**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**KUVENDI**

**L I G J**
**Nr.8449 datë 27.1.1999**

# KODI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I

## P J E S A I
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### KREU 1
### FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIME BAZË

Neni 1

Legjislacioni doganor përbëhet nga ky Kod, nga legjislacioni doganor ndërkombëtar lidhur me konventat në të cilat aderon Republika e Shqipërisë, nga aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, si edhe nga aktet e tjera ligjore që kanë të bëjnë me veprimtarinë doganore.

Neni 2

Veprimtaria doganore siguron mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë, që kanë të bëjnë me importet, eksportet dhe tranzitet e mallrave, pavarësisht nga mënyra e transportit, lidhur me dërgesat ndërkombëtare, me kalimin në pikat kufitare dhe me qarkullimin e lirë të mallrave, të personave dhe të bagazheve të tyre.

Neni 3

Territori doganor përfshin territorin tokësor, ujërat territoriale, ujërat e brendshme dhe hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Vija doganore përbëhet nga bregdeti, brigjet e liqeneve e të lumenjve kufitarë dhe nga kufijtë tokësorë me shtetet e tjerë.

Neni 5

1. Zona doganore përfshin atë pjesë të territorit doganor ku veprojnë autoritetet doganore, si dhe të gjitha zonat ku këto autoritete ushtrojnë kontroll ose mbikëqyrje doganore.
2. Zonat doganore vendosen në pikat e kontrollit të kalimit të kufirit, si dhe në pikat e tjera të territorit doganor.
3. Krijimi, shtrirja territoriale dhe klasifikimi i zonave doganore të përhershme ose të përkohshme,

caktohen nga Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit të Financave.

Neni 6

1. Zona doganore e mbikëqyrjes tokësore përbëhet nga territori që përfshin hapësirën nga vija doganore e kufirit tokësor deri në 10 km në brendësi. Përgjatë bregdetit kjo zonë mbikëqyrjeje shkon deri në 5 km nga bregu në brendësi.

2. Zona doganore e mbikëqyrjes detare përbëhet nga rripi i detit që shtrihet prej vijës doganore deri në kufirin e jashtëm të ujrave territoriale dhe të ujërave të brendshme.

Neni 7
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

"Me autoritete doganore kuptohen autoritetet e ngarkuara me zbatimin e legjislacionit doganor dhe te akteve te tjera ligjore dhe nenligjore, zbatimi i te cilave i eshte
ngarkuar ketyre autoriteteve."

Neni 8
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

Për qëllim të këtij Kodi, përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1.“Person” do të thotë:

a) një person fizik;

b) një person juridik.

c) te gjithe personat e tjere te njohur nga legjislacioni ne fuqi

2.“Person i vendosur në Republikën e Shqipërisë” do të thotë:

a) ne rastin e nje personi fizik ose te personave te tjere te permendur ne piken 1 shkronja "c", çdo person qe rregullisht banon ne Shqiperi.

b) në rastin e një personi juridik, çdo person i cili ka në Republikën e Shqipërisë një zyrë të regjistruar, selinë qendrore ose një seli të përhershme afariste.

3. “Administratë doganore” do të thotë: struktura organike e autoriteteve doganore.

4.“Zyrë doganore” do të thotë: çdo zyrë në të cilën mund të kryhen të gjitha ose një pjesë e formaliteteve që parashikon legjislacioni doganor.

5.“Vendim” do të thotë: çdo akt zyrtar i autoriteteve doganore që ka të bëjë me normativat doganore që rregullojnë një çështje të caktuar, i cili ka pasoja ligjore për një ose disa persona të caktuar ose të identifikueshëm.

6.“Status doganor” do të thotë: statusi i mallrave të kategorizuara si mallra shqiptare ose joshqiptare.

7.“Mallra shqiptare” do të thotë:

a) mallrat që përftohen ose prodhohen tërësisht në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë sipas kushteve të përcaktuara në nenin 29 dhe që nuk kanë në përbërje mallra të importuara nga vende ose territore të tjera;

b) mallrat e importuara nga vende ose territore të tjera dhe të vendosura në qarkullim të lirë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

c) mallrat që përftohen ose prodhohen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, qoftë vetëm prej mallrash të përmendura në nënparagrafin (b), qoftë prej mallrash të përmendura në të dy nënparagrafet e mësipërm (a) dhe (b).

8. “Mallra joshqiptare” do të thotë: të gjitha mallrat që nuk përfshihen në paragrafin 7.

9. “Borxh doganor” do të thotë: detyrimi që ka një person për të paguar shumën e detyrimeve të importit (borxh doganor importi) ose shumën e detyrimeve të eksportit (borxh doganor eksporti), që zbatohen për mallra të caktuara sipas dispozitave në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

10. “Detyrime importi” do të thotë: detyrimet doganore dhe taksa të tjera që kanë efekt të njëjtë me detyrimet doganore që duhen paguar në importimin e mallrave.

11. “Detyrime eksporti” do të thotë: detyrimet doganore dhe taksa të tjera që kanë efekt të njëjtë me detyrimet doganore që duhen paguar në eksportimin e mallrave.

12. “Debitor” do të thotë: çdo person që ka një borxh doganor për të paguar.

13. “Mbikëqyrje nga autoritetet doganore” do të thotë: veprimet me karakter të përgjithshëm të ndërmarra nga këto autoritete për të siguruar respektimin e legjislacionit doganor dhe, kur është e nevojshme, të dispozitave të tjera të zbatueshme mbi mallrat që i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore. Mbikëqyrja e zonës doganore të mbikëqyrjes tokësore kryhet nga autoritetet doganore të brendshme dhe mbikëqyrja e zonës doganore të mbikëqyrjes ujore nga autoritetet doganore detare.

14. “Kontroll nga autoritetet doganore” do të thotë: kryerja e veprimeve specifike si kontrolli i

mallrave, verifikimi i ekzistencës dhe i vërtetësisë së dokumenteve, shqyrtimi i kontabilitetit dhe i dokumenteve të tjerë të ndërmarrjeve, inspektimi i mjeteve të transportit, kontrolli i bagazheve dhe i mallrave të tjera që personat mbajnë ose kanë në trupin e vet, kryerja e verifikimeve dhe e veprimeve të tjera të ngjashme, për të siguruar respektimin e rregullave doganore dhe, kur është e nevojshme, të dispozitave të tjera të zbatueshme mbi mallrat që i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

15. “Destinacion doganor i mallrave” do të thotë:

a) vendosja e mallrave nën një regjim doganor;

b) hyrja e tyre në një zonë të lirë ose në një magazinë të lirë;

c) rieksportimi i tyre nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

d) asgjesimi i tyre;

e) braktisja dhe kalimi i tyre në favor të buxhetit të shtetit.

16. “Regjim doganor” do të thotë:

a) vënia në qarkullim të lirë;

b) tranziti;

c) magazinimi doganor;

d) përpunimi aktiv;

e) përpunimi nën kontroll doganor;

f) lejimi i përkohshëm;

g) përpunimi pasiv;

h) eksportimi.

17. “Deklarim në doganë” do të thotë: akti me të cilin një person shpreh, në format dhe mënyrat e caktuara, vullnetin për të vendosur mallrat nën një regjim të caktuar doganor.

18. “Datë e pranimit të deklarimit në doganë” do të thotë: çasti kur bëhet deklarimi në doganë dhe pranohet nga zyra doganore.

19. "Deklarues" do te thote: personi qe ben deklarimin ne dogane me emrin e vet ose personi ne emer te te cilit behet deklarimi ne dogane.

20. “Paraqitje e mallrave në doganë” do të thotë: njoftimi i autoriteteve doganore, në mënyrën e parashikuar, për mbërritjen e mallrave në zyrën doganore ose në një vend të caktuar ose të miratuar prej autoriteteve doganore.

21. “Çlirim i mallrave” do të thotë: akti, me anë të të cilit autoritetet doganore e bëjnë një mall të disponueshëm për qëllimet e parashikuara nga regjimi doganor, të cilit ai mall i ishte nënshtruar.

22. “Mbajtës i regjimit” do të thotë: personi për llogari të të cilit është bërë deklarimi në doganë ose personi të cilit i janë transferuar të drejtat dhe detyrimet e personit të përmendur më lart, lidhur me një regjim doganor.

23. “Mbajtës i autorizimit” do të thotë: personi të cilit i është lëshuar autorizimi.

## KREU 2
## ORGANIZIMI I ADMINISTRATËS DOGANORE, I PERSONELIT DHE I VEPRIMTARISË DOGANORE

### SEKSIONI 1
### ORGANIZIMI I ADMINISTRATËS DOGANORE QENDRORE DHE VENDORE

#### Neni 9
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Administrata doganore përbëhet nga drejtoria e përgjithshme, nga drejtoritë rajonale dhe nga degët doganore. Ajo varet nga Ministria e Financave dhe është nën mbikëqyrjen e saj.

2. Drejtoritë rajonale varen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe janë nën mbikëqyrjen e saj. Ato përbëhen nga një ose disa degë doganore, mbi të cilat ushtrojnë kontroll.

3. Kompetencat dhe organizimi i administratës doganore përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

4. Ne strukturat e Drejtorise se Pergjithshme te Doganave krijohet organi i luftes kunder kontrabandes dhe trafikut te paligjshem, i cili kryen funksionet e policies gjyqesore.
Detyrat dhe te drejtat e personelit qe kryen funksionet e policise gjyqesore jane te percaktuara me ligj.

#### Neni 10
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

Orari i funksionimit te zyrave te administrates doganore percaktohet ne aktet nenligjore ne zbatim te ketij Kodi.

SEKSIONI 2
FORMALITETET, KONTROLLET, MBIKËQYRJA DHE KOMPETENCAT E AUTORITETEVE DOGANORE

Neni 11
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Mallrat mund të kalojnë vijën doganore të kufirit tokësor, ujor dhe në aeroporte vetëm në pikat e kalimit të kufirit shtetëror, ku ka zona doganore.

2. Ngarkimi, shkarkimi, imbarkimi, zbarkimi dhe transbortimi i mallrave dhe i mjeteve përgjatë vijës doganore kufitare dhe në aeroporte kryhet me lejen e autoriteteve doganore dhe në përputhje me mënyrat e përcaktuara prej tyre.

3. Autoritetet doganore janë përgjegjëse për :

a) kryerjen e të gjitha veprimeve të përcaktuara në këtë Kod për mallrat në hyrje dhe në dalje të territorit doganor shqiptar, sipas rregullave të parashikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi;

b) verifikimin dhe vjeljen e detyrimeve doganore që duhen paguar;

c) "parandalimin, verifikimin dhe luften ndaj veprimtarise kontrabande, shkeljeve dhe trafikut te paligjshem te mallrave te ndaluara;

d) konstatimin dhe verifikimin e shkeljeve të dispozitave të këtij Kodi, të parashikura në pjesën VIII;

e) "pergatitjen dhe nenshkrimin e marreveshjeve dhe konventave nderkombetare ne fushen e doganave, sipas autorizimit;

f) përgatitjen, mbledhjen dhe, mbi bazën e një kërkese me shkrim, dërgimin e të dhënave statistikore të tregtisë së jashtme për Ministrinë e Bashkëpunimit Ekonomik e të Tregtisë dhe për organet e tjera publike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

g) mbikëqyrjen në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave që i nënshtrohen mbikëqyrjes së autoriteteve doganore.

4. Për të siguruar respektimin e dispozitave të përcaktuara nga ky Kod dhe nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore, zbatimi i të cilave u është ngarkuar autoriteteve doganore, punonjësit e doganave ushtrojnë kontroll mbi të gjitha mallrat, mbi mjetet e transportit dhe udhëtarët që kalojnë vijën doganore në zonat doganore e përgjatë vijës kufitare tokësore e ujore, në ujërat e brendshme dhe në hapësirën ajrore, që janë nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore. Me qëllim që të rritet efikasiteti i kontrolleve, autoritetet doganore mund të lidhin edhe marrëveshje për shkëmbim informacioni me organizma publikë ose privatë, shqiptarë ose të huaj, të këtij sektori.

5. Në pikat e kalimit të kufirit tokësor, ujor e në aeroporte, si dhe në dalje nga doganat e brendshme, organizohet kontrolli i mallrave dhe i mjeteve të transportit, që dalin nga zonat doganore, per te verifikuar nese cilesia dhe sasia e mallrave të transportuara janë në përputhje me dokumentet doganore shoqëruese. Nëse nuk rezultojnë mospërputhje, punonjësit e doganës që kryejnë këtë shërbim vendosin mbi dokumentet doganore vulën që tregon se janë në rregull. Në rast të kundërt, ata përpilojnë procesverbalin përkatës, të cilin ia kalojnë Kryetarit të zyrës doganore për të kryer formalitetet e mëtejshme.

6. Kur është e nevojshme, një shërbim i tillë kryhet nga autoritetet doganore edhe nëpërmjet kontrollit të mjeteve të transportit përgjatë rrugëve të lëvizjes së këtyre mjeteve. Në këtë rast, punonjësit e doganës që janë ngarkuar për të ndaluar mjetet e transportit, përdorin tabelën e ndalim-qarkullimit, me të cilën janë pajisur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe i tregojnë drejtuesit të mjetit kartën e tyre identifikuese. Në rast se nga kontrolli i bërë rezultojnë parregullsi, punonjësit e doganës e shoqërojnë automjetin pranë zyrës doganore më të afërt, ku përpilojnë procesverbalin përkatës, i cili i dorëzohet kryetarit të zyrës doganore për të kryer formalitetet e mëtejshme.

7. Me qëllim që të sigurohet zbatimi i legjislacionit doganor dhe i akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, zbatimi i të cilave i është ngarkuar doganës, autoritetet doganore mund të kryejnë të gjitha kontrollet e nevojshme pranë mjediseve të deklaruesit ose të çdo personi tjetër që është përfshirë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në çlirimin e mallrave, sipas akteve nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

8. Në rastet kur autoritetet e tjera që veprojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë kanë dyshime ose vihen në dijeni për shkelje të normave të këtij Kodi, të akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe të ligjeve të tjera, zbatimi i të cilave është detyrë e autoriteteve doganore, ato njoftojnë menjëherë zyrën doganore që mbulon territorin në fjalë. Kjo e fundit kryen të gjitha verifikimet e formalitetet e rastit, përfshirë këtu edhe njoftimin e organeve gjyqësore, sipas procedurave të parashikuara në pjesën VIII të këtij Kodi.

9. Kur ka dyshime të bazuara për trafik droge, armësh ose për krime të tjera me karakter ekonomik e financiar, autoritetet kompetente të policisë mund të ndalojnë automjetet që u nënshtrohen formaliteteve doganore dhe që janë të vulosura me plumbç prej autoriteteve doganore. Në këto raste, mjetet e transportit

shoqërohen në zyrën doganore më të afërt që është kompetente territorialisht, ku hiqet vula dhe autoritetet e mësipërme policore, në prani të autoriteteve doganore, kryejnë të gjitha kontrollet që ato i konsiderojnë të nevojshme. Këto autoritete, në bashkëpunim me autoritetet doganore, përgatisin një raport me shkrim, i cili, nëse është rasti, u dërgohet autoriteteve gjyqësore në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 12
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Përveç rasteve të forcave madhore, plotesisht te dokumentuara dhe me përjashtim të regjimit të tranzitit dhe vendosjes së mallrave në qarkullim të lirë, deklarimi në doganë duhet të bëhet në zyrën doganore kompetente për territorin ku është vendosur personi.

2. "Drejtori i Pergjithshem, duke bere perjashtim nga rregulli i shprehur ne piken 1, kur rrethanat kerkojne kryerje kontrollesh te veçanta, mund te vendose qe formalitetet doganore per disa kategori mallrash te perqendrohen ne zyren doganore kufitare ose ne nje a disa zyra doganore te brendshme."

3. Për nevoja të tregtisë dhe me kërkesë të personit të interesuar, kryetarët e degëve doganore mund të lejojnë që disa nga kontrollet doganore të kryhen në mjediset e deklaruesve ose në vende të tjera të propozuara prej tyre, të cilat konsiderohen të përshtatshme nga autoritetet doganore për kryerjen e të gjitha kontrolleve të nevojshme. Deklaruesit i ngarkohen shpenzimet e këtij shërbimi, të cilat përcaktohen me udhëzim të Drejtorit të Përgjithshëm, duke llogaritur kohën e harxhuar për kryerjen e kontrollit, si dhe largësinë e këtyre mjediseve nga zyra doganore.

## SEKSIONI 3
## ORGANIKAT, PUNËSIMI DHE MARRËDHËNIET E PUNËS SË PERSONELIT TË ADMINISTRATËS DOGANORE

Neni 13

1. Brenda 15 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij Kodi, Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit të Financave, përcakton organikën e administratës doganore, në mënyrë që të garantojë, nga njëra anë, mbrojtjen e interesave fiskale të Republikës së Shqipërisë dhe, nga ana tjetër, një organizim të përshtatshëm për dinamizmin dhe veçantinë e veprimtarisë doganore. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave merr masat për caktimin e personelit në zyrat doganore qendrore dhe vendore.

2. Në organikë, personeli sipas detyrave ndahet në funksionarë të lartë, drejtues, funksionarë doganorë dhe personel tjetër doganor të kategorizuar në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

3. Detyrat dhe funksionet e secilës prej kategorive të mësipërme, si dhe procedurat e kalimit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë karriere përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

4. Këshilli i Ministrave, brenda 15 ditësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij Kodi, përcakton nivelin e pagës për çdo kategori të personelit të parashikuar në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, në përputhje me ligjislacionin në fuqi.

Neni 14
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Drejtori i Pergjithshem emerohet me vendim te Keshillit te Ministrave, me propozim te Ministrit te Financave. Nendrejtoret e Pergjithshem te Doganave emerohen nga Ministri i Financave me propozim te Drejtorit te Pergjithshem te Doganave, sipas dispozitave te punesimit te ketij Kodi.

2. Personeli i administrates doganore, me perjashtim te personelit ndihmes, punesohet nepermjet nje konkurrimi publik, sipas procedurave te percaktuara nga ligji "Per sherbimin civil" dhe nga aktet nenligjore ne zbatim te tij, si dhe nga aktet nenligjore ne zbatim te ketij Kodi dhe nga dispozita te tjera te posaçme, qe rregullojne funksionimin e Drejtorise se Pergjithshme te Doganave.

3. Personeli ndihmes punesohet me emerim nga Drejtori i Pergjithshem i Doganave."

Neni 15
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Përveç të ardhurave të përmendura në nenin 296 të këtij Kodi, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave i lihen edhe 2 për qind të të ardhurave vjetor të doganave, për t'i përdorur për investime, përmirësimin e kushteve të punës e të jetesës së personelit të administratës doganore, si dhe për shpërblimin e tij.

2. Pa rene ndesh me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për nëpunësit publikë, personelit të

administratës doganore, duke pasur parasysh veçantinë e punës që kryen, si dhe vështirësitë që përballon gjatë ushtrimit të detyrës, mund t'i njihet një shpërblim stimulues, i bazuar në kriteret e mëposhtme:

a) shërbimi i kryer në zyrat doganore të kufirit tokësor, ujor dhe ajror;

b) shërbime me rrezik të veçantë për personin;

c) konstatimi i shkeljeve të Kodit Doganor dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

d) efikasiteti në punë.

3. Drejtori i Përgjithshëm, mbi bazën e kritereve të parashikuara në paragrafin 2 më sipër, bën shpërndarjen e këtij shpërblimi midis personelit të administratës doganore.

Neni 16

(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

"1. Policia gjyqesore, sipas nenit 9.4 te ketij Kodi gezon statusin e ushtarakut. Ajo vepron ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

2. Personeli doganor mban uniformen e sherbimit dhe, sipas vendimit te Drejtorit te Pergjithshem te Doganave, mund te pajiset me arme. Ne rastet kur, per nevoja te sherbimit, eshte e nevojshme te veprohet pa uniforme, personeli doganor duhet te paraqese dokumentin e identifikimit te leshuar nga Drejtori i Pergjithshem i Doganave.

3. Pajisja me arme dhe perdorimi i tyre nga punonjesit e doganes behet ne perputhje me dispozitat e ligjit per armet dhe te ligjit per perdorimin e armeve te zjarrit.

4. Personelit doganor i ndalohet te pranoje, drejtperdrejt ose terthorazi, shperblime ne para ose ne natyre per sherbimet doganore qe kryen. Atij i ndalohet te ushtroje çfaredo lloj veprimtarie tregtare ose keshillimore te papajtueshme me ushtrimin e veprimtarise doganore.

5. Personeli doganor eshte i detyruar te ruaje sekretin profesional per te gjitha veprimtarite qe lidhen me ushtrimin e detyres.

6. Ne baze te dispozitave te parashikuara nga Kodi Penal dhe te dispozitave ligjore e nenligjore ne fuqi ne fushen e doganave, Drejtori i Pergjithshem merr masa disiplinore per rastet e shkeljeve te ketij neni.

## KREU 3
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME, QË KANË TË BËJNË POSAÇËRISHT ME TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PERSONAVE LIDHUR ME LEGJISLACIONIN DOGANOR

### SEKSIONI 1
### E DREJTA E PËRFAQËSIMIT

Neni 17

1. Sipas kushteve të përcaktuara në nenin 89(2), çdo person mund të caktojë një përfaqësues të vetin për marrëdhëniet me autoritetet doganore, për të kryer veprimet e për të përmbushur formalitetet e parashikuara nga legjislacioni doganor.

2. Ky përfaqësim mund të jetë:

a) i drejtpërdrejtë, kur përfaqësuesi vepron në emër e për llogari të një personi tjetër; ose

b) i tërthortë, kur përfaqësuesi vepron në emër të tij, por për llogari të një personi tjetër.

3. Përveç rasteve të përmendura në nenin 89(2) (b) dhe (3), përfaqësuesi duhet të jetë i vendosur në Republikën e Shqipërisë.

4. Përfaqësuesi duhet të deklarojë se vepron për llogari të personit të përfaqësuar, të specifikojë nëse përfaqësimi është i drejtpërdrejtë ose i tërthortë dhe nëse ka të drejtën të veprojë si përfaqësues.

5. Autoritetet doganore i kërkojnë çdo personi që deklaron se vepron në emër dhe për llogari të një personi tjetër, të paraqesë dokumente që provojnë se i është dhënë e drejta të veprojë si përfaqësues.

6. Përfaqësues, sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen, mund të jetë edhe agjenti doganor i licencuar si i tillë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Kushtet për lëshimin dhe revokimin e licencës përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

### SEKSIONI 2
### VENDIME LIDHUR ME ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT DOGANOR

Neni 18

1. Kur një person kërkon që autoritetet doganore të marrin një vendim në zbatim të rregullave doganore, ai duhet të vërë në dispozicion të gjithë informacionin dhe të gjitha dokumentet e kërkuara nga autoritetet doganore për marrjen e vendimit.

2. Vendimi merret dhe i njoftohet kërkuesit brenda 30 ditësh nga data e paraqitjes së kërkesës.

3. Kur vendimet që janë marrë dhe i janë njoftuar kërkuesit me shkrim nga autoritetet doganore, hedhin poshtë kërkesën e tij ose janë në dëm të tij, duhet të shpjegohen arsyet në të cilat janë bazuar këto vendime. Në to duhet të vihet në dukje e drejta e kërkuesit për t'u ankuar siç parashikohet në nenet 19 dhe 20 të këtij Kodi.

4. Vendimet që janë marrë dhe i janë bërë të ditura kërkuesit zbatohen menjëherë nga autoritetet doganore. Kur vendimi kërkon pagesën e detyrimeve të importit ose të detyrimeve të eksportit dhe ky vendim kundërshtohet nga kërkuesi, zbatimi i tij mund të pezullohet vetëm në qoftë se ekziston ose lëshohet një garanci.

Neni 19

1. Një vendim në favor të kërkuesit anulohet në qoftë se është marrë në bazë informacionesh të pasakta ose të paplota dhe kur:

a) kërkuesi ishte në dijeni ose objektivisht duhej të ishte në dijeni që informacioni i dhënë ishte i pasaktë ose i paplotë, dhe

b) ky vendim nuk do të ishte marrë mbi bazën e një informacioni të saktë e të plotë.

2. Personi të cilit i adresohet vendimi duhet të njoftohet menjëherë për anulimin e tij.

3. Anulimi është i vlefshëm që nga data e marrjes së vendimit dhe mund të bëhet vetëm brenda periudhës kohore për të cilën është i vlefshëm autorizimi.

4. Personi i interesuar mund të ankohet kundër vendimit të anulimit të autorizimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave brenda 10 ditëve që nga data e njoftimit. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave kthen përgjigje brenda 20 ditëve për pranimin ose jo të ankesës. Në rast se Drejtori i Përgjithshëm i Doganave nuk kthen përgjigje brenda këtij afati kohor, kërkesa quhet e pranuar.

Neni 20

1. Me përjashtim të rasteve të përmendura në nenin 19, vendimi i marrë në favor të personit të interesuar revokohet ose ndryshohet në rastet kur një ose disa prej kushteve të përcaktuara për marrjen e vendimit nuk përmbushen më.

2. Një vendim në favor të personit të interesuar mund të revokohet kur personi të cilit i adresohet ai nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga vendimi në fjalë.

3. Personi, të cilit i adresohet vendimi, njoftohet menjëherë për revokimin ose ndryshimin e tij.

4. Revokimi ose ndryshimi i vendimit është i vlefshëm që nga data e njoftimit.

5. Personi i interesuar mund të ankohet kundër revokimit ose ndryshimit të vendimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave brenda 10 ditëve që nga data e njoftimit. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave kthen përgjigje brenda 20 ditëve për pranimin ose jo të ankesës. Në rast se Drejtori i Përgjithshëm i Doganave nuk kthen përgjigje brenda këtij afati kohor, kërkesa quhet e pranuar.

SEKSIONI 3
INFORMACIONI

Neni 21

1. Personat fizikë dhe juridikë për veprimet e tyre doganore, si dhe institucionet shtetërore në ushtrimin e funksoneve dhe kompetencave që u ka dhënë ligji mund t'u kërkojnë autoriteteve doganore informacion për zbatimin e legjislacionit doganor. Një kërkesë e tillë mund të refuzohet kur ajo nuk lidhet me një veprim importi ose eksporti që do të kryhet realisht.

2. Informacioni i jepet kërkuesit pa pagesë. Megjithatë, në rastin kur autoritetet doganore kanë bërë shpenzime të veçanta, që kanë të bëjnë veçanërisht me kryerjen e analizave dhe me raportet e ekspertëve për mallrat ose me kthimin e mallrave kërkuesit, shpenzimet i ngarkohen këtij të fundit.

Neni 22

1. Autoritetet doganore, kundrejt një kërkese me shkrim, japin informacion tarifor të detyrueshëm.

2. Informacioni tarifor i detyrueshëm është detyrues për autoritetet doganore kundrejt mbajtësit të informacionit vetëm përsa i takon klasifikimit tarifor të mallrave. Informacioni tarifor i detyrueshëm është detyrues për autoritetet doganore vetëm lidhur me mallrat, për të cilat formalitetet doganore janë kryer pas datës së dhënies së informacionit nga ana e tyre.

3. Mbajtësi i këtij informacioni duhet të provojë që mallrat e deklaruara i korrespondojnë në çdo aspekt mallrave të përshkruara në informacion.

4. Informacioni tarifor i detyrueshëm është i vlefshëm për një afat prej 6 vjetësh. Përveç rasteve të parashikuara në nenin 19, informacioni tarifor i detyrueshëm anulohet në rastet kur ai bazohet në informacione të paplota ose të pasakta të dhëna nga kërkuesi.

5. Informacioni tarifor i detyrueshëm pushon së qeni i vlefshëm kur:

a) nuk përputhet më me aktet ligjore dhe nëligjore në fuqi;

b) nuk përputhet më me shënimet shpjeguese ose me ndryshimet e bëra në Nomenklaturën e Sistemit të Harmonizuar për Përshkrimin dhe Kodifikimin e Mallrave, të miratuara nga Organizata Botërore e Doganave. Në këtë rast, data prej së cilës informacioni tarifor i detyrueshëm pushon së qeni i vlefshëm, është data në të cilën botohen masat e sipërpërmendura;

6. Klasifikimi tarifor i bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është detyrues dhe mund të ndryshohet vetëm me vendim të Komitetit të Sistemit të Harmonizuar pranë Organizatës Botërore të Doganave.

## SEKSIONI 4
## DISPOZITA TË TJERA

### Neni 23

Autoritetet doganore, në përputhje me kushtet e parashikuara nga dispozitat në fuqi, kryejnë të gjitha kontrollet që konsiderohen të nevojshme për të siguruar zbatimin me korrektësi të legjislacionit doganor.

### Neni 24

Për zbatimin e legjislacionit doganor, çdo person i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në operacione që lidhen me tregtinë e mallrave, duhet t'u paraqesë autoriteteve doganore të gjithë dokumentet dhe informacionin e nevojshëm, pavarësisht nga mënyra e përdorur për mbajtjen e tyre, si dhe të japë gjithë ndihmën e nevojshme të kërkuar prej tyre, brenda afateve kohore të përcaktuara nga autoritetet doganore. Në këtë rast zbatohet neni 26 i këtij Kodi.

### Neni 25

Çdo informacion i natyrës konfidenciale ose që është dhënë në konfidencë, mbrohet nga detyrimi për ruajtjen e sekretit profesional. Këto lloje infomacionesh nuk jepen nga autoritetet doganore pa lejen e shprehur qartë të personit ose të organit që i jep ato. Dhënia e informacionit lejohet atëherë kur autoritetet doganore janë të detyruara ose të autorizuara ta japin atë për procedura gjyqësore, sipas dispozitave në fuqi, veçanërisht të atyre për mbrojtjen e të dhënave.

### Neni 26

1. Personat e interesuar i ruajnë dokumentet e përmendura në nenin 24 për qëllime kontrolli nga ana e autoriteteve doganore për një periudhë prej dhjetë vjetësh kalendarikë, pavarësisht nga mjeti i përdorur. Kjo periudhë fillon nga fundi i vitit kur:

a) në rastin e mallrave të vendosura në qarkullim të lirë ose të deklaruara për eksport, qysh nga fundi i vitit kur është pranuar deklarata për vendosjen në qarkullim të lirë ose për eksport;

b) në rastin e mallrave të vendosura në qarkullim të lirë me detyrime importi të reduktuara ose zero, për shkak të përdorimit të tyre të veçantë, qysh nga fundi i vitit kur mallrat pushojnë së qeni objekt mbikëqyrjeje doganore;

c) në rastin e mallrave të vendosura nën një regjim tjetër doganor, qysh nga fundi i vitit kur regjimi doganor në fjalë ka përfunduar;

d) në rastin e mallrave të vendosura në zonë të lirë ose në magazinë të lirë, qysh nga fundi i vitit kur mallrat largohen nga zona ose magazina e lirë.

2. Megjithatë, dokumentet ruhen më gjatë se afati prej dhjetë vjetësh, në përputhje me dispozitat e parashikuara në akte të tjera ligjore, në rastet e mëposhtme:

a) kur kontrolli i autoriteteve doganore mbi një borxh doganor tregon se kontabiliteti përkatës duhet korrigjuar;

b) në rast se komunikimi me debitorin është pasojë e një veprimi që mund të çonte në ndjekje penale dhe autoritetet doganore nuk mund të përcaktonin shumën e saktë që duhet paguar sipas ligjit.

### Neni 27

Vlera e valutave të huaja në lekë shqiptare që duhet zbatuar në kuadrin e legjislacionit doganor llogaritet me kursin e këmbimit të shpallur nga Banka e Shqipërisë.

PJESA II
FAKTORËT MBI BAZËN E TË CILËVE ZBATOHEN DETYRIMET E IMPORTIT E TË EKSPORTIT, SI DHE MASAT E TJERA TË PARASHIKUARA PËR TREGTINË E MALLRAVE

KREU 1
TARIFA DOGANORE DHE KLASIFIKIMI TARIFOR I MALLRAVE

Neni 28

1. Detyrimet doganore ligjore që duhen shlyer kur lind një borxh doganor, bazohen në tarifën doganore të Republikës së Shqipërisë.

2. Masat e tjera, të parashikuara nga dispozitat që rregullojnë fusha të veçanta, që kanë të bëjnë me tregtinë e mallrave, zbatohen, kur është e nevojshme, sipas klasifikimit tarifor të këtyre mallrave.

3. Tarifa doganore e Republikës së Shqipërisë përfshin:

a) nomenklaturën e mallrave të bazuar në sistemin e harmonizuar;

b) çdo nomenklaturë tjetër, të bazuar tërësisht ose pjesërisht në sistemin e harmonizuar ose që i shton nënndarje këtij sistemi dhe që përcaktohet me dispozita të tjera që rregullojnë sektorë të veçantë, me synim zbatimin e masave tarifore që kanë të bëjnë me tregtinë e mallrave;

c) nivelet e detyrimeve doganore dhe të taksave të tjera, që zbatohen normalisht mbi mallrat e përfshira në nomenklaturën e bazuar në sistemin e harmonizuar;

d) masat tarifore preferenciale të përcaktuara në marrëveshjet që Republika e Shqipërisë lidh me vende të caktuara ose me grupe vendesh, dhe që parashikojnë dhënien e një trajtimi tarifor preferencial;

e) masat pezulluese autonome që parashikojnë një reduktim në/ose përjashtimin nga detyrimet e importit që duhen paguar për disa mallra;

f) masa të tjera tarifore të parashikuara në kuadrin e politikave tregtare shqiptare;

g) masa të tjera tarifore të parashikuara nga ligje të tjera shqiptare.

4. Me kërkesë të deklaruesit, zbatohen masat e përmendura në nënparagrafet 3 (d) dhe (e), në vend të atyre të parashikuara në nënparagrafin 3 (c), kur mallrat në fjalë plotësojnë kushtet e përcaktuara nga këto masa. Kërkesa mund të paraqitet edhe më pas, me kusht që të plotësohen kushtet përkatëse.

5. Kur zbatimi i masave të përmendura në nënparagrafin 3(d) dhe (e) kufizohet në një vëllim të caktuar importesh, ato pushojnë së qeni të vlefshme:

a) në rastin e kontigjenteve tarifore, sapo arrihet kufiri i vëllimit të përcaktuar të importeve;

b) në rastin e tavaneve tarifore, sipas dispozitave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.

6. Klasifikimi tarifor i mallrave qëndron në përcaktimin, sipas legjislacionit në fuqi:

a) të nëndarjes së nomenklaturës së bazuar në Sistemin e Harmonizuar ose të nënndarjes së çdo nomenklature tjetër të përmendur në nënparagrafin 3(b); ose

b) të nëndarjes së çdo nomenklature tjetër, të bazuar tërësisht ose pjesërisht në sistemin e harmonizuar ose që i shton nënndarje këtij sistemi dhe që parashikohet nga dispozita të tjera që rregullojnë sektorë të veçantë, me synim zbatimin e masave që ndryshojnë nga masat tarifore që kanë të bëjnë me tregtinë e mallrave, në të cilën klasifikohen mallrat e sipërpërmendura.

7. Trajtimi tarifor favorizues prej të cilit mund të përfitojnë disa mallra për shkak të natyrës së tyre ose të përdorimit të tyre të veçantë, i nënshtrohet kushteve të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi. Kur kërkohet autorizim, zbatohen nenet 109 dhe 110.

8. Për qëllim të paragrafit 7, me shprehjen “trajtim tarifor favorizues” kuptohet reduktimi ose pezullimi i një detyrimi importi, siç përmendet në nenin 8(10), qoftë kjo edhe në kuadrin e një kontigjenti tarifor.

KREU 2
ORIGJINA E MALLRAVE

SEKSIONI 1
ORIGJINA JOPREFERENCIALE

Neni 29

1. Me mallra që e kanë origjinën nga një vend i caktuar, kuptohen mallrat e përftuara ose prodhuara tërësisht në atë vend.

2. Me shprehjen “mallra të përftuara ose prodhuara tërësisht në një vend” kuptohen:

a) produktet minerale të nxjerra brenda këtij vendi;

b) produktet bimore të vjela ose të korrura në atë vend;

c) kafshët e gjalla të lindura dhe të rritura në atë vend;
d) produktet e prejardhura nga kafshë të gjalla të rritura në atë vend;
e) produktet e gjahut ose të peshkimit të kryer në atë vend;
f) produktet e peshkimit dhe produkte të tjera deti të marra jashtë ujërave territoriale të atij vendi nga anije të regjistruara ose të matrikuluara në atë vend dhe që mbajnë flamurin e atij vendi;
g) mallrat e përftuara ose të prodhuara në bordin e anijeve-fabrikë nga produktet e përmendura në nënpragrafin (f), me origjinë nga ai vend, me kusht që këto anije-fabrikë të jenë të regjistruara ose të matrikuluara në atë vend dhe të mbajnë flamurin e tij;
h) produktet e marra nga shtrati i detit ose nëntoka poshtë shtratit të detit jashtë ujërave territoriale, me kusht që ky vend të ketë të drejta ekskluzive për shfrytëzimin e shtratit të detit ose të nëntokës;
i) hedhurinat, mbetjet që dalin nga veprimtaria e prodhimit dhe produktet jashtë përdorimit, që janë mbledhur në atë vend dhe që mund të shërbejnë vetëm për t'u përdorur si lëndë të para;
j) mallrat e prodhuara tërësisht dhe vetëm prej mallrave të përmendura në nënpragrafet (a) deri (i) ose prej nënprodukteve të tyre, në çdo stad prodhimi që të jenë.
3. Në funksion të paragrafit 2, fjala “vend” përfshin edhe ujërat territoriale të atij vendi.

Neni 30

Mallrat, prodhimi i të cilave ka përfshirë më shumë se një vend, quhen me origjinë nga vendi ku këto mallra i janë nënshtruar trajtimit ose përpunimit të fundit, thelbësor, të justifikuar ekonomikisht, i cili është kryer në një ndërmarrje të pajisur për këtë qëllim dhe si rezultat i të cilit është prodhuar një produkt i ri ose që përfaqëson një stad të rëndësishëm të përpunimit.

Neni 31
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Legjislacioni doganor mund te parashikoje paraqitjen e nje dokumenti qe verteton origjinen e mallrave.
2. Dhoma e Tregtisë, në juridiksionin e së cilës është prodhuar malli, lëshon certifikatën e origjinës jopreferenciale të mallrave me origjinë shqiptare.
3. Pavarësisht nga paraqitja e këtij dokumenti, në rast dyshimesh serioze, autoritetet doganore mund të kërkojnë prova të tjera për t’u siguruar që treguesi i origjinës përputhet me rregullat e përcaktuara në legjislacionin përkatës.
4. Rregullat e origjinës jopreferenciale përcaktojnë kushtet që duhet të plotësojnë mallrat për t’u konsideruar me origjinë nga një vend i caktuar. Ato shërbejnë:
a) për zbatimin e tarifave doganore të Republikës së Shqipërisë, përjashtuar masat e parashikuara në nenin 28 paragrafi (3)(d);
b) për zbatimin e masave që ndryshojnë nga këto tarifa, të përcaktuara me dispozita të posaçme në fushën e tregtisë së mallrave.
Formalitetet për lëshimin e certifikatës së origjinës jopreferenciale përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

## SEKSIONI 2
## ORIGJINA PREFERENCIALE E MALLRAVE

Neni 32

1. Dispozitat mbi origjinën preferenciale përcaktojnë kushtet që duhet të plotësojnë mallrat për të përfituar nga masat preferenciale të parashikuara në marrëveshjet që Republika e Shqipërisë nënshkruan me vende të veçanta ose me grupe vendesh.
2. Autoritetet doganore janë të autorizuara të lëshojnë certifikatën e origjinës preferenciale të mallrave.
3. Rregullat mbi origjinën preferenciale, si dhe formalitetet për lëshimin e certifikatave të origjinës preferenciale përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

## KREU 3
## VLERA E MALLRAVE PËR QËLLIME DOGANORE

Neni 33

Dispozitat e këtij kreu përcaktojnë vlerën doganore të mallrave për qëllim të zbatimit të tarifës

doganore të Republikës së Shqipërisë, si dhe të masave jotarifore të parashikuara nga dispozita të tjera që rregullojnë fusha të veçanta, që kanë të bëjnë me tregtinë e mallrave.

Neni 34

1. Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaktuar, që është çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar për mallrat e shitura për eksport drejt territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, duke marrë në konsideratë edhe rregullimet që mund t'i bëhen në përputhje me nenet 37 dhe 38, me kusht që:

a) nuk ekziston asnjë kufizim për tjetërsimin ose përdorimin e mallrave nga blerësi, përveç kufizimeve që:

i) janë vendosur ose parashikuar me ligj ose nga autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë,

ii) nuk ndikojnë në mënyrë thelbësore në vlerën e mallrave;

b) shitja ose çmimi nuk janë objekt i kushteve ose shqyrtimeve, për shkak të të cilave nuk mund të përcaktohet vlera doganore e mallrave që duhen vlerësuar;

c) asnjë pjesë e të ardhurave të nxjerra nga çdo rishitje, tjetërsim ose përdorim i mëvonshëm i mallrave nga blerësi, të mos i kthehet drejtpërdrejt ose tërthorazi shitësit, përveç rastit kur mund të bëhet një rregullim i duhur në përputhje me nenin 37; dhe

d) blerësi dhe shitësi nuk janë të lidhur, ose kur blerësi dhe shitësi janë të lidhur, vlera e transaktuar të jetë e pranueshme për qëllime doganore sipas paragrafit 2.

2 a) Për të përcaktuar nëse vlera e transaktuar është e pranueshme për qëllimet e paragrafit 1, fakti që blerësi dhe shitësi janë të lidhur nuk përfaqëson në vetvete një arsye të mjaftueshme, për ta konsideruar vlerën e transaktuar të papranueshme. Nëse është e nevojshme, shqyrtohen rrethanat e shitjes dhe pranohet vlera e transaktuar, me kusht që lidhja të mos ketë ndikuar në çmim. Nëse, në bazë të informacionit të dhënë nga deklaruesi ose të marrë nga burime të tjera, autoritetet doganore kanë arsye të mendojnë që kjo lidhje ka ndikuar në çmim, ata i komunikojnë arsyet deklaruesit, të cilit i jepet një mundësi e arsyeshme për t'u përgjigjur. Me kërkesë të deklaruesit, arsyet njoftohen me shkrim.

b) Në një shitje mes personash të lidhur, vlera e transaktuar pranohet dhe mallrat vlerësohen në përputhje me paragrafin 1, vetëm kur deklaruesi provon që kjo vlerë i përafrohet shumë njërës prej vlerave të mëposhtme, që ekzistojnë në të njëjtën ose përafërsisht në të njëjtën kohë:

i) vlerës së transaktuar në rast shitjeje të mallrave identikë ose të ngjashme për eksport drejt Republikës së Shqipërisë, midis blerësve dhe shitësve që nuk janë të lidhur në asnjë rast,

ii) vlerës doganore të mallrave identike ose të ngjashme, siç përcaktohet në nenin 35(2) (c ),

iii) vlerës doganore të mallrave identike ose të ngjashme, siç përcaktohet në nenin 35(2)(d).

Në zbatimin e kritereve të sipërpërmendura, duhet të mbahen parasysh diferencat që lidhen me nivelet tregtare, nivelet sasiore, elementet e renditura në nenin 37 dhe shpenzimet e bëra nga shitësi në ato shitje, në të cilat ai dhe blerësi nuk janë të lidhur, nëse keto shpenzime nuk janë bërë nga shitësi në shitje në të cilat shitësi dhe blerësi janë të lidhur.

c) Kriteret e vendosura në nënparagrafin (b) përdoren me kërkesë të deklaruesit dhe vetëm për qëllime krahasimi. Nuk mund të vendosen vlera zëvendësuese sipas nënparagrafit në fjalë.

3 a) Çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar për mallrat e importuara është pagesa e plotë e bërë ose që duhet bërë nga blerësi për shitësin, ose në dobi të këtij të fundit dhe që përfshin të gjitha pagesat e bëra ose që duhen bërë, si kusht i shitjes së mallrave të importuara, nga blerësi shitësit, ose nga blerësi një pale të tretë, për të shlyer një detyrim të shitësit. Pagesa mund të mos bëhet me doemos në formën e transferimit të parave. Pagesa mund të bëhet me anë të letrave të kredisë ose çdo mjeti tjetër të rënë dakord dhe mund të bëhet drejtpërsëdrejti ose tërthorazi.

b) Veprimtaritë, duke përfshirë edhe veprimtaritë e marketingut, që ndërmerren nga blerësi për llogari të vet dhe që janë të ndryshme nga ato për të cilat neni 37 parashikon një rregullim, nuk konsiderohen se janë një pagesë e tërthortë që i bëhet shitësit edhe pse mund të konsiderohen se janë në përfitim të shitësit ose janë ndërmarrë në marrëveshje me shitësin dhe kostoja e tyre nuk i shtohet çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar në përcaktimin e vlerës doganore të mallrave të importuara.

Neni 35

1. Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 34, ajo duhet të përcaktohet duke ndjekur sipas radhës nënparagrafët (a), (b), (c ) dhe (d) të paragafit 2, duke u ndalur në të parin nënparagraf që lejon përcaktimin e saj, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e zbatimit të nënparagrafëve (c) dhe (d) mund edhe të shkëmbehet, nëse këtë e kërkon deklaruesi; dhe vetëm në rast se kjo vlerë nuk mund të përcaktohet në bazë të një nënparagrafi të caktuar, lejohet të zbatohen dispozitat e nënparagrafit që vjen menjëherë pas tij, sipas radhës që përshkruhet më sipër në këtë paragraf.

2. Vlera doganore e përcaktuar sipas këtij neni do të jetë:

a) vlera e transaktuar e mallrave identike të shitura për eksport drejt Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në/ose afërsisht të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen;

b) vlera e transaktuar e mallrave të ngjashme, të shitura për eksport drejt Republikës së Shqipërisë dhe të eksportuara në/ose afërsisht të njëjtën kohë me mallrat që po vlerësohen;

c) vlera e bazuar në çmimin për njësi, në të cilin mallrat e importuara që u korrespondojnë mallrave identike ose të ngjashme të importuara dhe të shitura brenda Republikës së Shqipërisë në sasinë më të madhe të përgjithshme, personave jo të lidhur me shitësit;

d) vlera e përllogaritur e përbërë nga mbledhja:

i) e kostos ose vlerës së materialeve e të fabrikimit ose të çdo përpunimi tjetër të përdorur për prodhimin e mallrave të importuara,

ii) e shumës së fitimit dhe të shpenzimeve të përgjithshme, që ka bërë prodhuesi në vendin e eksportimit për t'i eksportuar në drejtim të Republikës së Shqipërisë, që janë të barabarta me shumat që zakonisht rezultojnë nga shitja e mallrave të së njëjtës kategori ose lloj me mallrat që po vlerësohen,

iii) e kostos ose vlerës së elementeve të përmendur në nenin 37(1)(e).

3. Rregulla të mëtejshme për zbatimin e paragrafit 2 do të përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

## Neni 36

1. Kur vlera doganore e mallrave të importuara nuk mund të përcaktohet në bazë të nenit 34 ose 35, ajo përcaktohet në bazë të të dhënave të disponueshme në Republikën e Shqipërisë, duke përdorur mjete të arsyeshme, në përputhje me:

a) Marrëveshjen për zbatimin e nenit 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë;

b) nenin 7 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë;

c) dispozitat e këtij kreu.

2. Në rastet kur zbatohet paragrafit 1 vlera doganore nuk mund të përcaktohet mbi bazën:

a)e çmimit të shitjes në Republikën e Shqipërisë të mallrave të prodhuara në Republikën e Shqipërisë;

b) e një sistemi, i cili, për qëllime doganore, parashikon pranimin e vlerës më të lartë midis dy vlerave alternative;

c) e çmimit të mallrave në tregun e brendshëm të vendit eksportues;

d) e kostos së prodhimit, të ndryshme nga vlerat e përllogaritura e të përcaktuara për mallra identike ose të ngjashme, në përputhje me nenin 35(2)(d);

e) e çmimeve për eksport drejt një vendi tjetër të ndryshëm nga Republika e Shqipërisë;

f) e vlerave doganore minimale; ose

g) e vlerave arbitrare ose fiktive.

## Neni 37

(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)
(ndryshuar me ligjin Nr.8719, datë 19.12.2000)

1. Për përcaktimin e vlerës doganore në bazë të nenit 34, çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar për mallrat e importuara i duhen shtuar:

a) elementet e mëposhtëm, në masën që ato kanë qenë në ngarkim të blerësit, por nuk janë përfshirë në çmimin realisht të paguar ose që duhet paguar për mallrat:

i) shpenzimet për komisionimet dhe ndërmjetësitë, me përjashtim të komisioneve të blerjes,

ii) kostoja e mbajtësve të mallrave që, për qëllime doganore, trajtohen si një tërësi e vetme me mallrat në fjalë,

iii) kostoja e ambalazhimit, përfshirë këtu si punën dhe materialet;

b) vlera, e përpjestuar në mënyrën e duhur, e mallrave dhe e shërbimeve të mëposhtme, kur këto mallra furnizohen drejtpërsëdrejti ose tërthorazi nga blerësi pa pagesë ose me pagesë të reduktuar për t'u përdorur për prodhimin dhe shitjen për eksport të mallrave të importuara, në atë masë që kjo vlerë nuk është përfshirë në çmimin realisht të paguar ose që duhet paguar:

i) materiale, pjesë përbërëse, pjesë dhe artikuj të ngjashëm të trupëzuar në mallrat e importuara,

ii) vegla, matrica, kallëpe e artikuj të ngjashëm, të përdorur për prodhimin e mallrave të importuara,

iii) materiale të harxhuara për prodhimin e mallrave të importuara,

iv) puna inxhinierike dhe zhvilluese, punimet artistike, puna projektuese dhe vizatimet e skicat të kryera jashtë Republikës së Shqipërisë dhe të nevojshme për prodhimin e mallrave të importuara;

c) pagesa mbi të drejtën e pronësisë intelektuale (royalties) dhe pagesa për të drejtën e licencës (license fee), që lidhen me mallrat që po vlerësohen, që blerësi duhet të paguajë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, si kusht i shitjes së mallrave që po vlerësohen, në masën që ato nuk janë përfshirë në çmimin realisht të paguar ose që duhet paguar;

d) vlera e çdo pjese të fitimit nga çdo rishitje, tjetërsim ose përdorim i mëvonshëm i mallrave të importuara që i shkon drejtpërsëdrejti ose tërthorazi shitësit;

e) i) shpenzimet e transportit e të sigurimit për mallrat e importuara, dhe

ii) shpenzimet e ngarkimit e të trajtimit që lidhen me transportin e mallrave të importuara, deri në vendin e hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Shtesat në çmimin realisht të paguar ose që duhet paguar, sipas këtij neni, bëhen vetëm në bazë të të dhënave objektive e të llogaritshme.

2.1 Ne percaktimin e vleres doganore nuk mund t'i behet asnje shtese çmimit realisht te paguar ose qe duhet te paguhet, perveç rasteve te permendura ne kete nen. (ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

3. Në funksion të këtij kreu, shprehja “komision blerjeje” do të thotë pagesë që një importues i bën agjentit të tij për shërbimin e përfaqësimit në blerjen e mallrave që duhen vlerësuar.

4. Pavarësisht nga çka parashikohet në paragrafin 1(c):

a) pagesat për të drejtën e riprodhimit të mallrave të importuara në Republikën e Shqipërisë nuk i shtohen çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar për mallrat e importuara, gjatë përcaktimit të vlerës doganore; dhe

b) pagesat e bëra nga blerësi për të drejtën e shpërndarjes ose të rishitjes së mallrave të importuara nuk i shtohen çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar për mallrat e importuara, në qoftë se këto pagesa nuk janë një kusht për shitjen e mallrave për eksport drejt Republikës së Shqipërisë.

c) Pagesat për të drejtën e pronësisë intelektuale (royalities) dhe për të drejtën e licencës (licence fee) për filmat kinematografikë të importuar në Republikën e Shqipërisë me të drejtën e riprodhimit dhe të shpërndarjes, nuk do t'i shtohen çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar. (ndryshuar me ligjin Nr.8719, datë 19.12.2000)

## Neni 38

1. Me kusht që të jenë të shprehura veças prej çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar për mallrat e importuara, në vlerën doganore nuk përfshihen elementet e mëposhtëm:

a) shpenzimet e transportit të mallrave, pas mbërritjes së tyre në pikën e hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) shpenzimet për ndërtimin, ngritjen, montimin, mirëmbajtjen ose asistencën teknike, të ndërmarra pas importimit të mallrave të tilla, si për shembull komplekse industriale, makineri ose pajisje;

c) pagesa interesash, që rrjedhin nga një marrëveshje financiare e bërë nga blerësi dhe që lidhet me blerjen e mallrave të importuara, pavarësisht nëse financimi mund të jetë bërë nga vetë shitësi ose nga një person tjetër, por me kusht që marrëveshja financiare të jetë bërë me shkrim dhe kur kërkohet, blerësi të jetë në gjendje të vërtetojë se:

i) këto mallra janë shitur realisht, me çmimin e deklaruar si çmim faktikisht i paguar ose që duhet paguar, dhe

ii) norma e interesit të pretenduar nuk e kalon normën mbizotëruese për transaksione të tilla në vendin ku, dhe në çastin kur, është siguruar financimi;

d) shpenzimet për të drejtën e riprodhimit në Republikën e Shqipërisë të mallrave të importuara;

e) komisionet e blerjes;

f) detyrime importi dhe pagesa të tjera që duhen paguar në Republikën e Shqipërisë për arsye të importimit ose të shitjes së mallrave.

## Neni 39

Për përcaktimin e vlerës doganore të sistemeve mbartëse, që përdoren në pajisjet e përpunimit të të dhënave dhe që përmbajnë të dhëna ose instruksione, përcaktohen rregulla të posaçme në aktet nëligjore në zbatim të këtij Kodi.

## Neni 40

(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Dispozitat e këtij kreu nuk cenojnë zbatimin e dispozitave të veçanta që kanë të bëjnë me përcaktimin e vlerës së mallrave të vendosura në qarkullim të lirë, pasi u është caktuar një destinacion tjetër doganor.

2. Vlera doganore e mallrave qe prishen shpejt, te cilat zakonisht dergohen me konsenjacion me kerkese te deklaruesit, mund te percaktohet me procedure te thjeshtuar, pa iu nenshtruar kritereve te vleresimit te parashikuara ne nenet 34, 35 dhe 36.

3. Kur lind nevoja që të përcaktohet vlera doganore e mallrave të importuara dhe kjo vlerë është e shprehur në një njësi monetare të ndryshme nga Leku shqiptar, përdoret procedura e mëposhtme:

a) Kursi i ri i shkëmbimit valutor përcaktohet çdo muaj, me përjashtim të rasteve të përmendura në paragrafin 3 (d).

b) Kursi i shkëmbimit do të jetë i vlefshëm duke filluar nga data 6 e çdo muaji deri në datën 5 të

muajit pasardhës.

c) Kursi i shkëmbimit që do të përdoret do të jetë kursi i shkëmbimit i shpallur nga Banka e Shqipërisë në ditën e fundit të punës së muajit paraardhës të periudhës së përmendur në paragrafin 3 (b).

d) Kur kursi ditor i shkëmbimit, i shpallur nga Banka e Shqipërisë, është 5 për qind më i madh ose më i vogël se ai i vendosur në përputhje me paragrafin 3 (c), për t'u përdorur në përputhje me paragrafin 3 (b), ky i fundit do të zëvendësohet nga kursi ditor dhe do të hyjë në fuqi në ditën e dytë pas shpalljes dhe do të përdoret si kurs shkëmbimi në zbatim të nenit 27 për të gjithë periudhën e mbetur.

## PJESA III
## DISPOZITA TË ZBATUESHME PËR MALLRAT QË HYJNË DHE DALIN NGA TERRITORI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DERISA T'U CAKTOHET NJË DESTINACION DOGANOR

### KREU 1
### HYRJA DHE DALJA E MALLRAVE NË TERRITORIN DOGANOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

#### Neni 41

1. "Çast i hyrjes" ose "çast i daljes" quhet çasti i kalimit të mallrave, pavarësisht nga mënyra e transportimit, në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë, për të hyrë në territorin doganor të saj ose për të dalë prej tij.

2. "Manifest i mallrave" është dokumenti që shoqëron mallrat që hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë ose dalin prej tij, në rrugë ajrore, detare, nëpërmjet lumenjve ose liqeneve. Ky dokument duhet të përmbajë të dhënat mbi shtetësinë, flamurin dhe ekuipazhin e mjetit të transportit, si dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për identifikimin e ngarkesës, siç parashikohet në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

3. Mallrat që futen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore që nga çasti i hyrjes. Ato mund t'i nënshtrohen kontrolleve nga autoritetet doganore.

4. Këto mallra mbeten nën këtë mbikëqyrje për aq kohë sa është e nevojshme për të përcaktuar statusin e tyre doganor dhe, në rastin e mallrave joshqiptare dhe pa rënë ndesh me nenin 105(1), derisa statusi doganor i këtyre mallrave të ndryshojë, ose ato të futen në një zonë të lirë ose magazinë të lirë, ose të rieksportohen, ose të shkatërrohen, ose të braktisen e të kalojnë në favor të buxhetit të shtetit.

#### Neni 42

1. Mallrat e sjella në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë duhet të çohen pa humbur kohë nga personi që i transporton ato dhe në rrugën e përcaktuar nga autoritetet doganore e sipas udhëzimeve të tyre, nëse ka të tilla:

a) në zyrën doganore të caktuar nga autoritetet doganore ose në cilindo vend tjetër të caktuar ose miratuar prej tyre; ose

b) në një zonë të lirë, nëse mallrat duhen të futen në atë zonë të lirë drejtpërsëdrejti me rrugë ujore, ajrore ose tokësore.

2. Personi që merr përsipër përgjegjësinë e transportimit të mallrave pas hyrjes së tyre në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, edhe si rezultat i një transbordimi, është përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në paragrafin 1.

3. Paragrafi 1(a) nuk përjashton zbatimin e çfarëdo dispozite në fuqi për trafikun turistik, trafikun kufitar, trafikun postar ose trafikun me rëndësi ekonomike të papërfillshme, me kusht që veprimtaritë e mbikëqyrjes dhe mundësitë e kontrollit doganor të mos cenohen.

4. Kriteret e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, përderisa ato nuk vijnë në kundërshtim me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë, nuk zbatohen për mallrat në bordin e anijeve ose të mjeteve ajrore që përshkojnë ujërat ose hapësirën ajrore territoriale të Republikës së Shqipërisë, pa pasur si destinacion të tyre një port ose aeroport të vendosur në Republikën e Shqipërisë. Në çdo rast, autoritetet doganore mund të marrin të gjitha masat dhe të kryejnë të gjitha kontrollet e nevojshme për t'u siguruar që mallrat e transportuara nga mjetet e përmendura më lart të mos futen ilegalisht në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 43

1. Kur, për shkak të rrethanave të paparashikueshme ose fuqie madhore, detyrimi i parashikuar në nenin 42(1) nuk mund të përmbushet, personi që ka këtë detyrim ose çdo person tjetër që vepron në emër të tij duhet të njoftojë pa humbur kohë autoritetet doganore për gjendjen. Në rast se situata e paparashikuar ose

fuqia madhore nuk shkakton humbjen e plotë të mallrave, autoritetet doganore duhet të informohen për vendndodhjen e saktë të mallrave.

2. Kur, për shkak të rrethanave të paparashikueshme ose fuqie madhore, një mjet lundrues ose mjet ajror sipas nenit 42(4) detyrohet të futet përkohësisht në port ose të zbresë në tokë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe nuk mund të përmbushet detyrimi i parashikuar në nenin 42(1) personi, që fut mjetin lundrues ose mjetin ajror në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë ose çdo person tjetër që vepron për llogari të tij, duhet të informojë pa humbur kohë autoritetet doganore për gjendjen.

3. Autoritetet doganore përcaktojnë masat që duhen marrë për të bërë të mundur mbikëqyrjen doganore të mallrave të përmendura në paragrafin 1, si dhe ato në bordin e anijeve ose të mjeteve ajrore në rrethanat e përcaktuara në paragrafin 2, dhe të sigurojnë, kur është e nevojshme, që këto mallra të transportohen më pas pranë një zyre doganore ose një vendi tjetër të caktuar ose miratuar nga autoritetet doganore.

## KREU 2
## DISPOZITA TË VEÇANTA TË ZBATUESHME PËR MALLRAT QË HYJNË OSE DALIN NGA TERRITORI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË DËRGUARA NË RRUGË AJRORE, DETARE OSE HEKURUDHORE DHE NËPËRMJET TRAFIKUT TË UDHËTARËVE E TRAFIKUT POSTAR

### A. Dispozita të përgjithshme
### Neni 44

1. Kur mallrat futen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga një vend i huaj në rrugë ajrore, detare ose hekurudhore dhe dërgohen të shoqëruara me një dokument të vetëm transporti, pa transbordim dhe me të njëjtat mënyra transporti, drejt një porti ose aeroporti tjetër në Republikën e Shqipërisë, ato duhet të paraqiten në doganë, për qëllim të nenit 65 të këtij Kodi, vetëm në portin, areoportin ose stacionin hekurudhor në të cilin ato shkarkohen ose transbordohen.

2. Norma më të specifikuara në lidhje me mbikëqyrjen, kontrollin dhe formalitetet doganore që duhen kryer në çastin e hyrjes e të daljes së mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, jepen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

### B. Trafiku ajror
### Neni 45

1. Mjetet ajrore që hyjnë në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë mund të fluturojnë në rrugët ajrore të përcaktuara nga autoritetet përgjegjëse për trafikun ndërkombëtar dhe mund të ulen e të ngrihen nga areoportet ndërkombëtare të miratuara për trafik ajror me vendet e huaja.

2. Komandanti i mjetit ajror, para se të largohet nga aeroporti i autorizuar, siç parashikohet në paragrafin 1, duhet të paraqesë pranë zyrës doganore kompetente manifestin e mallrave, për të gjitha mallrat që do të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë. Autoritetet doganore mund të ushtrojnë të gjitha kontrollet e nevojshme për të verifikuar nëse të gjitha mallrat e deklaruara në manifest janë ngarkuar efektivisht në mjetin ajror.

### Neni 46

1. Mjetet ajrore, ekuipazhet e tyre, bagazhet e ekuipazheve, udhëtarët, bagazhet e udhëtarëve dhe mallrat e transportuara janë objekt i mbikëqyrjes së autoriteteve doganore në aeroportin më të parë, kur mbërrijnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Një aeroport i autorizuar për trafik ndërkombëtar i nënshtrohet mbikëqyrjes së autoriteteve doganore.

3. Kapiteni i mjetit ajror ose një person i autorizuar prej tij, sapo mjeti ajror ulet në një aeroport të autorizuar, duhet të paraqesë në zyrën doganore kompetente manifestin për të gjitha mallrat e transportuara.

4. Ndalohet që mjetet ajrore të hedhin mallra gjatë fluturimit.

### Neni 47

Paraqitja e manifestit të mallrave autoriteteve doganore nuk është e nevojshme në rastet e mëposhtme:

a) Për mjetet ajrore që fluturojnë nga një aeroport i Republikës së Shqipërisë në një tjetër brenda saj, pa ndonjë ndalesë në një aeroport jashtë Republikës së Shqipërisë, me kusht që të mos transportojnë mallra që janë objekt kontrolli e mbikëqyrjeje doganore.

b) Për mjetet ajrore ushtarake.

c) Për mjetet ajrore private, të përdorimit vetjak, në rast se një mjet i tillë nuk transporton mallra që i nënshtrohen mbikëqyrjes ose kontrollit doganor.

Neni 48

Autoritetet doganore të aeroportit të mbërritjes ushtrojnë mbikëqyrjen doganore mbi mjetin ajror sapo ai të ulet dhe kryejnë të gjitha kontrollet e formalitetet që zbatohen për:

a) kabinën dhe bagazhin e ekuipazhit;

b) bagazhet e udhëtarëve, përfshirë edhe bagazhet e dorës.

Neni 49

Mbikëqyrja dhe kontrolli nga autoritetet doganore i mjetit ajror, i ekuipazhit, i kabinës së ekuipazhit, i udhëtarëve e i bagazheve të tyre dhe i mallrave që nisen në një destinacion jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, kryhet në aeroporte të autorizuara për fluturime ndërkombëtare.

Neni 50

Në qoftë se, në rast rrethanash të paparashikuara ose forcë madhore, një mjet ajror duhet të ulet në një aeroport të paautorizuar për trafik ajror ndërkombëtar, kapiteni i mjetit ajror, informon zyrën doganore më të afërt, e cila vendos mjetin ajror, ekuipazhin, udhëtarët dhe mallrat nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e autoriteteve doganore.

**C. Trafiku ujor**

Neni 51

1. Mjetet lundruese, që transportojnë mallra për në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, mund të ankorohen vetëm në porte të miratuara për trafik ndërkombëtar.

2. Në raste rrethanash të paparshikueshme ose force madhore, mjetet lundruese të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, mund të ankorohen edhe në pika të tjera. Kapiteni i mjetit lundrues informon zyrën doganore më të afërt ose autoritetet publike më të afërta, të cilat raportojnë menjëherë pranë autoriteteve doganore më të afërta.

Neni 52

1. Mjetet lundruese, të cilat transportojnë mallra që hyjnë në/ose dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë dhe që lundrojnë në zonën doganore kufitare në det, liqene e lumenj të lundrueshëm, duhet të kenë në bord manifestin e mallrave të përmendur në nenin 41(2), përveç rasteve kur parashikohet ndryshe.

2. Një dokument tjetër ose një grup dokumentesh, të cilat përmbajnë informacionin e kërkuar për manifestin, mund të pranohen si manifest sipas akteve nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

3. Nuk kanë nevojë të kenë manifest mallrash mjetet lundruese të mëposhtme:

a) Mjetet lundruese të përdorura për qëllime shkencore.

b) Mjetet lundruese të peshkimit të përdorura vetëm për peshkim.

c) Mjetet lundruese sportive e private, me kusht që të mos transportojnë mallra që janë objekt kontrolli doganor.

Neni 53

1. Mbikëqyrja doganore fillon menjëherë sapo mjeti lundrues ankorohet, arrin në radë ose hyn në port dhe vazhdon deri në çastin kur mallrat shkarkohen nga mjeti lundrues për t'iu caktuar një destinacion doganor.

2. Menjëherë pas përfundimit të inspektimit policor dhe atij fitosanitar, autoritetet doganore mund të ushtrojnë të gjitha kontrollet e nevojshme në bordin e mjetit lundrues.

Neni 54

Kapiteni i mjetit lundrues duhet të paraqesë pranë autoriteteve doganore manifestin e mallrave, sipas procedurave të parashikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, brenda 24 orëve nga mbërritja e mjetit lundrues në radë ose në port.

Neni 55

1. Transbordimi i mallrave nga një mjet në një mjet tjetër duhet të miratohet nga autoritetet doganore dhe duhet të kryhet nën mbikëqyrjen doganore.

2. Në raste rrethanash të paparashikueshme mallrat mund të transbordohen nga një mjet lundrues në një tjetër pa autorizimin e autoriteteve doganore. Në raste të tilla kapiteni i mjetit lundrues duhet t'i kërkojë autoriteteve kompetente detare ose portuale një vërtetim, ku shpjegohen arsyet e transbordimit. Ky dokument i paraqitet menjëherë autoriteteve doganore kompetente.

3. Autoritetet doganore kompetente që marrin këtë dokument duhet të sigurohen se nuk ka pasur shkelje të karakterit doganor. Në rast se ka pasur, ata marrin vendimet përkatëse sipas procedurave të pjesës VIII të këtij Kodi.

Neni 56

Mjetet lundruese që transportojnë mallra që hyjnë ose dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet liqeneve ose lumenjve, mund të mbërrijnë vetëm në/ose të nisen vetëm nga, pikat e autorizuara prej autoriteteve doganore. Këto mjete lundruese u nënshtrohen të njëjtave formalitete të parashikuara nga nenet 51 deri 55 të këtij Kodi.

Neni 57

Mjetet lundruese të huaja në tranzit, të cilat ndalojnë në porte shqiptare detare, liqenore ose lumore për t’u furnizuar me karburant, ushqime ose pajisje të tjera, por jo për të ngarkuar ose shkarkuar mallra, përjashtohen nga kontrolli doganor dhe vendosen vetëm nën mbikëqyrje doganore.

Neni 58

1. Mjetet lundruese shqiptare që kryejnë shërbime të rregullta midis dy zonave doganore kufitare brenda territorit doganor shqiptar, të autorizuara për transport mallrash ose udhëtarësh, nuk paraqesin manifest të mallrave, me kusht që ato të mos jenë objekt i kontrollit dhe i mbikëqyrjes doganore.

2. Në çdo rast autoritetet doganore, në zonën e mbikëqyrjes doganore mund të kryejnë të gjitha kontrollet e nevojshme për verifikimin e shkeljeve të mundshme të dispozitave të këtij Kodi dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

**D. Trafiku hekurudhor**

Neni 59

1. Shoqëria hekurudhore, që pranon të fusë me rrugë hekurudhore në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë mallra të shoqëruara me një dokument dorëzimi, është organi përgjegjës për kryerjen e formaliteteve doganore përkatëse.

2. Shoqëria hekurudhore vë në dispozicion të administratës doganore gjithë dokumentet e mbajtura pranë zyrës së financës, në lidhje me mallrat e transportuara.

3. Në transportin e udhëtarëve me rrugë hekurudhore, autoritetet doganore kryejnë të gjitha kontrollet në pikat e kalimit të kufirit tokësor hekurudhor mbi udhëtarët dhe bagazhet e tyre, si dhe në kabinën e drejtimit, mbi personelin dhe bagazhet e tij.

**E. Mallrat postare**

Neni 60

1. Gjithë posta që përmban dërgesa për qëllime tregtare, si dhe gjithë posta që përfshin dërgesa me një vlerë të përgjithshme për çdo dërgesë që e kapërcen kufirin e përcaktuar në dispozitat në fuqi të nxjerra nga ministri i Financave, i nënshtrohen deklarimit në doganë.

2. Mallrat e dërguara me rrugë postare midis një zyrë postare të huaj dhe një zyrë postare shqiptare pranohen e dërgohen nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore. Në rastet e dërgesave të përshpejtuara, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave mund të autorizojë çlirimin e menjëhershëm të mallrave kundrejt dhënies së një garancie dhe depozitimit të një deklarate të posaçme periodike dhe përmbledhëse, sipas formës së përcaktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

3. Zyrat postare duhet t’i përcjellin të gjitha ngarkesat, të cilat përmbajnë mallra që futen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nën mbikëqyrjen doganore, në zyrat postare të caktuara nga autoritetet doganore për kryerjen e kontrolleve të nevojshme.

4. Dërgesat postare mbeten nën mbikëqyrjen doganore gjatë gjithë kohës së plotësimit të formaliteteve doganore pranë zyrës postare.

Neni 61

Nuk i nënshtrohen deklarimit në doganë dërgesat postare të mëposhtme:

a) Kartolinat dhe letrat që përmbajnë vetëm mesazhe vetjake.

b) Materialet e botuara që nuk u nënshtrohen detyrimeve të importit.

c) Letra të shkruara në sistemin e leximit për të verbërit, dhe

d) çdo lloji dërgese tjetër që dërgohet me letër ose pako postare, që përjashtohet nga detyrimi për t'u paraqitur në zyrën doganore në përputhje me nenin 42 (3) të këtij Kodi.

Neni 62

Autoritetet doganore përcaktojnë në përputhje me këtë Kod, kushtet, kufizimet dhe mënyrat sipas të cilave zbatohen masat për ushtrimin e mbikëqyrjes doganore mbi dërgesat postare që dërgohen jashtë dhe që janë objekt i kontrollit të autoriteteve doganore.

**F. Trafiku i udhëtarëve**

Neni 63

Në funksion të këtij kreu, termi "udhëtar" do të thotë:

**A. Në hyrje**

1. Çdo person që hyn përkohësisht në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, duke mos qenë normalisht banues në këtë territor, dhe

2. çdo person që kthehet në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në të cilin normalisht ai është banues, pasi ka qëndruar përkohësisht në një vend të huaj;

**B. Në dalje**

1. Çdo person që largohet përkohësisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ku ai është normalisht banues, dhe

2. çdo person, që pas një qëndrimi të përkohshëm largohet nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ku ai nuk është normalisht banues.

Neni 64

1. Gjatë hyrjes ose daljes nga Republika e Shqipërisë, udhëtari duhet të deklarojë dhe me kërkesë të autoriteteve doganore, duhet të tregojë të gjitha mallrat që transporton.

2. Për të verifikuar deklarimin, të cilit i referohet paragrafi 1 i këtij neni, autoritetet doganore, në qoftë se është e nevojshme, mund të kontrollojnë mallrat që transporton udhëtari.

3. Mallrat e transportuar nga korrierët diplomatikë, të shoqëruara me një notë diplomatike, nuk i nënshtrohen kontrollit doganor. Gjithashtu, nuk i nënshtrohen kontrollit doganor deputetët dhe çdo person tjetër që me ligj i është dhënë status i veçantë, si dhe bagazhet dhe posta që iu dërgohet këtyre personave. Kjo dispozitë zbatohet edhe për çdo person tjetër që, sipas dispozitave të tjera në fuqi, mund të përfitojë një përjashtim të tillë.

KREU 3

PARAQITJA E MALLRAVE NË DOGANË

Neni 65

Mallrat, që sipas nenit 42(1)(a) mbërrijnë në zyrën doganore ose në një vend tjetër të caktuar ose miratuar nga autoritetet doganore, paraqiten në doganë nga personi që i ka sjellë këto mallra në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë ose, kur është rasti, nga personi që ka përgjegjësinë e transportimit të mallrave pas hyrjes së tyre:

i) kur transportohen në rrugë detare brenda dy orëve nga mbërritja, dhe

ii) kur transportohen në rrugë të tjera të ndryshme nga ajo detare brenda një ore pas mbërritjes.

Neni 66

Neni 65 nuk përjashton zbatimin e legjislacionit në fuqi në lidhje me mallrat e transportuara nga udhëtarët.

Neni 67

Mallrat, pasi të jenë paraqitur në doganë dhe me lejen e autoriteteve doganore, mund të kontrollohen ose mund të merren mostra, me qëllim që t'u caktohet një destinacion doganor. Kjo leje i jepet personit të autorizuar për t'u caktuar mallrave këtë destinacion, kundrejt një kërkese me shkrim.

## KREU 4
## DEKLARATA PËRMBLEDHËSE DHE SHKARKIMI I MALLRAVE QË PARAQITEN NË DOGANË

### Neni 68

1. Pa rënë ndesh me dispozitat e nenit 70, mallrat e paraqitura në doganë sipas rregullave që parashikon neni 65, shoqërohen nga një deklaratë përmbledhëse që duhet të depozitohet:

i) kur transportohen në rrugë detare, brenda dy orëve nga paraqitja e mallrave në doganë, dhe

ii) kur transportohen në rrugë të tjera të ndryshme nga ajo detare, brenda një ore pas paraqitjes së mallrave në doganë.

2. Deklarata përmbledhëse depozitohet pranë autoriteteve doganore brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 1(i) dhe (ii). Megjithatë, autoritetet doganore mund të lejojnë njëfarë kohe për depozitimin e deklaratës, por jo më vonë se dita e parë e punës që pason ditën e paraqitjes së mallrave në doganë.

### Neni 69

1. Deklarata përmbledhëse bëhet në formën që i korrespondon modelit të përcaktuar nga autoritetet doganore. Megjithatë, autoritetet doganore mund të lejojnë përdorimin si deklaratë përmbledhëse të çfarëdo dokumenti tregtar ose zyrtar që përmban të dhënat e nevojshme për identifikimin e mallrave, siç parashikohet në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

2. Deklarata përmbledhëse depozitohet nga:

a) personi që i ka sjellë mallrat në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë ose nga cilido person që merr përsipër transportimin e mallrave pas hyrjes së tyre në këtë territor, ose

b) personi në emër të të cilit kanë vepruar personat e përmendur në nënparagrafin (a).

### Neni 70

Pa rënë ndesh me dispozitat për mallrat e importuara nga udhëtarë dhe dërgesat postare e kolipostare, autoritetet doganore mund të mos kërkojnë depozitimin e një deklarate përmbledhëse, me kusht që një gjë e tillë të mos pengojë mbikëqyrjen doganore të mallrave dhe që formalitetet e nevojshme për caktimin e destinacionit doganor të jenë kryer para përfundimit të afatit të përmendur në nenin 68.

### Neni 71

1. Mallrat shkarkohen ose transbordohen, nga mjetet e transportit me të cilat janë sjellë, vetëm me leje të autoriteteve doganore dhe në vendet e caktuara ose të miratuara prej tyre. Megjithatë, nuk kërkohet leje në rast rreziku të pashmangshëm, kur shkarkimi i menjëhershëm i gjithë mallit ose i një pjese të tij është i domosdoshëm. Në këtë rast, njoftohen menjëherë autoritetet doganore.

2. Me qëllim që të kontrollohen mallrat dhe mjetet e transportit që i kanë sjellë ato, autoritetet doganore mund të kërkojnë në çdo kohë shkarkimin e shpaketimin e mallrave.

3. Kur autoritetet doganore kanë dyshime se është kryer një shkelje doganore, atyre u lejohet të kontrollojnë mjetet e transportit dhe mallrat që kanë hyrë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, edhe para se të jetë depozituar deklarata përmbledhëse. Personi që ka futur mallra, personi që ka marrë përsipër transportin e mallrave pas hyrjes ose deklaruesi ka të drejtën të jetë i pranishëm gjatë kohës që bëhet kontrolli i mallrave. Autoritetet doganore duhet të njoftojnë personin përkatës se ato synojnë të kryejnë kontroll. Nëse brenda 2 orësh nga ky njoftim personi në fjalë nuk deklaron se ai do të jetë i pranishëm gjatë kontrollit, autoritetet doganore kryejnë kontrollin pa praninë e tij.

### Neni 72

Mallrat nuk duhen lëvizur nga vendosja e tyre fillestare pa autorizimin e autoriteteve doganore.

## KREU 5
## DETYRIMI PËR T'U CAKTUAR NJË DESTINACION DOGANOR MALLRAVE TË PARAQITURA NË DOGANË

Neni 73

Mallrave joshqiptare të paraqitura në doganë, duhet t'u caktohet një destinacion doganor që lejohet për këto mallra.

Neni 74

1. Kur mallrat mbulohen nga një deklaratë përmbledhëse, formalitetet e nevojshme për t'u caktuar atyre një destinacion doganor duhet të kryhen brenda afateve të mëposhtme:

a) Dhjetë ditë nga data kur depozitohet deklarata përmbledhëse, në rast se mallrat janë transportuar me rrugë detare.

b) Pesë ditë nga dita kur depozitohet deklarata përmbledhëse, në rast se mallrat janë transportuar me rrugë të tjera të ndryshme nga ajo detare.

2. Kur e justifikojnë rrethanat, autoritetet doganore mund të caktojnë një afat më të shkurtër ose të autorizojnë një zgjatje të afatit të përmendur në paragrafin 1. Megjithatë, kjo zgjatje nuk duhet të tejkalojë nevojat reale që justifikohen nga rrethanat.

KREU 6
MAGAZINIMI I PËRKOHSHËM I MALLRAVE

Neni 75

Nga çasti i paraqitjes së mallrave në doganë e deri në çastin e caktimit të një destinacioni doganor për to, këto mallra kanë statusin e mallrave në magazinim të përkohshëm. Që këtu e në vijim këto mallra do të përmenden si "mallra në magazinim të përkohshëm".

Neni 76

1. Mallrat në magazinim të përkohshëm ruhen në zona doganore ose në vende të tjera të miratuara nga autoritetet doganore, ku mund të qëndrojnë brenda afateve të përcaktuara në nenin 74.

2. Autoritetet doganore mund t'i kërkojnë mbajtësit të mallrave, paraqitjen e një garancie me qëllim që të sigurohet pagesa e çdo borxhi doganor që mund të lindë sipas nenit 218 ose 219.

Neni 77

Pa rënë ndesh me dispozitat e nenit 67, mallrat në magazinim të përkohshëm u nënshtrohen vetëm përpunimeve të tilla që synojnë sigurimin e ruajtjes së këtyre mallrave në gjendje të pandryshuar, pa modifikuar pamjen e jashtme ose karakteristikat teknike të tyre.

Neni 78

1. Autoritetet doganore, pa humbur kohë, marrin të gjitha masat e nevojshme, përfshirë këtu edhe shitjen e mallrave, për të rregulluar situatën e tyre, në rastet kur formalitetet e nevojshme për t'u caktuar mallrave destinacionin doganor nuk kanë filluar brenda afateve të caktuara në përputhje me nenin 74.

2. Autoritetet doganore mund të transferojnë mallrat në një vend të veçantë që është nën mbikëqyrjen e tyre, me rrezikun e me shpenzimet e mbajtësit të mallrave, derisa të rregullohet situata e mallrave.

KREU 7
DISPOZITA TË ZBATUESHME PËR MALLRAT JOSHQIPTARE QË KANË QARKULLUAR NËN REGJIMIN E TRANZITIT

Neni 79

Neni 42, me përjashtim të paragrafit 1 (a) dhe nenet 43 dhe 65 deri 78 nuk zbatohen kur mallrat e vendosura më parë nën regjimin e tranzitit hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 80

Sapo mallrat joshqiptare, që kanë qarkulluar nën regjimin e tranzitit, mbërrijnë në destinacionin e tyre në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe paraqiten në doganë në përputhje me dispozitat për tranzitin, zbatohen nenet 68 deri 78 të këtij Kodi.

KREU 8
DISPOZITA TË TJERA

Neni 81

Kur e kërkojnë rrethanat, në rastet e rrezikut për jetën ose shëndetin e njerëzve apo të ndotjes së mjedisit, autoritetet doganore mund të shkatërrojnë mallrat e paraqitura në doganë. Autoritetet doganore informojnë për këtë mbajtësin e mallrave. Shpenzimet e shkatërrimit të mallrave paguhen nga mbajtësi i mallrave.

Neni 82

1. Kur autoritetet doganore konstatojnë se mallrat janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në mënyrë të parregullt ose i janë shmangur mbikëqyrjes doganore, autoritetet doganore marrin të gjitha masat e nevojshme, përfshirë këtu edhe shitjen e mallrave, në mënyrë që të rregullojnë situatën e tyre, përveç zbatimit të sanksioneve të parashikuara në pjesën VIII të këtij Kodi.

2. Kur mallrat joshqiptare, që qarkullojnë nën regjimin e tranzitit, mbërrijnë në destinacion në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë parregullsisht ose i janë shmangur mbikëqyrjes doganore, autoritetet doganore marrin të gjitha masat e nevojshme, përfshirë këtu edhe shitjen e mallrave, në mënyrë që të rregullojnë situatën e tyre, përveç zbatimit të sanksioneve të parashikuara në pjesën VIII të këtij Kodi.

3. Kufizimi ose licencimi i importeve, eksporteve ose tranzitimit të mallrave të veçantë, me qëllim mbrojtjen e interesave ekonomike e publike, mund të bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Autoritetet doganore, me kërkesë të zotëruesit të një marke fabrikimi ose licencë prodhimi, ose edhe të të drejtave të tjera të specifikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, mund të ndalojnë vënien në qarkullim të lirë, eksportimin, rieksportimin dhe vendosjen në një regjim të caktuar pezullues mallrat e njohura si të falsifikuara ose pirate, sipas procedurave të parashikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

PJESA IV
DESTINACIONI DOGANOR

KREU 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 83

1. Përveç rasteve kur me vendim të Këshillit të Ministrave është parashikuar ndryshe, mallrave mund t’u jepet, në çdo kohë dhe sipas kushteve të përcaktuara, një destinacion doganor, pavarësisht nga lloji ose sasia, vendi i origjinës ose destinacioni.

2. Paragrafi 1 nuk përjashton zbatimin e ndalimeve, të vendosura nga Këshilli i Ministrave, ose të kufizimeve të justifikuara nga motive të moralit publik, të politikave publike ose të sigurimit publik, të mbrojtjes së shëndetit e të jetës së njerëzve, të kafshëve ose të bimëve, të mbrojtjes së pasurisë kombëtare me vlera artistike, historike ose arkeologjike ose të mbrojtjes së pronësisë industriale e tregtare.

KREU 2
REGJIMET DOGANORE

SEKSIONI 1
VENDOSJA E MALLRAVE NËN NJË REGJIM DOGANOR

Neni 84

1. Të gjitha mallrat që duhet të vendosen nën një regjim doganor duhet të mbulohen nga një deklaratë për këtë regjim doganor brenda afateve të përcaktuara në nenin 74.

2. Mallrat shqiptare të deklaruara për eksport, përpunim pasiv, tranzit ose regjim magazinimi doganor i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore nga çasti i pranimit të deklaratës doganore, deri në çastin e daljes nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ose derisa të shkatërrohen ose derisa deklarata doganore cilësohet e pavlefshme.

Neni 85

Në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi ose me dispozita të nxjerra nga ministri i Financave, me

propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, përcaktohen rregulla të veçanta për kompetencat e autoriteteve doganore e të zyrave të ndryshme doganore, duke mbajtur parasysh natyrën e mallrave dhe regjimet doganore nën të cilat këto mallra duhet të vendosen.

Neni 86

Deklarimi në doganë duhet të bëhet:
a) me shkrim; ose
b) duke përdorur teknikën e përpunimit të të dhënave, kur një gjë e tillë parashikohet me dispozita të posaçme; ose
c) nëpërmjet një deklarimi gojor; ose përmes çdo veprimi tjetër me anë të të cilit personi përgjegjës për mallrat shpreh dëshirën e tij për t'i vendosur ato nën një regjim doganor, nëse një mundësi e tillë parashikohet në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

**A. Deklarata me shkrim**
Neni 87

1. Deklarata me shkrim bëhet sipas një formulari që i korrespondon modelit zyrtar të përpiluar për këtë qëllim. Ajo duhet të nënshkruhet dhe të përmbajë të gjitha të dhënat e nevojshme për zbatimin e dispozitave që rregullojnë regjimin doganor, për të cilin mallrat janë deklaruar.
2. Deklarata duhet të shoqërohet me të gjitha dokumentet e kërkuara për zbatimin e dispozitave që rregullojnë regjimin doganor, për të cilin mallrat janë deklaruar.

Neni 88

Deklaratat që plotësojnë kërkesat e parashikuara në nenin 87 pranohen nga autoritetet doganore menjëherë, me kusht që mallrat, të cilave ato u referohen, të jenë paraqitur në doganë.

Neni 89
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Pa rënë ndesh me nenit 17, deklarata doganore mund të bëhet nga çdo person që është në gjendje të paraqesë ose që bën të mundur paraqitjen e mallrave pranë autoriteteve doganore kompetente, së bashku me të gjitha dokumentet e kërkuara për zbatimin e dispozitave mbi regjimin doganor, për të cilin mallrat janë deklaruar.
2. Megjithatë,
a) kur pranimi i një deklarate doganore sjell si pasojë detyrime të veçanta mbi një person të caktuar, deklarata duhet bërë nga vetë personi ose nga ai person që vepron për llogari të tij;
b) deklaruesi duhet të jetë i vendosur në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, kushti që lidhet me vendosjen në Republikën e Shqipërisë nuk zbatohet për personat të cilët bëjnë deklaratë për mallra që kalojnë tranzit nëpër territorin doganor të Republikës së Shqipërisë me destinacion një vend të tretë, ose që bëjnë deklaratë lejimi të përkohshëm.
3. Paragrafi 2(b) nuk përjashton zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe midis Republikës së Shqipërisë dhe një vendi tjetër ose një grupi vendesh, në bazë të të cilave shtetasit e këtyre vendeve mund të bëjnë deklarata doganore në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 90

1. Me kërkesën e tij deklaruesi mund të lejohet nga autoritetet doganore të korrigjojë një ose më shumë të dhëna të deklaratës, pasi ajo të jetë pranuar nga dogana. Korrigjimi nuk duhet ta bëjë deklaratën të zbatueshme për mallra, të ndryshme nga ato që janë deklaruar fillimisht në të.
2. Megjithatë, asnjë korrigjim nuk lejohet, kur autorizimi kërkohet pasi autoritetet doganore:
a) kanë njoftuar deklaruesin që do të kontrollojnë mallrat; ose,
b) kanë arritur në përfundimin që të dhënat në fjalë janë të pasakta; ose,
c) kanë çliruar mallrat.

Neni 91

1. Me kërkesë të deklaruesit, autoritetet doganore e shpallin të pavlefshme deklaratën doganore të pranuar më parë, kur deklaruesi paraqet prova që mallrat ishin deklaruar gabimisht për regjimin doganor të treguar në deklaratë ose kur, për shkak të rrethanave të veçanta, nuk justifikohet me vendosjen e mallrave nën

regjimin doganor të treguar në deklaratë. Megjithatë, kur autoritetet doganore e kanë informuar deklaruesin se do të kontrollojnë mallrat, kërkesa e anulimit të deklaratës nuk pranohet deri në përfundimin e kontrollit.

2. Pasi mallrat të jenë çliruar, deklarata nuk mund të bëhet e pavlefshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

3. Pavlefshmëria e deklaratës nuk bie ndesh me zbatimin e sanksioneve të parashikuara në pjesën VIII të këtij Kodi.

Neni 92

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, data e pranimit të deklaratës nga autoritetet doganore përdoret si datë e zbatimit të të gjitha dispozitave që lidhen me regjimet doganore, për të cilët mallrat janë deklaruar.

Neni 93

Për të kryer verifikimin e deklaratave të pranuara, autoritetet doganore mund:

a) të shqyrtojnë dokumentet në mbështetje të deklaratës dhe dokumentet shoqëruese. Autoritetet doganore mund t'i kërkojnë deklaruesit të paraqesë dokumente të tjera për të verifikuar saktësinë e të dhënave të deklaratës;

b) të kontrollojnë mallrat dhe të marrin mostra për analiza ose për ekzaminime më të hollësishme.

Neni 94

1. Transporti i mallrave për në vendin ku do të kryhet kontrolli ose ku do të merren mostrat e ku kryhen të gjitha trajtimet e nevojshme për kontrollin ose marrjen e mostrave, bëhet nga deklaruesi ose nën përgjegjësinë e tij. Shpenzimet e rastit janë në ngarkim të deklaruesit.

2. Deklaruesi gëzon të drejtën të jetë i pranishëm gjatë kontrollit të mallrave dhe marrjes së mostrave. Kur e shohin të arsyeshme, autoritetet doganore i kërkojnë deklaruesit të jetë i pranishëm ose i përfaqësuar gjatë kontrollit të mallrave ose marrjes së mostrave, për t'u dhënë atyre ndihmën e nevojshme për lehtësimin e proceseve të mësipërme.

Neni 95

(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Rezultati i kontrollit te pjesshem te mallrave, qe perfshihen ne deklaraten doganore, merret i mireqene per te gjithe mallin e perfshire ne ate deklarate. Megjithate, deklaruesi mund te kerkoje kontroll te metejshem te mallrave, nese mendon qe rezultatet e kontrollit te pjesshem nuk jane te vlefshme per pjesen tjeter te mallit te deklaruar.

2. Për qëllim të zbatimit të paragrafit 1, kur formulari i deklaratës mbulon dy ose me shumë artikuj, të dhënat që lidhen me secilin nga artikujt, konsiderohen si pjesë përbërëse e një deklarate doganore më vete.

Neni 96

Rezultatet e verifikimit të deklaratës përdoren për zbatimin e dispozitave që rregullojnë regjimin doganor nën të cilin mallrat janë vendosur.

Neni 97

1. Autoritetet doganore marrin masat e nevojshme për të identifikuar mallrat, kur një identifikim i tillë është i nevojshëm për të garantuar respektimin e kushteve të regjimit doganor në të cilin mallrat janë deklaruar.

2. Shenjat identifikuese të vendosura mbi mallrat ose mjetet e transportit, mund të hiqen ose të shkatërrohen vetëm nga autoritetet doganore ose me autorizimin e tyre, me përjashtim të rastit kur, si rezultat i rrethanave të paparashikuara ose i një fuqie madhore, heqja ose shkatërrimi i tyre është i domosdoshëm për të garantuar mbrojtjen e mallrave ose të mjeteve të transportit.

Neni 98

1. Pa rënë ndesh me nenin 99, kur kushtet për vendosjen e mallrave nën regjimin në fjalë janë plotësuar dhe, në qoftë se mallrat nuk i nënshtrohen ndonjë mase ndaluese ose kufizuese, autoritetet doganore çlirojnë mallrat sapo të jenë verifikuar të dhënat në deklaratën doganore.

2. Të gjitha mallrat e mbuluara nga e njëjta deklaratë doganore çlirohen në të njëjtën kohë. Për zbatimin e këtij paragrafi, kur një deklaratë doganore mbulon dy ose më shumë artikuj, të dhënat që lidhen me secilin nga artikujt, konsiderohen si pjesë përbërëse e një deklarate më vete.

Neni 99

1. Kur nga pranimi i një deklarate doganore lind një borxh doganor, mallrat e mbuluara nga deklarata nuk çlirohen pa u paguar ose pa u garantuar më parë borxhi doganor. Megjithatë, pa rënë ndesh me paragrafin 2, kjo dispozitë nuk zbatohet për regjimin e lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimet e importit.

2. Kur, në zbatim të dispozitave që rregullojnë regjimin doganor për të cilin mallrat janë deklaruar, autoritetet doganore kërkojnë dhënien e një garancie, mallra në fjalë nuk çlirohen për atë regjim doganor derisa të jetë dhënë garancia.

Neni 100

Autoritetet doganore marrin të gjithë masat e nevojshme, përfshirë konfiskimin dhe shitjen, për mallrat që:

a) nuk mund të çlirohen sepse:

i) nuk është bërë e mundur kryerja ose vazhdimi i kontrollit të mallrave brenda afateve të parashikuara nga autoritetet doganore për arsye që kanë të bëjnë me deklaruesin; ose,

ii) nuk janë paraqitur dokumentet që duheshin paraqitur përpara se mallrat mund të vendosen nën regjimin doganor të kërkuar; ose

iii) nuk është kryer apo nuk është garantuar brenda afateve të parashikuara pagesa e garancisë në lidhje me detyrimet e importit ose të eksportit, sipas rastit, e cila duhej kryer ose garantuar; ose

iv) u nënshtrohen masave ndaluese ose kufizuese;

b) nuk janë tërhequr brenda 10 ditëve nga data e çlirimit të tyre.

**B. Deklarata të tjera**

Neni 101

Kur deklarata doganore bëhet nëpërmjet një teknike përpunimi të dhënash, për qëllimin e nenit 86 (b), ose nëpërmjet çdo veprimi tjetër për qëllimin e nenit 86 (c), zbatohen mutatis mutandis (duke bërë ndryshimet përkatëse) nenet 87 deri 100, pa rënë ndesh me parimet e shprehura në këto dispozita.

**C. Shqyrtimi i deklaratës pas çlirimit të mallrave**

Neni 102

1. Autoritetet doganore me nismën e tyre ose me kërkesë të deklaruesit mund të korrigjojnë deklaratën doganore pas çlirimit të mallrave.

2. Autoritetet doganore, pasi të kenë lejuar çlirimin e mallrave dhe me qëllim që të sigurohen për saktësinë e të dhënave të deklaratës doganore, mund të verifikojnë dokumentet tregtare dhe të dhënat që lidhen me veprimet e importit e të eksportit, si dhe veprimet e mëtejshme tregtare që kanë të bëjnë me këto mallra. Ky verifikim mund të kryhet në mjediset e deklaruesit ose të çdo personi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të përfshirë në veprimet e mësipërme për arsye të veprimtarisë së tij profesionale, ose të çdo personi tjetër në zotërim të të cilit janë dokumentet e të dhënat e mësipërme për qëllime tregtie. Autoritetet doganore mund të kontrollojnë edhe mallrat, kur paraqitja në doganë e tyre është ende e mundur.

3. Kur rishikimi i deklaratës doganore ose verifikimi i saj pas çlirimit të mallrave tregon se dispozitat për regjimet doganore në fjalë janë zbatuar në bazë informacionesh të pasakta e të paplota, autoritetet doganore, veç zbatimit të sanksioneve të parashikuara në pjesën VIII të këtij Kodi marrin, në përputhje me dispozitat në fuqi, masat e nevojshme për të rregulluar situatën, duke u mbështetur në informacionin e ri që disponojnë.

SEKSIONI 2
VENDOSJA NË QARKULLIM TË LIRË

Neni 103

1. Vendosja në qarkullim të lirë u jep mallrave joshqiptare statusin doganor të mallrave shqiptare.

2. Kjo sjell zbatimin e masave të politikës tregtare, kryerjen e formaliteteve të tjera të parashikuara për importimin e mallrave, si edhe pagesën e detyrimeve të importit.

Neni 104

Kur një dërgesë përbëhet nga mallra me klasifikim tarifor të ndryshëm dhe trajtimi i secilit prej tyre sipas klasifikimit të duhur për të përgatitur deklaratën sjell si pasojë një punë të madhe e shpenzime të tepruara në krahasim me detyrimet e importit që duhen paguar, autoritetet doganore, me kërkesë të deklaruesit mund të bien dakord që detyrimet e importit të paguhen mbi të gjithë ngarkesën në bazë të klasifikimit tarifor të mallrave që kanë nivelin më të lartë të detyrimit të importit.

Neni 105

1. Mallrat e vendosura në qarkullim të lirë, me një nivel të reduktuar ose zero të detyrimeve të importit, për arsye të përdorimit të veçantë të tyre, do të mbeten nën mbikëqyrjen doganore. Kjo mbikëqyrje përfundon kur kushtet për përfitimin e nivelit të reduktuar ose zero të detyrimeve pushojnë së ekzistuari, kur mallrat eksportohen ose shkatërrohen, ose kur lejohet përdorimi i mallrave për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara për zbatimin e nivelit të reduktuar ose zero të detyrimit, me kusht që të paguhen detyrimet përkatëse.

2. Nenet 111 dhe 113 zbatohen mutatis mutandis për mallrat e përmendura në paragrafin 1.

Neni 106

Mallrat e vendosura në qarkullim të lirë humbasin statusin doganor të mallrave shqiptare kur:

a) deklarata doganore për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë bëhet e pavlefshme pas çlirimit të mallrave, në përputhje me nenin 91; ose

b) detyrimet e importit që duhen paguar për këto mallra janë rimbursuar ose shuar:

i) nën regjimin e përpunimit aktiv në formën e sistemit me rimbursim; ose

ii) lidhur me mallrat me defekte, të cilat nuk u përgjigjen kushteve të kontratës sipas nenit 251; ose

iii) në situata si ato të përmendura në nenin 252, kur rimbursimi ose shuarja është e kushtëzuar nga eksportimi ose rieksportimi i mallrave ose nga dhënia e një destinacioni doganor të barazvlefshëm.

SEKSIONI 3
REGJIMET PEZULLUESE DHE REGJIMET DOGANORE EKONOMIKE

**A. Dispozita të përbashkëta për disa regjime**

Neni 107

1. Në nenet 108 deri 113:

a) për mallrat joshqiptare shprehja “regjim pezullues” zbatohet në regjimet e mëposhtme:

i) tranzit;

ii) magazinim doganor;

iii) përpunim aktiv në sistemin me pezullim;

iv) përpunim nën kontroll doganor;

v) lejim i përkohshëm;

b) shprehja “regjime doganore ekonomike” zbatohet në regjimet e mëposhtme:

i) magazinim doganor;

ii) përpunim aktiv;

iii) përpunim nën kontroll doganor;

iv) lejim i përkohshëm;

v) përpunim pasiv.

2. Me “mallra importi” kuptohen mallrat e vendosura nën një regjim pezullues dhe mallrat, të cilat duke qënë të vendosura nën regjimin e përpunimit aktiv në formën e sistemit me rimbursim, i kanë përmbushur formalitetet për vendosjen në qarkullim të lirë dhe formalitetet e parashikuara në nenin 146.

3. Me “mallra në gjendje të pandryshuar” kuptohen mallra të cilat në kushtet e regjimit të përpunimit aktiv ose të përpunimit nën kontroll doganor nuk kanë pësuar asnjë formë përpunimi.

Neni 108

Përdorimi i çdo regjimi doganor ekonomik kushtëzohet nga lëshimi i autorizimit përkatës prej autoriteteve doganore.

Neni 109

Pa rënë ndesh me kushtet specifike shtesë që rregullojnë regjimin përkatës, autorizimi i përmendur në

nenin 108 dhe ai i përmendur në nenin 123 jepet vetëm:

a) për personat që ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme për kryerjen si duhet të operacioneve;

b) kur autoritetet doganore mund të mbikëqyrin e kontrollojnë regjimin.

Neni 110

1. Autorizimi përcakton kushtet në të cilat zbatohet regjimi përkatës.

2. Mbajtësi i autorizimit duhet të njoftojë autoritetet doganore për të gjithë faktorët që lindin pas dhënies së autorizimit dhe që mund të ndikojnë në vazhdimësinë ose përmbajtjen e tij.

Neni 111

1. Autoritetet doganore mund të kushtëzojnë vendosjen e mallrave nën një regjim pezullues, me depozitimin e një garancie që të sigurojë se çdo borxh doganor, që mund të lindë në lidhje me ato mallra, do të paguhet.

2. Dispozitat e posaçme që kanë të bëjnë me dhënien e një garancie për regjime pezulluese të caktuara përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Neni 112

1. Një regjimi ekonomik pezullues përfundon kur mallrave ose produkteve kompensuese apo të përpunuara, të vendosura nën këtë regjim, u jepet një destinacion i ri doganor.

2. Autoritetet doganore marrin të gjitha masat e nevojshme për të rregulluar situatën e mallrave lidhur me të cilat regjimi në fjalë nuk është mbyllur sipas kushteve të parashikuara.

Neni 113

Të drejtat dhe detyrimet e mbajtësit të një regjimi doganor ekonomik mund t'i transferohen më pas, në bazë të kushteve të vendosura nga autoritetet doganore, personave të tjerë të cilët përmbushin të gjitha kushtet e nevojshme për të përfituar nga regjimi në fjalë.

**B. Tranziti**
**I. Dispozita të përgjithshme**

Neni 114

1. Regjimi i tranzitit lejon lëvizjen nga një pikë në tjetrën, brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë:

a) të mallrave joshqiptare, pa ia nënshtruar këto mallra detyrimeve të importit dhe detyrimeve të tjera ose masave të politikës tregtare;

b) të mallrave shqiptare, të cilat u nënshtrohen masave për eksportimin e tyre drejt vendeve të tjera dhe për të cilat janë kryer formalitetet përkatëse doganore për eksport.

2. Lëvizja, siç përmendet në paragrafin 1, kryhet:

a) nën regjimin e tranzitit; ose

b) kur mbulohet nga një Carnet TIR (Konventa TIR), në qoftë se kjo lëvizje:

i) ka filluar ose duhet të përfundojë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;

ii) lidhet me dërgesa mallrash që duhen shkarkuar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të cilat transportohen së bashku me mallra të destinuara të shkarkohen në një vend tjetër; ose

c) kur mbulohet nga një Carnet ATA (Konventa ATA), i përdorur si dokument tranziti; ose

d) me postë (përfshirë pakot postare).

3. Regjimi i tranzitit zbatohet pa rënë ndesh me dispozitat e veçanta të zbatueshme për lëvizjen e mallrave të vendosura nën një regjim doganor ekonomik.

Neni 115

Regjimi i tranzitit përfundon kur mallrat dhe dokumentet përkatëse i paraqiten zyrës doganore të destinacionit në përputhje me dispozitat e regjimit në fjalë.

**II. Dispozita të veçanta lidhur me tranzitin**
Neni 116

Regjimi i tranzitit zbatohet mbi mallrat që kalojnë nëpër territorin e një vendi tjetër, vetëm në qoftë

se:

a) një gjë e tillë është parashikuar në një marrëveshje ndërkombëtare; ose

b) transportimi i mallrave nëpër atë vend mbulohet nga një dokument transporti i vetëm, i hartuar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë; në këtë rast realizimi i këtij regjimi pezullohet në territorin e vendit tjetër.

Neni 117

1. Pa rënë ndesh me nenin 118, personi përgjegjës duhet të japë një garanci, që të sigurojë pagesën e çdo borxhi doganor ose të detyrimeve të tjera që mund të lindin në lidhje me mallrat.

2. Përveç rasteve që përcaktohen, kur është e nevojshme, me dispozita të ministrit të Financave, nuk ka nevojë të paraqitet garanci për:

a) udhëtime në rrugë detare dhe ajrore;

b) transport me tubacione;

c) operacione të kryera nga shoqëri hekurudhore publike.

Neni 118

1. Autoritetet doganore mund t’i lejojnë të mos japë garanci për veprimet e tranzitit që kryen, çdo personi që plotëson kushtet e parashikuara në paragrafin 2, pa cenuar kufizimet e parashikuara në paragrafin 3.

2. Lejohen të mos japin garanci, siç përmendet në paragrafin 1, vetëm personat që:

a) janë të vendosur në Republikën e Shqipërisë;

b) përdorin rregullisht regjimin e tranzitit;

c) gëzojnë një gjendje financiare të tillë që i lejon të respektojnë detyrimet që kanë;

d) nuk kanë kryer asnjë shkelje të ligjeve doganore ose fiskale; dhe

e) në përputhje me formularin model të përcaktuar, marrin përsipër të paguajnë që në kërkesën e parë me shkrim të autoriteteve doganore, çdo shumë të kërkuar lidhur me veprimet e tyre të tranzitit.

3. Heqja e detyrimit për të dhënë garanci në përputhje me paragrafet 1 dhe 2 nuk zbatohet në rastin e veprimeve të tranzitit që lidhen me mallrat e mëposhtme:

a) me vlerë të përgjithshme më të madhe se shuma e caktuar në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi; ose

b) që paraqesin rrezik të lartë përsa i takon nivelit të detyrimeve të importit, të cilat u nënshtrohen në Republikën e Shqipërisë.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila jep të drejtën për të mos dhënë garancinë, duhet t’i lëshojë çdo personi që e fiton këtë të drejtë një ose më shumë kopje të autorizimit me të cilin hiqet detyrimi i dhënies së garancisë.

Neni 119

1. Përgjegjësi kryesor është mbajtësi i regjimit të tranzitit. Ai mban përgjegjësi për:

a) paraqitjen e mallrave të paprekura në zyrën doganore të destinacionit, brenda afatit të caktuar kohor dhe duke respektuar masat që marrin autoritetet doganore për të siguruar identifikimin e mallrave;

b) respektimin e dispozitave që lidhen me regjimin e tranzitit.

2. Pavarësisht nga detyrimet e përgjegjësit kryesor sipas paragrafit 1, transportuesit ose marrësit e mallrave, të cilët janë në dijeni që mallrat po qarkullojnë nën regjimin e tranzitit, janë, gjithashtu, përgjegjës për paraqitjen e mallrave të paprekura në zyrën doganore të destinacionit, brenda afatit të caktuar kohor dhe duke respektuar masat që marrin autoritetet doganore për të siguruar identifikimin e mallrave.

Neni 120

1. Rregulla të hollësishme për funksionimin e këtij regjimi dhe përjashtimet përkatëse, përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

2. Me kusht që të garantohet zbatimi i masave që parashikohen me ligj për mallrat, ministri i Financave ka të drejtë, në rrethana të caktuara, të vendosë procedura të thjeshtuara për mallrat që nuk do të qarkullojnë në territorin e një vendi tjetër.

**C. Magazinimi doganor**

Neni 121

1. Regjimi i magazinimit doganor lejon ruajtjen në një magazinë doganore:

a) të mallrave joshqiptare, pa iu nënshtruar ato detyrimeve të importit ose masave të politikës

tregtare;

b) të mallrave shqiptare, kur dispozitat në fuqi që rregullojnë fusha të veçanta parashikojnë që vendosja e tyre në magazinat doganore kërkon zbatimin e masave që normalisht lidhen me eksportin e këtyre mallrave.

2. Me "magazinë doganore" kuptohet çdo vend i miratuar e i mbikëqyrur nga autoritetet doganore, ku mallrat mund të magazinohen sipas kushteve të përcaktuara.

3. Rastet kur mallrat e përmendura në paragrafin 1 mund të vendosen në regjimin e magazinimit doganor pa u ruajtur në një magazinë doganore, përcaktohen me vendim të veçantë të ministrit të Financave.

Neni 122

1. Një magazinë doganore mund të jetë publike ose private:

a) me "magazinë publike" kuptohet një magazinë doganore që mund të përdoret nga çdo person për ruajtjen e mallrave;

b) me "magazinë private" kuptohet një magazinë doganore e destinuar vetëm për magazinimin e mallrave nga administruesi i magazinës.

2. "Administrues i magazinës" është personi i autorizuar nga autoritetet doganore për të administruar magazinën doganore.

3. "Depozituesi" është personi i cili mban të gjitha detyrimet që rrjedhin nga deklarata doganore e vendosjes së mallrave nën regjim magazinimi doganor, ose, të cilit i janë transferuar të drejtat dhe detyrimet e një personi të tillë.

Neni 123

1. Administrimi i magazinës doganore i nënshtrohet lëshimit të një autorizimi nga autoritetet doganore, me përjashtim të rastit kur këto autoritete e administrojnë vetë magazinën doganore.

2. Çdo person që dëshiron të administrojë një magazinë doganore duhet të bëjë një kërkesë me shkrim, e cila përmban informacionin e kërkuar për lëshimin e autorizimit, duke treguar veçanërisht se ekziston një nevojë ekonomike për magazinimin e mallrave. Autorizimi përcakton kushtet për administrimin e magazinës doganore.

3. Autorizimi u lëshohet vetëm personave të vendosur në Republikën e Shqipërisë.

Neni 124

Administruesi i magazinës ka përgjegjësi:

a) të sigurojë që mallrat, gjatë kohës që janë në magazinën doganore, të mos i shmangen mbikëqyrjes doganore;

b) të plotësojë detyrimet që lindin nga magazinimi i mallrave që ndodhen nën regjimin e magazinimit doganor; dhe

c) të respektojë të gjitha kushtet e veçanta të specifikuara në autorizim.

Neni 125

1. Duke anashkaluar nenin 124, kur autorizimi ka të bëjë me një magazinë publike, në autorizim mund të parashikohet që përgjegjësitë e përmendura në nenin 124 (a) dhe/ose (b), bien tërësisht mbi depozituesin.

2. Depozituesi është në çdo kohë përgjegjës për plotësimin e detyrimeve që lindin nga vendosja e mallrave nën regjimin e magazinimit doganor.

Neni 126

Të drejtat dhe detyrimet e administratorit të magazinës, me miratimin e autoriteteve doganore, mund t'i transferohen një personi tjetër.

Neni 127

Pa rënë ndesh me nenin 111, autoritetet doganore mund t'i kërkojnë administruesit të magazinës të paraqesë një garanci lidhur me përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 124.

Neni 128

1. Personi i caktuar nga autoritetet doganore mban regjistër të magazinimit të të gjitha mallrave të

vendosura nën regjimin e magazinimit doganor, në formën e miratuar nga këto autoritete.

2. Pa rënë ndesh me nenin 109, autoritetet doganore mund të mos e mbajnë regjistrin e magazinimit të mallrave, nëse përgjegjësitë, të cilave u referohet neni 124(a) dhe/ose (b), bien ekskluzivisht mbi depozituesin dhe mallrat janë vendosur në këtë regjim në bazë të një deklarate me shkrim, që është pjesë përbërëse e procedurës normale.

Neni 129

1. Kur ekziston një nevojë ekonomike dhe nuk cenohet mbikëqyrja doganore, autoritetet doganore mund të lejojnë që:

a) mallra shqiptare, të ndryshme prej atyre të përmendura në nenin 121(1)(b), të ruhen në mjediset e magazinës doganore;

b) mallrat joshqiptare të përpunohen në mjediset e magazinës doganore, nën regjimin e përpunimit aktiv, duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara prej këtij regjimi. Formalitetet që mund të mos kryhen në një magazinë doganore, përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi;

c) mallrat joshqiptare, të përpunohen në mjediset e një magazine doganore, nën regjimin e përpunimit nën kontroll doganor, duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara nga ky regjim. Formalitetet që mund të mos kryhen në një magazinë doganore përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

2. Në rastet e përmendura në paragrafin 1, mallrat nuk i nënshtrohen regjimit të magazinimit doganor.

3. Autoritetet doganore mund të kërkojnë që mallrat e përmendura në paragrafin 1 të shënohen në regjistrin e magazinës sipas nenit 128.

Neni 130

Mallrat e vendosura në regjim magazinimi doganor shënohen në regjistrin e magazinës sipas nenit 128, që në çastin kur ato futen në magazinën doganore.

Neni 131

1. Mallrat mund të qëndrojnë nën regjimin e magazinimit doganor për një periudhë deri në 12 muaj. Autoritetet doganore, me kërkesë të depozituesit, mund të pranojnë një zgjatje të afatit deri në 12 muaj të tjerë.

2. Megjithatë, kur rrethana të jashtëzakonshme e kërkojnë, autoritetet doganore mund të vendosin, brenda kufijsh kohorë të arsyeshëm, një afat më të shkurtër, gjatë të cilit depozituesi duhet t'u caktojë mallrave një destinacion të ri doganor.

Neni 132

1. Mallrat e importit mund të pësojnë trajtime të ndryshme me qëllim ruajtjeje, përmirësimi të pamjes së jashtme ose të cilësisë së tregtimit, ose për t'i përgatitur ato për shpërndarje ose rishitje.

2. Lista e mënyrave të trajtimit, të përmendura në paragrafin e mësipërm, përfshihet në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi. Ministri i Financave ka të drejtë të bëjë çdo ndryshim të nevojshëm në këtë listë.

3. Mënyrat e trajtimit, të përmendura në paragrafin 1, duhet të autorizohen që më parë nga autoritetet doganore, të cilat përcaktojnë edhe kushtet në të cilat ato mund të kryhen.

Neni 133

1. Kur e kërkojnë rrethanat, mallrat e vendosura nën regjim magazinimi doganor, mund të zhvendosen përkohësisht nga magazina doganore. Kjo zhvendosje bëhet me autorizim paraprak të autoriteteve doganore, të cilat përcaktojnë kushtet për kryerjen e saj.

2. Në kohën që janë jashtë magazinës doganore, mallrat mund t'u nënshtrohen mënyrave të trajtimit të përmendura në nenin 132, sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen.

Neni 134

Autoritetet doganore mund të lejojnë që mallrat, e vendosura nën regjimin e magazinimit doganor, të transferohen nga një magazinë doganore në një tjetër.

Neni 135

1. Kur lind një borxh doganor lidhur me mallrat e importit dhe vlera doganore e këtyre mallrave bazohet në çmimin realisht të paguar ose që duhet paguar, i cili përfshin shpenzimet e magazinimit e të ruajtjes së mallrave gjatë vendosjes së tyre në magazinë, këto shpenzime nuk është e nevojshme të përfshihen në vlerën doganore, në rast se janë treguar veçmas nga çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar për këto mallra.

2. Në rast se mallrat në fjalë u janë nënshtruar mënyrave të zakonshme të trajtimit për qëllimin e nenit 132, lloji i mallrave, vlera doganore dhe sasia që merret parasysh për përcaktimin e shumës së detyrimeve të importit, me kërkesë të deklaruesit janë ato që do të ishin marrë parasysh për mallrat në kohën e përmendur në nenin 229, nëse këto mallra nuk do t'i ishin nënshtruar këtij trajtimi.

3. Megjithatë, në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, përcaktohen raste në të cilat mund të ketë, nëse është e nevojshme, anashkalime nga paragrafi 2 i këtij neni.

**D. Përpunimi aktiv**
**I. Dispozita të përgjithshme**

Neni 136

1. Pa rënë ndesh me nenin 137, regjimi i përpunimit aktiv lejon që mallrat e përmendura më poshtë të përdoren në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në një ose më shumë operacione përpunimi:

a) mallrat joshqiptare të destinuara për t'u rieksportuar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë në formën e produkteve kompensuese, pa iu nënshtruar detyrimeve të importit ose masave të politikës tregtare;

b) mallrat e vendosura në qarkullim të lirë, me rimbursim ose shuarje të detyrimeve të importit që duhen paguar për këto mallra, nëse ato eksportohen jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë në formën e produkteve kompensuese.

2. Shprehjet e mëposhtme nënkuptojnë:

a) "sistem me pezullim": masat lehtësuese të regjimit të përpunimit aktiv për rieksportimin, siç është parashikuar në paragrafin 1(a);

b) "sistem me rimbursim": masat lehtësuese të regjimit të përpunimit aktiv për rieksportimin, siç është parashikuar në paragrafin 1(b);

c) "operacione përpunimi":

i) punimin e mallrave, duke përfshirë montimin, bashkimin ose përshtatjen me mallra të tjera;

ii) përpunimin e mallrave;

iii) riparimin e mallrave, duke përfshirë ndreqjen dhe rregullimin e tyre; dhe

iv) përdorimin e disa mallrave, të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, të cilat nuk gjenden në produktet kompensuese, por që lejojnë ose lehtësojnë prodhimin e këtyre produkteve, edhe sikur ato të jenë përdorur tërësisht ose pjesërisht gjatë procesit të punës;

d) "produkte kompensuese": të gjitha produktet që rezultojnë nga operacionet e përpunimit;

e) "koeficienti i shfrytëzimit": sasia ose përqindja e produkteve kompensuese të përftuara nga përpunimi i një sasie të caktuar mallrash të importuara.

**II. Dhënia e autorizimit**
Neni 137

Autorizimi lëshohet me kërkesë të personit që kryen operacionet e përpunimit ose që bën të mundur kryerjen e tyre.

Neni 138

Autorizimi lëshohet vetëm:

a) për persona të vendosur në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, autorizimi mund t'u lëshohet edhe personave të vendosur jashtë vendit, përsa u përket importeve të një natyre jotregtare;

b) kur pa rënë ndesh me përdorimin e mallrave të përmendura në nenin 136 (2)(c)(iv), mallrat e importit mund të identifikohen në produktet kompensuese;

c) kur regjimi i përpunimit aktiv mund të ndihmojë në krijimin e kushteve më të favorshme për eksportin ose rieksportin e produkteve kompensuese, me kusht që interesat thelbësorë të prodhuesve shqiptarë të mos cenohen (kushtet ekonomike).

**III. Funksionimi i regjimit**
Neni 139

1. Autoritetet doganore përcaktojnë afatin brenda të cilit produktet kompensuese duhet të jenë eksportuar ose rieksportuar ose t'u jetë caktuar një destinacion doganor tjetër. Ky afat merr parasysh kohën e nevojshme për kryerjen e operacioneve të përpunimit dhe të vënies në dispozicion të produkteve kompensuese.

2. Afati fillon nga data kur mallrat joshqiptare janë vendosur nën regjimin e përpunimit aktiv. Autoritetet doganore, me kërkesë të arsyetuar nga mbajtësi i autorizimit, mund ta shtyjnë këtë afat.

Neni 140

1. Autoritetet doganore përcaktojnë ose koeficientin e shfrytëzimit për operacionin në fjalë ose, kur është rasti, metodën e përcaktimit të këtij koeficienti. Koeficienti i shfrytëzimit përcaktohet në bazë të rrethanave reale në të cilat operacioni i përpunimit është kryer ose duhet të kryhet.

2. Kur e kërkojnë rrethanat, dhe veçanërisht në rastin e operacioneve përpunuese që tradicionalisht kryhen në kushte teknike të përcaktuara qartë për mallra me karakteristika të njëjta thelbësore dhe që kanë si rezultat prodhimin e produkteve kompensuese me cilësi të njëjtë, në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi mund të caktohet koeficienti standard i shfrytëzimit, në bazë të të dhënave reale të vërtetuara më parë.

Neni 141

Rastet dhe kushtet në të cilat mallrat në gjendje të pandryshuar ose produktet kompensuese konsiderohen se janë vendosur në qarkullim të lirë, mund të përcaktohen me dispozita të nxjerra nga ministri i Financave.

Neni 142

1. Pa rënë ndesh me nenin 143, kur lind një borxh doganor, shuma e këtij borxhi përcaktohet në bazë të elementeve përkatëse të taksimit për mallrat e importit, në datën e pranimit të deklaratës për vendosjen e këtyre mallrave nën regjimin e përpunimit aktiv.

2. Nëse, në datën e përmendur në paragrafin 1, mallrat e importit plotësojnë kushtet e përcaktuara për përfitimin e trajtimit tarifor preferencial brenda kuotave ose tavaneve tarifore, ato përfitojnë çdo trajtim tarifor preferencial për mallra identike, që është në fuqi në datën e pranimit të deklaratës së vendosjes në qarkullim të lirë.

Neni 143

Duke anashkaluar nenin 142, produktet kompensuese:

a) u nënshtrohen detyrimeve të importit, të llogaritura në përputhje me rregullat që zbatohen në regjimin doganor në fjalë ose në zonat e lira, kur janë vendosur nën sistemin me pezullim ose në një zonë të lirë apo magazinë të lirë;

megjithatë,

i) personi i interesuar mund të kërkojë që detyrimi të përllogaritet sipas nenit 142;

ii) në rastet kur produkteve kompensuese u është caktuar një nga destinacionet doganore të përmendura më sipër, i ndryshëm nga përpunimi nën kontroll doganor, shuma e detyrimeve të importit dhe i detyrimeve të tjera që vilen, duhet të jetë të paktën, e barabartë me shumën e llogaritur sipas nenit 142;

b) mund t'u nënshtrohen dispozitave që rregullojnë nxjerrjen e detyrimeve dhe që janë përcaktuar në kuadër të regjimit të përpunimit nën kontrollin doganor, në rastet kur mallrat e importit mund të ishin vendosur nën këtë regjim;

c) përfitojnë trajtim tarifor favorizues për shkak të përdorimit të veçantë, kur ky trajtim parashikohet për mallra identike;

d) përjashtohen nga detyrimet e importit, në rast se për mallra identike të importuara në përputhje me nenin 199, ka një dispozitë ligjore në lidhje me këtë përjashtim.

**IV. Operacione përpunimi në një vend të huaj**

Neni 144

1. Një pjesë ose të gjitha produktet kompensuese ose mallrat në gjendje të pandryshuar mund të eksportohen përkohësisht, me qëllim që të përpunohen më tej në një vend të huaj, nëse autoritetet doganore e autorizojnë një gjë të tillë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dispozitat për përpunimin pasiv.

2. Kur lind një borxh doganor që ka të bëjë me produkte të riimportuara, duhet të paguhen detyrimet e mëposhtme:

a) Detyrimet e importit mbi produktet kompensuese ose mbi mallra në gjendje të pandryshuar të përmendura në paragrafin 1, të përllogaritura sipas neneve 142 e 143; dhe

b) detyrimet e importit mbi produktet e riimportuara, pas përpunimit të tyre në një vend të huaj, shuma e të cilave përllogaritet sipas dispozitave që lidhen me regjimin e përpunimit pasiv, me të njëjtat kushte që do të ishin zbatuar sikur produktet e eksportuara nën këtë regjim të ishin vendosur në qarkullim të lirë para se të kryhej ky eksportim.

**V. Dispozita të veçanta që lidhen me sistemin me rimbursim**
Neni 145

1. Sistemi me rimbursim mund të përdoret për të gjitha mallrat, me përjashtim të atyre që, në datën e pranimit të deklaratës së vendosjes në qarkullim të lirë:

a) janë objekt i kufizimeve sasiore të importit;

b) brenda kontigjenteve, mund të përfitojnë masa tarifore preferenciale ose një masë pezullimi autonome për qëllimin e nenit 28(3) (d) dhe (e).

2. Për më tepër, sistemi me rimbursim mund të përdoret vetëm në rast se, në datën e pranimit të deklaratës për vendosjen e mallrave të importit në qarkullim të lirë, nuk janë caktuar rimbursime eksporti për produktet kompensuese.

3. Leja për të përdorur sistemin me rimbursim jepet vetëm në qoftë se në datën e pranimit të deklaratës për eksport të produkteve kompensuese, për këto produkte nuk është caktuar rimbursim eksporti.

Neni 146

1. Deklarata për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë duhet të vërë në dukje se është përdorur sistemi me rimbursim dhe të japë hollësira për autorizimin.

2. Autorizimi në fjalë i bashkëngjitet deklaratës së vendosjes në qarkullim të lirë.

Neni 147

Në sistemin me rimbursim nenet 141, 142 dhe 143 (c ) nuk zbatohen.

Neni 148

Eksportimi i përkohshëm i produkteve kompensuese, i kryer sipas nenit 144 (1) nuk quhet si eksportim për qëllimin e nenit 149, përveç rastit kur produkte të tilla nuk riimportohen në Republikën e Shqipërisë brenda afatit të caktuar.

Neni 149

1. Mbajtësi i autorizimit mund të kërkojë rimbursimin ose shuarjen e detyrimeve të importit, në rast se ai mund t'u argumentojë në mënyrë bindëse autoriteteve doganore, që produktet kompensuese të përftuara nga mallra të importuara, të vendosura në qarkullim të lirë nën sistemin me rimbursim janë:

a) eksportuar, ose

b) me synim rieksportimin e mëvonshëm janë vendosur nën regjimin e tranzitit, regjimin e magazinimit doganor, nën regjimin e lejimit të përkohshëm, nën regjimin e përpunimit aktiv (sistemi me pezullim ), ose në një zonë të lirë ose magazinë të lirë,

mjafton që të gjitha kushtet për përdorimin e regjimit, gjithashtu, të jenë plotësuar.

2. Për qëllim të caktimit të një destinacioni doganor të përmendur në rastin e dytë të paragrafit 1(b), produktet kompensuese konsiderohen si mallra joshqiptare.

3. Afati, brenda të cilit duhet të bëhet kërkesa për rimbursim, përcaktohet në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

4. Produktet kompensuese, të vendosura nën një regjim doganor ose në një zonë të lirë ose magazinë të lirë, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1, vendosen në qarkullim të lirë vetëm kur autorizohen nga autoritetet doganore, të cilat, kur e kërkojnë rrethanat, mund të lëshojnë këtë autorizim. Në këtë rast, dhe pa rënë ndesh me nenin 143(a), shuma e detyrimeve të importit, të rimbursuara ose të shuara, quhet se përbën shumën e borxhit doganor.

**E. Përpunimi nën kontroll doganor**
Neni 150

Regjimi i përpunimit nën kontroll doganor lejon të përdoren në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë mallra joshqiptare në operacione që e ndryshojnë natyrën ose gjendjen e mallrave, pa iu nënshtruar detyrimeve të importit ose masave të politikave tregtare, dhe vendosjen në qarkullim të lirë të produkteve të përftuara si pasojë e këtyre operacioneve, kundrejt pagesës se detyrimeve përkatëse të importit.

Produkte të tilla quhen produkte të përpunuara.

Neni 151

Lista e rasteve, në të cilat mund të përdoret regjimi i përpunimit nën kontroll doganor, përcaktohet në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Neni 152

Autorizimi për përpunim nën kontroll doganor lëshohet në bazë të kërkesës së personit që kryen vetë përpunimin ose që bën të mundur kryerjen e këtij përpunimi.

Neni 153

Autorizimi jepet vetëm për:

a) persona të vendosur në Republikën e Shqipërisë;

b) mallra të importit, kur ato mund të identifikohen në produktet e përpunuara;

c) rastet kur gjendja dhe lloji i mallrave, pas procesit të përpunimit nuk mund të rikthehen ekonomikisht në përshkrimin ose gjendjen që ato kishin para se të vendoseshin nën regjim;

d) rastet kur përdorimi i regjimit nuk mund të sjellë si pasojë mosrespektimin e rregullave në lidhje me origjinën dhe kufizimet sasiore të zbatueshme mbi mallrat e importuara;

e) rastet kur përmbushen kushtet e nevojshme për zbatimin e regjimit që ndihmon krijimin ose mbajtjen e një veprimtarie përpunimi në Republikën e Shqipërisë, pa cenuar interesat e prodhuesve shqiptare të produkteve të ngjashme (kushtet ekonomike).

Neni 154

Nenet 139 dhe 140 zbatohen mutatis mutandis.

Neni 155

Kur lind një borxh doganor, që ka të bëjë me mallra në gjendje të pandryshuar ose me produkte që janë në një stad përpunimi të ndërmjetëm në krahasim me atë që parashikohet në autorizim, shuma e këtij borxhi përcaktohet në baze të elementeve të taksimit në fuqi për mallrat e importit në datën e pranimit të deklaratës për vendosjen e mallrave në regjimin e përpunimit nën kontroll doganor.

Neni 156

1. Nëse në datën kur janë vendosur në regjimin e përpunimit nën kontroll doganor, mallrat e importit përfitojnë trajtim tarifor preferencial dhe ky trajtim zbatohet për produkte identike me produktet e vendosura në qarkullim të lirë, detyrimet e importit, të cilave iu nënshtrohen produktet e përpunuara, përllogariten duke zbatuar masën e detyrimeve që duhen paguar në kuadrin e trajtimit në fjalë.

2. Në qoftë se trajtimi tarifor preferencial, i përmendur në paragrafin 1, për mallrat e importuara i nënshtrohet kuotave ose tavaneve tarifore, zbatimi i masës se taksimit, të përmendur në paragrafin 1, për produktet e përpunuara i nënshtrohet, gjithashtu, edhe kushtit që trajtimi tarifor preferencial në fjalë zbatohet mbi mallrat e importuara në datën e pranimit të deklaratës për vendosjen në qarkullim të lirë. Në këtë rast, sasia e mallrave të importuara të përdorura për prodhimin e produkteve të përpunuara e të vendosura në qarkullim të lirë, përllogaritet sipas kuotave ose tavaneve tarifore në fuqi në datën e pranimit të deklaratës së vendosjes në qarkullim të lirë dhe, asnjë sasi nuk përllogaritet sipas kuotave ose tavaneve tarifore të hapura për produkte të njëjta me ato të përpunuara.

**F. Lejimi i përkohshëm**

Neni 157

Regjimi i lejimit të përkohshëm bën të mundur përdorimin në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit dhe pa iu nënshtruar masave të politikave tregtare, të mallrave joshqiptare të destinuara për t’u rieksportuar, pa pësuar ndryshime, përveç zhvleftësimit normal për shkak të përdorimit të tyre.

Neni 158

Autorizimi për lejimin e përkohshëm lëshohet në bazë të kërkesës se personit që i përdor mallrat ose

që bën të mundur përdorimin e tyre.

Neni 159

1. Autoritetet doganore refuzojnë lëshimin e autorizimit për përdorim të regjimit të lejimit të përkohshëm, në rast se është e pamundur të sigurohet identifikimi i mallrave të importuara.

2. Megjithatë, autoritetet doganore mund të autorizojnë përdorimin e regjimit të lejimit të përkohshëm pa siguruar identifikimin e mallrave, atëherë kur, duke marrë parasysh llojin e mallrave ose natyrën e operacioneve që duhet të kryhen, mungesa e masave të identifikimit nuk sjell si pasojë asnjë formë abuzimi të regjimit në fjalë.

Neni 160

1. Autoritetet doganore përcaktojnë afatin brenda të cilit mallrat e importit duhet të rieksportohen ose t'u caktohet një destinacion i ri doganor. Ky afat duhet të zgjasë për aq kohë sa të arrihet qëllimi për të cilin është lëshuar autorizimi.

2. Pa rënë ndesh me afatet e veçanta të përcaktuara sipas nenit 161, afati, gjatë të cilit mallrat mund të qëndrojnë nën regjimin e lejimit të përkohshëm, është 12 muaj. Autoritetet doganore, në bazë të një kërkesë të arsyetuar mirë të personit të interesuar, mund të zgjasin afatin e përmendur në paragrafin 1 për një maksimum prej 12 muajsh të tjerë, me qëllim që të bëhet i mundur përdorimi i autorizuar.

3. Megjithatë, për rrethana të veçanta, autoritetet doganore mund të përcaktojnë, brenda kufijsh kohorë të arsyeshëm, afate më të shkurtra, duke marrë pëlqimin e personit të interesuar.

Neni 161

Rastet dhe kushtet e veçanta, në të cilat mund të përdoret regjimi i lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimet e importit, përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Neni 162

1. Përdorimi i regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimet e importit jepet për mallrat të cilat, ndërsa mbeten në pronësi të një personi të vendosur në një vend të huaj, nuk mbulohen nga dispozitat e nenit 161 ose, edhe pse mbulohen nga këto dispozita, nuk i plotësojnë të gjitha kushtet e parashikuara nga ky nen për dhënien e regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimet e importit.

2. Lista e mallrave, në lidhje me të cilat mund të mos përdoret regjimi i lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimet e importit, përcaktohet në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Neni 163

1. Shuma e detyrimeve të importit që duhet paguar për mallrat e vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimet e importit caktohet në masën 3 për qind të shumës se detyrimeve që duhet paguar për mallrat në fjalë. Kjo shumë prej 3 për qind zbatohet për çdo muaj ose pjesë të muajit, gjatë të cilit mallrat janë vendosur nën regjimin e lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm, sikur këto mallra të ishin vendosur në qarkullim të lirë në datën në të cilën u vendosën nën regjimin e lejimit të përkohshëm.

2. Shuma e detyrimeve të importit që duhet të paguhet nuk duhet të kapërcejë atë shumë që do të ishte kërkuar, nëse mallrat në fjalë do të ishin vendosur në qarkullim të lirë në datën që ato u vendosen nën regjimin e lejimit të përkohshëm, duke mos llogaritur interesat që mund të zbatoheshin.

3. Transferimi i të drejtave e i detyrimeve që rrjedhin nga regjimi i lejimit të përkohshëm, sipas nenit 113, nuk nënkupton se duhet të zbatohen të njëjtat masa përjashtimi për secilën nga periudhat e përdorimit që duhen marrë parasysh.

4. Kur transferimi i përmendur në paragrafin 3 bëhet me përjashtim të pjesshëm për të dy personat e autorizuar për përdorimin e regjimit gjatë të njëjtit muaj, mbajtësi i autorizimit fillestar është i detyruar të paguajë shumën e detyrimeve të importit që duhen paguar për të gjithë muajin.

Neni 164

1. Kur lind një borxh doganor që ka të bëjë me mallra të importuara, shuma e këtij borxhi përcaktohet në bazë të elementeve të taksimit në fuqi për këto mallra në datën e pranimit të deklaratës për vendosjen e tyre nën regjimin e lejimit të përkohshëm. Megjithatë, në rastet e parashikuara nga dispozitat e

nenit 161, shuma e borxhit përcaktohet në bazë të elementeve të taksimit në fuqi për mallrat në fjalë në datën e përmendur në nenin 229.

2. Kur, për një arsye të ndryshme nga vendosja e mallrave nën regjimin e lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimet e importit, lind një borxh doganor për mallrat e vendosura nën regjimin në fjalë, shuma e këtij borxhi është e barabartë me diferencën midis shumës se detyrimeve të llogaritura sipas paragrafit 1 dhe shumës se detyrimeve që duhet paguar sipas nenit 163.

**G. Përpunimi pasiv**
**I. Dispozita të përgjithshme**

Neni 165
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Pa rënë ndesh me dispozitat që rregullojnë fusha të veçanta që kanë të bëjnë me sistemin e shkëmbimeve standarde, siç parashikohet në nenet 174 deri 179 ose në nenin 144, regjimi i përpunimit pasiv lejon që mallrat shqiptare të eksportohen përkohësisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, me qëllim që t'u nënshtrohen operacioneve përpunuese dhe produktet që dalin si rezultat i këtyre operacioneve të vendosen në qarkullim të lirë me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit.

2. Eksportimi i përkohshëm i mallrave shqiptare sjell zbatimin e detyrimeve të eksportit, të masave të politikës tregtare dhe të formaliteteve të tjera për daljen e mallrave shqiptare nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

3. Me përkufizimet që vijojnë do të kuptohen:

a) "mallra në eksport të përkohshëm": mallrat e vendosura nën regjimin e përpunimit pasiv;

b) "operacione përpunimi": operacionet e përmendura në nenin 136 (2)(c ), rasti i parë, i dytë dhe i tretë;

c) "produkte kompensuese": të gjitha produktet e përftuara si rezultat i operacioneve të përpunimit;

d) "koeficient i shfrytëzimit" do të thotë sasia ose përqindja e produkteve kompensuese, e përftuar nga përpunimi i një sasie të caktuar mallrash eksporti të përkohshëm.

Neni 166

1. Mallrat shqiptare nuk vendosen në regjimin e përpunimit pasiv kur:

a) eksportimi i tyre sjell si pasojë rimbursimin ose shuarjen e detyrimeve të importit;

b) para eksportimit, këto mallra janë vendosur në qarkullim të lirë me përjashtim të plotë të detyrimeve të importit, për arsye të përdorimit të tyre të veçantë, për aq kohë sa vazhdojnë të ekzistojnë kushtet për dhënien e përjashtimit në fjalë;

c) eksportimi i tyre sjell si pasojë mundësinë e rimbursimin të pagesës për eksport ose përparësi financiare të dhëna për këtë rast.

2. Megjithatë, anashkalimet nga paragrafi 1(b) mund të përcaktohen me dispozita të nxjerra nga ministri i Financave.

**II. Dhënia e autorizimit**
Neni 167

1. Autorizimi për të përdorur regjimin e përpunimit pasiv jepet me kërkesë të personit që bën të mundur kryerjen e operacioneve të përpunimit.

2. Duke anashkaluar paragrafin 1, autorizimi për të përdorur regjimin e përpunimit pasiv për mallra me origjinë shqiptare, për qëllimin e pjesës II, kreu 2, seksioni 1, mund t'i jepet një personi tjetër, në rast se operacioni i përpunimit konsiston në përfshirjen e këtyre mallrave brenda mallrave të përftuara jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të importuara si produkte kompensuese, me kusht që përdorimi i regjimit të ndihmojë nxitjen e shitjes së mallrave të eksportit, pa cenuar interesat thelbësorë të prodhuesve shqiptarë për produkte identike ose të ngjashme me produktet kompensuese të importuara.

3. Rastet dhe mënyrat në të cilat zbatohen paragrafet e mësipërme, përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Neni 168

Autorizimi jepet vetëm:

a) për persona të vendosur në Republikën e Shqipërisë;

b) kur vlerësohet se është e mundur të verifikohet që produktet kompensuese janë përftuar nga përpunimi i mallrave të eksportuara përkohësisht. Rastet e anashkalimeve nga ky nënparagraf dhe kushtet në të cilat këto anashkalime zbatohen, përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi;

c) kur autorizimi për përdorimin e regjimit të përpunimit pasiv nuk sjell si pasojë cenimin e interesave thelbësorë të prodhuesve dhe përpunuesve shqiptarë (kushtet ekonomike).

**III. Funksionimi i regjimit**

Neni 169

1. Autoritetet doganore përcaktojnë afatin brenda të cilit produktet kompensuese duhet të riimportohen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë. Ato mund ta zgjasin këtë afat me kërkesë të arsyetuar mirë nga ana e mbajtësit të autorizimit.

2. Autoritetet doganore përcaktojnë koeficientin e shfrytëzimit për këtë operacion, ose kur është e nevojshme, metodën e përcaktimit të këtij koeficienti.

Neni 170

1. Përjashtimi i plotë ose i pjesshëm nga detyrimet e importit, i parashikuar në nenin 171(1), jepet vetëm kur produktet kompensuese janë deklaruar për vendosje në qarkullim të lirë, në emër ose për llogari të:

a) mbajtësit të autorizimit, ose

b) çdo personi tjetër të vendosur në Republikën e Shqipërisë, mjafton që të ketë marrë pëlqimin e mbajtësit të autorizimit dhe kushtet e autorizimit të jenë plotësuar.

2. Përjashtimi i plotë ose i pjesshëm nga detyrimet e importit, të parashikuara në nenin 171, nuk jepet kur një nga kushtet apo detyrimet lidhur me regjimin e përpunimit pasiv nuk është plotësuar, me përjashtim të rastit kur gjykohet se këto mangësi nuk kanë pasoja domethënëse në funksionimin e duhur të regjimit.

Neni 171

1. Përjashtimi i plotë ose i pjesshëm nga detyrimet e importit, parashikuar në nenin 165, zbatohet duke zbritur nga shuma e detyrimeve të importit, që duhen paguar për produktet kompensuese të vendosura në qarkullim të lirë, shumën e detyrimeve të importit që do të duhej të paguheshin në të njëjtën datë mbi mallrat e eksportuara përkohësisht, nëse ato do të ishin importuar në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nga vendi ku i janë nënshtruar përpunimit ose operacionit të fundit të përpunimit.

2. Shuma për t'u zbritur sipas paragrafit 1, llogaritet në varësi të sasisë e të natyrës së mallrave në fjalë në datën e pranimit të deklaratës që i vendos ato nën regjimin e përpunimit pasiv dhe në baze të elementeve të tjera të taksimit, të zbatueshme mbi këto mallra në datën e pranimit të deklaratës së vendosjes në qarkullim të lirë të produkteve kompensuese. Si vlerë e mallrave të eksportuara përkohësisht llogaritet ajo që merret parasysh për këto mallra në përcaktimin e vlerës doganore të produkteve kompensuese, në përputhje me nenin 37(1)(b)(i) ose, nëse vlera nuk mund të përcaktohet në këtë mënyrë, merret diferenca midis vlerës doganore të produkteve kompensuese dhe shpenzimeve të përpunimit të përcaktuara me mënyrë të arsyeshme. Megjithatë,

a) disa prej detyrimeve, të përcaktuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, nuk merren parasysh në llogaritjen e shumës që duhet zbritur;

b) në qoftë se përpara se të vendoseshin nën regjimin e përpunimit pasiv, mallrat e eksportit të përkohshëm ishin vendosur në qarkullim të lirë me detyrim të reduktuar për arsye të përdorimit të tyre të veçantë, dhe për aq kohë sa vazhdojnë të ekzistojnë kushtet e dhënies së detyrimit të reduktuar, shuma që zbritet është shuma e detyrimeve të importit të vjela efektivisht në datën e vendosjes së mallrave në qarkullim të lirë.

3. Kur mallrat e eksportuara përkohësisht mund të përfitonin në datën e vendosjes në qarkullim të lirë, një detyrim të reduktuar ose zero për arsye të përdorimit të tyre të veçantë, kjo shumë merret parasysh, me kusht që këto mallra t'u jenë nënshtruar përpunimeve që përputhen me një përdorim të tillë të veçantë në vendin ku është kryer përpunimi ose përpunimi i fundit.

4. Kur produktet kompensuese përfitojnë një masë tarifore preferenciale për qëllimin e nenit 28(3)(d) dhe (e), dhe kjo masë është në fuqi për mallrat që bëjnë pjesë në të njëjtin klasifikim tarifor, si dhe mallrat e eksportuara përkohësisht, masa e detyrimeve të importit që merret parasysh në përcaktimin e shumës që duhet zbritur sipas paragrafit 1, është masa që do të zbatohej nëse mallrat e eksportuara përkohësisht do të plotësonin kushtet në të cilat kjo masë preferenciale mund të zbatohet.

5. Ky nen nuk bie ndesh me zbatimin e dispozitave të zbatuara ose të zbatueshme në kuadrin e tregtisë midis Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera, të cilat mund të parashikojnë përjashtimin prej detyrimeve të importit për disa produkte kompensuese.

Neni 172

1. Kur operacionet e përpunimit kanë për qëllim riparimin e mallrave të eksportuara përkohësisht, këto mallra vendosen në qarkullim të lirë me përjashtim të plotë nga detyrimet e importit, nëse autoritetet

doganore binden se mallrat janë riparuar pa pagesë, ose në bazë të një detyrimi kontraktual ose ligjor garancie, ose për shkak të një defekti prodhimi.

2. Paragrafi 1 nuk zbatohet kur defekti vihet re në çastin kur mallrat në fjalë vendosen për herë të parë në qarkullim të lirë.

Neni 173

Kur operacionet e përpunimit kanë për qëllim riparimin e mallrave të eksportuara përkohësisht, dhe ky riparim kryhet kundrejt pagesës, përjashtimi i pjesshëm nga detyrimet e importit sipas nenit 165 jepet duke përcaktuar shumën e detyrimeve që zbatohen në bazë të elementeve të taksimit për produktet kompensuese në datën e pranimit të deklaratës së vendosjes në qarkullim të lirë të këtyre produkteve dhe duke marrë si vlerë doganore një shumë të barabartë me shpenzimet e riparimit, me kusht që këto shpenzime të përbëjnë të vetmin shpenzim të kryer nga mbajtësi i autorizimit dhe të mos jenë ndikuar nga ndonjë lidhje midis këtij të fundit dhe personit që kryen riparimin.

**IV. Përpunimi pasiv me përdorim të sistemit të shkëmbimeve standarde**

Neni 174

1. Sipas kushteve të përcaktuara në nenet 174 deri 179, të cilat zbatohen së bashku me dispozitat pararendëse, sistemi i shkëmbimeve standarde lejon që një mall i importuar, që këtej e tutje i quajtur “produkt zëvendësues”, të zëvendësojë një produkt kompensues.

2. Autoritetet doganore lejojnë përdorimin e shkëmbimeve standarde, kur operacioni i përpunimit ka të bëjë me riparimin e mallrave shqiptare.

3. Pa rënë ndesh me nenin 179, dispozitat e zbatueshme për produktet kompensuese zbatohen edhe për produktet zëvendësuese.

4. Autoritetet doganore lejojnë që, në kushtet e parashikuara prej vetë këtyre autoriteteve, produktet zëvendësuese të importohen, para se të eksportohen mallrat e eksportit të përkohshëm (importim paraprak). Importimi paraprak i një produkti zëvendësues kërkon dhënien e një garancie për të mbuluar shumën e detyrimeve të importit.

Neni 175

1. Produktet zëvendësuese duhet të kenë të njëjtin klasifikim tarifor, cilësi tregtare dhe karakteristika teknike të njëjta me mallrat e eksportit të përkohshëm, njësoj sikur këto të fundit t’u ishin nënshtruar riparimeve në fjalë.

2. Kur mallrat e eksportit të përkohshëm janë përdorur përpara eksportimit, edhe produktet zëvendësuese duhet të jenë të përdorura dhe nuk mund të jenë produkte të reja. Megjithatë, autoritetet doganore mund të autorizojnë shmangie nga ky rregull, nëse produkti zëvendësues është dhënë pa pagesë, qoftë për arsye të një detyrimi kontraktual ose ligjor garancie, qoftë për shkak të një defekti prodhimi.

Neni 176

Shkëmbimet standarde autorizohen vetëm kur është e mundur të verifikohet se janë plotësuar kushtet e parashikuara nga neni 175.

Neni 177

1. Në rast importimi paraprak, mallrat e eksportit duhet të eksportohen përkohësisht brenda një afati dymujor, duke filluar nga data e pranimit prej autoriteteve doganore të deklaratës se vendosjes në qarkullim të lirë të mallrave zëvendësuese.

2. Megjithatë, kur justifikohet nga rrethana të jashtëzakonshme, autoritetet doganore, me kërkesë të personit të interesuar, mund të zgjasin afatin e përmendur në paragrafin 1, brenda kufijsh kohorë të arsyeshëm.

Neni 178

Në rast importimi paraprak dhe kur zbatohet neni 171, shuma që duhet zbritur përcaktohet në bazë të elementeve të taksimit të zbatueshëm mbi mallrat e eksportit të përkohshëm në datën e pranimit të deklaratës, që i vendos këto mallra nën regjim.

Neni 179

Neni 167(2) dhe neni 168 (b) nuk zbatohen në kuadrin e sistemit të shkëmbimeve standarde.

**V. Dispozita të tjera**

Neni 180

Procedura e parashikuar në kuadrin e regjimit të përpunimit pasiv zbatohet edhe për vënien në jetë të masave të politikës tregtare jotarifore.

SEKSIONI 4

EKSPORTI

Neni 181

1. Regjimi i eksportit lejon që mallrat shqiptare të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë. Eksportimi sjell zbatimin e formaliteteve të daljes, duke përfshirë edhe masat e politikës tregtare dhe, kur është rasti, detyrimet e eksportit.

2. Me përjashtim të mallrave të vendosura nën regjimin e përpunimit pasiv, të gjitha mallrat shqiptare të destinuara për eksport vendosen nën regjimin e eksportit.

3. Rastet dhe kushtet në të cilat mallrat që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë nuk i nënshtrohen një deklarate eksporti, përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi dhe, nëse është e nevojshme, me dispozita të nxjerra nga ministri i Financave.

4. Deklarata e eksportit duhet të depozitohet në zyrën doganore kompetente për mbikëqyrjen e vendit ku është vendosur eksportuesi, ose ku mallrat janë paketuar ose ngarkuar për eksport. Në rast se është e nevojshme, përjashtimet nga ky rast përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Neni 182

Çlirimi i mallrave për eksport jepet me kusht që mallrat në fjalë të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë në të njëjtën gjendje që ato ishin në datën e pranimit të deklaratës së eksportit.

KREU 3

LLOJE TË TJERA DESTINACIONI DOGANOR

SEKSIONI 1

ZONAT E LIRA DHE MAGAZINAT E LIRA

**A. Dispozita të përgjithshme**

Neni 183

Zonat e lira dhe magazinat e lira janë pjesë të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë ose mjedise të vendosura në këtë territor dhe të ndara nga pjesa tjetër e tij, në të cilat:

a) mallrat joshqiptare, për qëllim të zbatimit të detyrimeve të importit dhe të masave të politikës tregtare të importit, konsiderohen sikur nuk ndodhen në territorin doganor shqiptar, me kusht që të mos jenë vendosur në qarkullim të lirë ose të mos jenë vendosur nën një regjim tjetër doganor dhe as përdorur apo konsumuar në kushte të ndryshme nga ato të parashikuara në legjislacionin doganor;

b) mallrat shqiptare, të cilat me dispozita të veçanta, për shkak të vendosjes në një zonë të lirë ose magazinë të lirë, përfitojnë nga masat që normalisht shoqërojnë eksportin e mallrave.

Neni 184

1. Këshilli i Ministrave mund të përcaktojë pjesë të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë si zona të lira. Ministri i Financave miraton paraprakisht ndërtimin e çdo lloj ndërtese në një zonë të lirë. Gjithashtu, ministri i Financave autorizon krijimin e magazinave të lira.

2. Këshilli i Ministrave përcakton kufijtë gjeografikë të çdo zone të lirë.

3. Zonat e lira duhet të përcaktohen me saktësi dhe të rrethohen. Këshilli i Ministrave përcakton pikat e hyrjes dhe të daljes për çdo zonë të lirë. Ministri i Financave përcakton pikat e hyrjes dhe të daljes për çdo magazinë të lirë.

Neni 185

1. Kufijtë dhe pikat e hyrjes e të daljes nga zonat e lira dhe magazinat e lira i nënshtrohen mbikëqyrjes së autoriteteve doganore.

2. Personat dhe mjetet e transportit që hyjnë ose dalin nga një zonë e lirë ose magazinë e lirë mund t'i nënshtrohen kontrollit doganor.

3. Hyrja në një zonë të lirë ose magazinë të lirë mund t'u ndalohet personave që nuk ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme për respektimin e dispozitave të këtij Kodi.

4. Kur mallrat hyjnë ose dalin nga një magazinë e lirë, një kopje e dokumentit të transportit që shoqëron këto mallra i dorëzohet autoriteteve doganore. Kur mallrat hyjnë ose dalin nga një zonë e lirë, një kopje e dokumentit të transportit që shoqëron mallrat mbahet në dispozicion të autoriteteve doganore. Autoritetet doganore mund të kontrollojnë mallrat që hyjnë, qëndrojnë ose dalin nga zona e lirë ose magazina e lirë. Kur kërkohet të kryhen kontrolle të tilla, mallrat vihen në dispozicion të autoriteteve doganore.

**B. Hyrja e mallrave në zona të lira ose magazina të lira**

Neni 186

1. Si mallrat shqiptare ashtu dhe ato joshqiptare mund të vendosen në një zonë të lirë ose magazinë të lirë.

2. Megjithatë, autoritetet doganore mund të kërkojnë që mallrat, të cilat paraqesin rrezikshmëri, ose që ka mundësi të dëmtojnë mallra të tjera, ose të cilat për arsye të tjera kërkojnë instalime të veçanta, të vendosen në mjedise të pajisura posaçërisht për të përballuar këto kërkesa.

Neni 187

1. Pa rënë ndesh me nenin 185(4), mallrat që hyjnë në një zonë të lirë ose magazinë të lirë nuk ka nevojë të paraqiten pranë autoriteteve doganore dhe as të depozitohet deklaratë doganore.

2. Mallrat u paraqiten autoriteteve doganore dhe u nënshtrohen formaliteteve doganore të parashikuara vetëm kur ato:

a) janë vendosur nën një regjim doganor i cili përfundon kur këto mallra hyjnë në një zonë të lirë ose magazinë të lirë; megjithatë, kjo paraqitje nuk kërkohet kur regjimi doganor në fjalë lejon përjashtimin nga detyrimi për paraqitjen e mallrave;

b) janë vendosur në një zonë të lirë ose magazinë të lirë në zbatim të një vendimi që lejon rimbursimin ose shuarjen e detyrimeve të importit për to;

c) përfitojnë nga masat e përmendura në nenin 183(b).

3. Autoritetet doganore duhet të njoftohen për mallrat që i nënshtrohen detyrimeve të eksportit ose dispozitave të tjera mbi eksportin.

4. Me kërkesë të palës së interesuar, autoritetet doganore lëshojnë vërtetim për statusin shqiptar ose joshqiptar të mallrave të vendosura në një zonë të lirë ose magazinë të lirë.

**C. Funksionimi i zonave të lira dhe magazinave të lira**

Neni 188

Qëndrimi i mallrave në zona të lira ose magazina të lira nuk u nënshtrohet kufijve kohore.

Neni 189

1. Kryerja e çdo veprimtarie industriale, tregtare ose shërbimi në një zonë të lirë ose magazinë të lirë autorizohet sipas kushteve të parashikuara në këtë Kod. Kryerja e këtyre veprimtarive u njoftohet paraprakisht autoriteteve doganore.

2. Autoritetet doganore mund të vendosin ndalime ose kufizime të caktuara të veprimtarive të përmendura në paragrafin 1, duke pasur parasysh llojin e mallrave në fjalë ose nevojat e mbikëqyrjes doganore.

3. Autoritetet doganore mund t'u ndalojnë ushtrimin e veprimtarisë në një zonë të lirë ose magazinë të lirë personave që nuk paraqesin garancitë e nevojshme të respektimit të normave të parashikuara në këtë Kod.

Neni 190

1. Mallrat joshqiptare të vendosura në një zonë të lirë ose magazinë të lirë, gjatë kohës që qëndrojnë në zonën e lirë ose magazinën e lirë mund:

a) të vendosen në qarkullim të lirë, sipas kushteve të parashikuara nga ky regjim dhe nga neni 194;

b) t'u nënshtrohen pa autorizim formave të zakonshme të trajtimit, të përmendura në nenin 132(1);

c) të vendosen nën regjimin e përpunimit aktiv, sipas kushteve të parashikuara nga ky regjim;

d) të vendosen nën regjimin e përpunimit nën kontroll doganor, sipas kushteve të parashikuara nga ky regjim;

e) të vendosen nën regjimin e lejimit të përkohshëm, sipas kushteve të parashikuara nga ky regjim;

f) të braktisen në përputhje me nenin 197;

g) të shkatërrohen, me kusht që personi i interesuar t'u ofrojë autoriteteve doganore gjithë informacionin që ato e gjykojnë të nevojshëm.

2. Kur mallrat vendosen në një nga regjimet e përmendura në nënparagrafët (c), (d), ose (e), autoritetet doganore ndërmarrin masat e parashikuara të kontrollit, për aqsa është e nevojshme që të njihen kushtet e veprimit dhe të mbikëqyrjes doganore të zonave të lira apo magazinave të lira.

Neni 191

1. Në rastet kur nuk zbatohet neni 190, mallrat joshqiptare dhe mallrat shqiptare të përmendura në nenin 183(b) nuk konsumohen ose përdoren në zona të lira ose magazina të lira.

2. Pa rënë ndesh me dispozitat që zbatohen për mallrat që konsumohen ose mbahen në bordin e mjeteve të transportit, dhe kur regjimi në fjalë e lejon, paragrafi 1 nuk pengon përdorimin ose konsumimin e mallrave, vendosja në qarkullim të lirë ose lejimi i përkohshëm i të cilave nuk sjell zbatimin e detyrimeve të importit ose të masave të politikës tregtare. Në këtë rast nuk nevojitet deklarata për vendosjen në qarkullim të lirë ose për lejimin e përkohshëm. Megjithatë, kjo deklaratë është e nevojshme kur mallrat përllogariten përkundrejt një kuote ose tavani.

Neni 192

1. Të gjithë personat, të cilët ushtrojnë një veprimtari që lidhet me ruajtjen, punimin, përpunimin, shitjen ose blerjen e mallrave në një zonë të lirë ose magazinë të lirë, duhet të mbajnë një regjistër magazine sipas formës së miratuar nga autoritetet doganore. Mallrat shënohen në regjistrin e magazinës sapo të futen në mjediset e këtij personi. Regjistri i magazinës duhet të jetë i tillë që t'u lejojë autoriteteve doganore të identifikojnë mallrat dhe të regjistrojnë lëvizjet e tyre.

2. Kur mallrat transbordohen brenda një zone të lirë, dokumentet që lidhen me këtë operacion mbahen në dispozicion të autoriteteve doganore. Ruajtja afatshkurtër e mallrave për një transbordim të tillë quhet pjesë përbërëse e operacionit.

**D. Dalja e mallrave nga zonat e lira ose magazinat e lira**

Neni 193

1. Pa rënë ndesh me dispozitat përkatëse të legjislacionit doganor që rregullojnë fusha të veçanta, mallrat që dalin nga një zonë e lirë ose magazinë e lirë mund:

a) të eksportohen ose rieksportohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë; ose

b) të hyjnë në një pjesë tjetër të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Dispozitat e pjesës III, me përjashtim të neneve 73 deri 78, ku bëhet fjalë për mallrat shqiptare, zbatohen për mallrat e sjella në pjesë të tjera të atij territori, me përjashtim të mallrave që dalin nga ajo zonë me rrugë detare ose ajrore, pa u vendosur nën regjimin e tranzitit ose nën një regjim tjetër doganor.

Neni 194

1. Kur lind një borxh doganor që ka të bëjë me mallra joshqiptare dhe vlera doganore e këtyre mallrave bazohet në një çmim realisht të paguar ose që duhet paguar, i cili përfshin shpenzimet e magazinimit ose të ruajtjes së mallrave, ndërkohë që ato qëndrojnë në një zonë të lirë ose në një magazinë të lirë, këto shpenzime nuk përfshihen në vlerën doganore në rast se ato janë paraqitur veçmas nga çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar për mallrat.

2. Kur mallrat në fjalë i janë nënshtruar, në një zonë të lirë apo në një magazinë të lirë, njërës prej formave të zakonshme të përpunimit për qëllimin e nenit 132(1), lloji, vlera doganore dhe sasia e mallrave në bazë të të cilave bëhet përcaktimi i shumës se detyrimeve të importit, me kërkesë të deklaruesit dhe me kusht që ky përpunim të jetë përmendur në autorizimin e dhënë në përputhje me paragrafin 2 të nenit të sipërpërmendur, janë ato që merren parasysh për të tilla mallra në çastin e përmendur në nenin 229, sikur ato të mos kishin pësuar trajtimin e përmendur më sipër. Megjithatë, anashkalime nga kjo normë përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Neni 195

1. Kur mallrat hyjnë ose rihyjnë në një pjesë tjetër të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, ose vendosen nën një regjim doganor, certifikata e përmendur në nenin 187(4) përdoret si provë e statusit

shqiptar ose joshqiptar të këtyre mallrave.

2. Kur nga certifikata ose me ndonjë mënyrë tjetër nuk provohet që mallrat kanë status shqiptar ose joshqiptar, mallrat konsiderohen si:

a) mallra shqiptare, për qëllim të zbatimit të detyrimeve të eksportit dhe të licencave të eksportit, si dhe të masave përcaktuara në kuadër të politikave tregtare;

b) mallra joshqiptare në të gjitha rastet e tjera.

Neni 196

Autoritetet doganore, para se mallrat të eksportohen ose rieksportohen nga një zonë e lirë ose magazinë e lirë, sigurohen se janë respektuar dispozitat ligjore për eksportimin ose rieksportimin.

SEKSIONI 2
RIEKSPORTIMI, ASGJËSIMI DHE BRAKTISJA

Neni 197
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Mallrat joshqiptare mund:
a) të rieksportohen jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;
b) të asgjësohen;
c) te braktisen dhe te kalojne ne favor te buxhetit te shtetit, sipas akteve ligjore ne fuqi.

2. Rieksportimi sjell zbatimin e formaliteteve të parashikuara për daljen e mallrave, përfshirë këtu edhe masa të politikës tregtare. Rastet kur mallrat joshqiptare mund të vendosen nën regjim pezullues me synim që të mos zbatohen masa të politikës tregtare për eksportin, mund të përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

3. Rieksportimi ose asgjësimi u njoftohet paraprakisht autoriteteve doganore. Autoritetet doganore ndalojnë rieksportimin, nëse kjo parashikohet nga formalitetet ose masat e përmendura në fjalinë e pare të paragrafit 2. Për mallrat e destinuara për rieksportim, të cilat gjatë qëndrimit në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë vendosen nën një regjim doganor ekonomik, duhet të depozitohet një deklaratë doganore për qëllimin e neneve 84 deri 102. Në të tilla raste zbatohet neni 181 (3) dhe (4). Braktisja kryhet në përputhje me aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

4. "Shpenzimet e asgjesimit ose te braktisjes nuk perballohen nga buxheti i shtetit."

5. Çdo mbetjeje ose hedhurine, që del nga asgjësimi, i caktohet një destinacion doganor që parashikohet për mallra joshqiptare. Ato mbeten nën mbikëqyrje doganore deri në çastin e përmendur në nenin 41(3).

PJESA V
MALLRAT QË DALIN NGA TERRITORI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 198

1. Mallrat që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore. Ato mund të jenë objekt i kontrollit të autoriteteve doganore në përputhje me dispozitat në fuqi. Këto mallra dalin nga territori në fjalë nëpër rrugën e përcaktuar nga autoritetet doganore dhe në përputhje me procedurat e parashikuara nga këto autoritete.

2. Mallrat që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë paraqiten pranë zyrës doganore kompetente të kufirit, në varësi të mjetit të transportit, ku kryhen të gjitha kontrollet dhe formalitetet e nevojshme për të verifikuar nëse për mallrat janë paguar të gjitha detyrimet doganore përkatëse në eksport, si dhe për të shënuar në dokumentet shoqëruese, kur është e nevojshme, daljen e mallrave nga ky territor doganor.

PJESA VI
OPERACIONE TË PRIVILEGJUARA

KREU 1
PËRJASHTIMET NGA DETYRIMET DOGANORE

Neni 199
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)
(ndryshuar me ligjin Nr. 8999, date 30.1.2003)

1. Përjashtimi nga detyrimet e importit jepet për rastet e parashikuara në paragrafin 2 ose, kur është e nevojshme, me ligj të veçantë. Mënyrat, kufinjtë në vlerë e në sasi, formalitetet dhe kushtet për dhënien e përjashtimit nga detyrimet e importit përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

2. Përjashtimet nga detyrimet doganore në import jepen në rastet e mëposhtme:

a) sende vetjake që u përkasin personave fizikë, që ndryshojnë vendqëndrimin e tyre të zakonshëm nga një vend tjetër në Republikën e Shqipërisë;

b) sende të importuara në raste martese;

c) sende vetjake të përfituara nga trashëgimia;

d) uniforma shkollore, pajisje e sende shkollore dhe sende të tjera me karakter jotregtar për përdorim nga nxënës e studentë;

e) dërgesa me vlerë të papërfillshme;

f) mallra që gjenden në bagazhin vetjak të udhëtarëve;

g) kafshë laboratori dhe lëndë biologjike ose kimike që nevojiten për kërkime;

h) substanca terapeutike me origjinë njerëzore dhe reagente për përcaktimin e grupeve të gjakut e të përbërjes së tij, organe njerëzore për transplantime;

i) lëndë referuese për kontrollin cilësor të produkteve mjeksore;

j) prodhime farmaceutike të përdorura në veprimtari sportive ndërkombëtare që zhvillohen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

k) ndihma humanitare të ardhura në adresë e për llogari të organizatave bamirëse humanitare, të institucioneve të kultit, të enteve publike, si dhe të institucioneve shtetërore buxhetore;

l) dekorime dhe shpërblime për tituj nderi;

m) dhurata të përfituara në kuadrin e marrëdhënieve ndërkombëtare;

n) mallra për t'u përdorur nga kryetari i shtetit;

o) mallrat e importuara me qellim nxitjeje te tregtise dhe reklamim veprimtarie; * (ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

p) dërgesa të destinuara për organizata që mbrojnë të drejtat e autorit, ose të drejta të tjera industriale apo tregtare;

q)botime informative me karakter turistik;

r) dokumentecione e artikuj të ndryshëm, siç detajohet në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi;

s) materiale të ndryshme për paketimin dhe ruajtjen e mallrave gjatë transportimit të tyre;

t) ushqime kafshësh dhe pajisje që nevojiten gjatë transportit të kafshëve;

u) karburant dhe vajra lubrifikuese në depozitën e automjeteve;

v) arkivole, urna dhe zbukurime e pajisje funerali për to, si dhe materiale që shërbejnë për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe zbukurimin e monumenteve ose varrezave të viktimave të luftës;

x) furnizimet e bordit dhe pajisjet e nevojshme për funksionimin normal të mjeteve.

3. Përjashtimet nga detyrimet e importit jepen, gjithashtu, në çdo rast tjetër të parashikuar me marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe të nënshkruara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe të ratifikuara nga Kuvendi, për aqsa këto marrëveshje e parashikojnë shprehimisht përjashtimin nga detyrimet e importit.

4. Ministri i Financave mund te autorizoje hapjen e "Duty free shops", (dyqane te cliruara nga taksat) ne aeroporte, qe ndodhen ne zonen doganore te territorit doganor te Republikes se Shqiperise, per shitjen e produkteve, me perjashtim nga detyrimet e importit.
Formalitetet dhe procedurat qe ndiqen ne keto raste percaktohen me vendim te Keshillit te Ministrave.

5. Autorizimet e regjimit te magazines doganore te tipit C, te miratuara deri ne hyrjen ne fuqi te ketij ligji, per hapjen e "Duty free shops" (dyqane te cliruara nga taksat), ne zonat doganore tokesore, kufitare, dhe ne portet detare, me perjashtim te atyre te aeroporteve, revokohen pas 30 diteve nga hyrja ne fuqi e ketij ligji. Pas kesaj date, mallrave gjendje u jepet njeri nga destinacionet doganore, te parashikuara ne dispozitat e ketij kodi, ndersa te gjitha "Duty free shops", me perjashtim te atyre ne aeroporte, mbyllen. *(ndryshuar me ligjin Nr. 8999, date 30.1.2003)

## KREU 2
## MALLRAT E RIKTHYERA

### Neni 200

1. Mallrat shqiptare, të cilat, pasi janë eksportuar nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë,

rikthehen në këtë territor dhe vendosen në qarkullim të lirë brenda një periudhe tre vjeçare, me kërkesë të personit të interesuar, përfitojnë përjashtim nga detyrimet e importit.

Megjithatë:

a) periudha tre vjeçare mund të zgjatet duke marrë parasysh rrethanat e veçanta;

b) kur përpara eksportimit nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë mallrat e rikthyera ishin vendosur në qarkullim të lirë me detyrime importi të reduktuara ose zero, për arsye të përdorimit të tyre të veçantë, përjashtimi nga detyrimet sipas paragrafit 1 jepet vetëm nëse mallrat do të riimportohen për të njëjtin qëllim. Kur ndryshon qëllimi për të cilin mallrat në fjalë do të importohen, shuma e detyrimeve të importit që duhen paguar për këto mallra, reduktohet, duke i zbritur çdo shume të paguar për mallrat, kur ato u vendosën në qarkullim të lirë për herë të parë. Nëse shuma e fundit është më e madhe se ajo e paguar në çastin e vendosjes në qarkullim të lirë të mallrave që rikthehen, nuk jepet asnjë lloj rimbursimi.

2. Përjashtimi nga detyrimet doganore i përmendur në paragrafin 1 nuk jepet për:

a) mallrat e eksportuara nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë nën regjimin e përpunimit pasiv, me përjashtim të rastit kur këto mallra mbeten në të njëjtën gjendje në të cilën ishin eksportuar;

b) mallrat, të cilat i janë nënshtruar një mase që përfshin eksportimin e tyre në një vend tjetër. Rrethanat dhe kushtet në të cilat kjo kërkesë mund të mos zbatohet, përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Neni 201

Përjashtimi nga detyrimet doganore i parashikuar në nenin 200, jepet vetëm nëse mallrat janë riimportuar në gjendjen në të cilën ishin eksportuar. Rrethanat dhe kushtet në të cilat kjo kërkesë mund të mos zbatohet, përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Neni 202

1. Nenet 200 dhe 201 zbatohen mutatis mutandis për produktet kompensuese të eksportuara ose të rieksportuara më parë, pas një regjimi të përpunimit aktiv.

2. Shuma e detyrimeve të importit përcaktohet në bazë të rregullave të zbatueshme në kuadrin e regjimit të përpunimit aktiv, ku si datë e rieksportimit të produkteve kompensuese merret data e vendosjes së tyre në qarkullim të lirë.

## KREU 3
## PRODUKTET E PESHKIMIT NE DET DHE PRODUKTE TË TJERA TË NXJERRA NGA DETI

Neni 203

Pa rënë ndesh me nenin 29 (2)(f), përjashtohen nga detyrimet e importit kur vendosen në qarkullim të lirë:

a) produktet e peshkimit dhe produkte të tjera të nxjerra nga ujërat territoriale të një vendi tjetër prej anijeve të regjistruara ose të matrikulluara në Republikën e Shqipërisë dhe që mbajnë flamur shqiptar;

b) produkte të përftuara nga produktet e përmendura në pikën (a) në anije fabrikë, që plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën (a).

# PJESA VII
# BORXHI DOGANOR

## KREU 1
## GARANCIA PËR TË MBULUAR NJË BORXH DOGANOR

Neni 204

1. Kur, në përputhje me legjislacionin doganor, autoritetet doganore kërkojnë dhënien e një garancie, me qëllim që të sigurohet pagesa e një borxhi doganor, kjo garanci jepet nga debitori ose personi që mund të bëhet i tillë.

2. Për një borxh doganor autoritetet doganore mund të kërkojnë vetëm një garanci.

3. Autoritetet doganore mund të autorizojnë që garancia të sigurohet nga një person tjetër që nuk është personi të cilit i është kërkuar garancia.

Neni 205

1. Kur legjislacioni doganor e parashikon që sigurimi i garancisë të jetë fakultativ, kërkesa e kësaj garancie lihet në vlerësimin e autoriteteve doganore, për aqsa ato e gjykojnë që shlyerja e një borxhi doganor ekzistues ose që mund të lindë, nuk është e sigurtë se do të bëhet brenda afatit të parashikuar. Kur garancia e përmendur në fjalinë e mësipërme nuk kërkohet, autoritetet doganore pavarësisht nga kjo, mund t'i kërkojnë personit të përmendur në nenin 204 (1) të marrë përsipër përmbushjen e detyrimeve ligjore.

2. Garancia e përmendur në paragrafin e mësipërm, kërkohet:

a) në çastin e zbatimit të dispozitave që kërkojnë garancinë, ose

b) në një çast të mëvonshëm, në qoftë se autoritetet doganore konstatojnë që shlyerja e borxhit doganor që ka lindur ose mund të lindë nuk është e sigurtë se do të bëhet brenda afatit të parashikuar.

Neni 206

Me kërkesë të personit të përmendur në nenin 204 (1) ose (3), autoritetet doganore mund të lejojnë dhënien e një garancie globale për të mbuluar dy ose më shumë veprime, për të cilat ka lindur ose mund të lindë një borxh doganor.

Neni 207

1. Kur legjislacioni doganor e bën të detyrueshme dhënien e garancisë, autoritetet doganore caktojnë shumën e kësaj garancie në një masë të njëjtë me:

a) shumën e saktë të borxhit ose të borxheve doganore në fjalë, kur kjo shumë mund të përcaktohet me saktësi në çastin kur kërkohet garancia;

b) shumën maksimale, sipas vlerësimit të autoriteteve doganore, të borxhit ose të borxheve doganore që kanë lindur ose mund të lindin në raste të tjera.

Kur jepet garanci globale për një borxh doganor, i cili ndryshon me kalimin e kohës, shuma e kësaj garancie fiksohet në një nivel që lejon mbulimin e borxhit doganor në çdo kohë.

2. Kur dispozitat e këtij Kodi parashikojnë dhënien e garancisë fakultative dhe autoritetet doganore kërkojnë dhënien e saj, shuma e garancisë caktohet nga këto autoritete në mënyrë të tillë që të mos kapërcejë nivelin e përmendur në paragrafin 1.

Neni 208

Garancia mund të jepet në formën e një:

a) depozite në të holla, ose

b) dorëzanie.

Neni 209

1. Depozita në të holla duhet të bëhet në monedhën zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

2. Janë të barazvlefshme me një depozitë në të holla:

a) dorëzimi i një çeku, pagesa e të cilit garantohet nga institucioni që e ka lëshuar atë, në çdo mënyrë që quhet e pranueshme për autoritetet doganore;

b) dorëzimi i çdo instrumenti tjetër të njohur prej autoriteteve doganore si mënyrë pagese.

3. Garancia në formën e një depozite në të holla ose çdo forme pagese e barazvlefshme me të, jepet në përputhje me dispozitat në fuqi.

Neni 210

1. Dorëzanësi merr përsipër me shkrim të paguajë personalisht dhe bashkërisht me debitorin shumën e borxhit doganor të garantuar që duhet paguar.

2. Dorëzanësi duhet të jetë një person i tretë i vendosur në Republikën e Shqipërisë dhe i pranuar nga autoritetet doganore.

3. Autoritetet doganore mund të refuzojnë miratimin e dorëzanësit ose të llojit të garancisë së propozuar, kur kjo e fundit gjykohet se nuk siguron pagesën e borxhit doganor brenda afatit të përcaktuar.

Neni 211
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Pa rene ndesh me aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, personi, të cilit i kërkohet sigurimi i garancisë, është i lirë të zgjedhë midis llojeve të garancive të parashikuara në nenin 208.

2. Në përputhje me dispozitat e këtij Kodi dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, autoritetet doganore mund të refuzojnë pranimin e llojit të garancisë së propozuar, kur ai është i papajtueshëm me funksionimin e rregullt të regjimit doganor në fjalë. E njëjta procedurë zbatohet edhe për garancinë e

propozuar. Autoritetet doganore mund të kërkojnë që lloji i garancisë së zgjedhur të mbahet vetëm për një periudhë të caktuar.

Neni 212
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Autoritetet doganore mund te pranojne lloje garancish te ndryshme nga ato te permendura ne nenin 208 dhe ne aktet nenligjore ne zbatim te ketij Kodi, vetem kur keto sigurojne ne menyre te njejte pagesen e borxhit doganor.
2. Autoritetet doganore refuzojnë garancinë e propozuar nga debitori, kur gjykojnë se kjo garanci nuk siguron pagesën e borxhit doganor.
3. Me të njëjtat kufizime të shprehura në paragrafin 2, autoritetet doganore mund të pranojnë një depozitë në të holla pa u plotësuar kushtet e parashikuara në nenin 209(1).

Neni 213

Kur autoritetet doganore gjykojnë se garancia e ofruar nuk siguron, ose nuk është më e sigurtë ose e mjaftueshme për të siguruar pagesën e një borxhi doganor brenda afatit të caktuar, ato kërkojnë prej personit të përmendur në nenin 204(1), sipas preferencës së këtij të fundit, të sigurojë një garanci shtesë ose të zëvendësojë garancinë e mëparshme me një garanci të re.

Neni 214

1. Garancia nuk çlirohet për sa kohë që borxhi doganor, për të cilin kjo garanci është lëshuar, nuk është shlyer ose mund të lindë përsëri. Garancia duhet të çlirohet sapo borxhi doganor shlyhet ose nuk mund të lindë përsëri.
2. Kur borxhi doganor shlyhet pjesërisht ose mund të lindë vetëm në lidhje me një pjesë të shumës që është siguruar, me kërkesë të personit të interesuar çlirohet vetëm pjesa përkatëse e garancisë, me përjashtim të rastit kur shuma në fjalë nuk e justifikon këtë veprim.

Neni 215

Dispozitat e këtij kreu nuk zbatohen vetëm kur në marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, është parashikuar ndryshe.

KREU 2
LINDJA E NJË BORXHI DOGANOR

Neni 216

1. Borxhi doganor i importit lind nëpërmjet:
a) vendosjes në qarkullim të lirë të mallrave që u nënshtrohen detyrimeve të importit, ose
b) vendosjes së këtyre mallrave nën regjimin e lejimit të përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimet e importit.
2. Borxhi doganor lind në datën e pranimit të deklaratës doganore në fjalë.
3. Debitor është deklaruesi. Në rastin e përfaqësimit të tërthortë, është gjithashtu debitor personi për llogari të të cilit bëhet deklarata doganore. Kur deklarata doganore lidhur me një nga regjimet e përmendura në paragrafin 1 hartohet në bazë të një informacioni që tregon se një pjesë ose e gjithë shuma e detyrimeve doganore që duhen paguar nuk është vjelë, personat që e kanë dhënë informacionin e nevojshëm për hartimin e deklaratës dhe ata që ishin në dijeni ose objektivisht duhej të ishin në dijeni se ky informacion ishte i rremë, mund të quhen, gjithashtu, debitorë në përputhje me dispozitat në fuqi.

Neni 217

1. Një borxh doganor importi lind nëpërmjet:
a) futjes së paligjshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave që duhet të paguajnë detyrime importi, ose
b) futjes së paligjshme në një pjesë tjetër të këtij territori të mallrave të tilla që janë të vendosura në një zonë të lirë ose magazinë të lirë.
Për qëllim të këtij neni, me futje të paligjshme kuptohet çdo futje mallrash në kundërshtim me dispozitat e neneve 42, 43, 65 dhe 66 dhe të rastit të dytë të nenit 193.

2. Borxhi doganor lind në çastin kur mallrat futen në mënyrë të paligjshme.

3. Debitorët janë:

a) personi që i fut këto mallra në mënyrë të paligjshme;

b) çdo person që merr pjesë në futjen e paligjshme të mallrave dhe që ka dijeni ose objektivisht duhet të dijë që kjo hyrje është e paligjshme, dhe

c) çdo person që blen ose mban mallrat në fjalë dhe që, në çastin e blerjes ose të mbajtjes së mallrave, ishte në dijeni ose objektivisht duhej të dinte që ato ishin futur në mënyrë të paligjshme.

Neni 218

1. Borxhi doganor i importit lind nëpërmjet shmangies nga mbikëqyrja doganore e mallrave që i nënshtrohen detyrimeve të importit.

2. Borxhi doganor lind që në çastin kur mallrat i shmangen mbikëqyrjes doganore.

3. Debitor është:

a) personi që i shmang mallrat nga mbikëqyrja doganore;

b) çdo person që merr pjesë në këtë shmangie dhe që është në dijeni ose që objektivisht duhet të dinte se mallrat i janë shmangur mbikëqyrjes doganore;

c) çdo person që blen ose mban mallrat në fjalë dhe që, në çastin e blerjes ose të mbajtjes së mallrave, ishte në dijeni ose objektivisht duhej të dinte që ato mallra i ishin shmangur mbikëqyrjes doganore, dhe

d) kur është rasti, personi të cilit i takon të përmbushë detyrimet që lindin nga ruajtja e përkohshme e mallrave ose nga përdorimi i regjimit doganor nën të cilin mallrat janë vendosur.

Neni 219

1. Borxhi doganor i importit lind nëpërmjet:

a) mospërmbushjes së njërit prej detyrimeve që lindin nga ruajtja e përkohshme ose nga përdorimi i regjimit doganor nën të cilin janë vendosur mallrat që i nënshtrohen detyrimeve të importit, ose

b) moszbatimit të njërit prej kushteve të përcaktuara për vendosjen e mallrave nën këtë regjim ose për dhënien e së drejtës të pagesës së reduktuar ose zero të detyrimeve të importit për arsye të përdorimit të veçantë të mallrave, në raste që janë të ndryshme prej atyre të përmendura në nenin 218, veç po qe se konstatohet se këto mangësi nuk kanë pasur në praktikë asnjë pasojë mbi funksionimin e duhur të magazinimit të përkohshëm ose regjimit doganor në fjalë.

2. Borxhi doganor lind në çastin kur nuk përmbushet detyrimi, mospërmbushja e të cilit sjell lindjen e borxhit doganor, ose në çastin kur mallrat janë vendosur nën regjimin doganor në fjalë dhe më pas konstatohet se në të vërtetë nuk është përmbushur njëri prej kushteve për vendosjen e mallrave nën një regjim të tillë ose për dhënien e detyrimeve të importit të reduktuara ose zero për arsye të përdorimit të veçantë të mallrave.

3. Debitor është personi të cilit, sipas rastit, i kërkohet ose të plotësojë kushtet që lindin në lidhje me mallrat për të cilat duhen paguar detyrime importi për arsye të magazinimit të tyre të përkohshëm, ose për arsye të përdorimit të regjimit doganor nën të cilat ato janë vendosur, ose të respektojë kushtet e vendosjes së mallrave nën këtë regjim.

Neni 220

1. Borxhi doganor i importit lind nga konsumi ose përdorimi, në një zonë të lirë ose në një magazinë të lirë, i mallrave që u nënshtrohen detyrimeve të importit, në kushte të ndryshme nga ato të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Kur mallrat zhduken dhe zhdukja e tyre nuk mund të justifikohet në mënyrë bindëse pranë autoriteteve doganore, këto autoritete mund t'i konsiderojnë këto mallra si të hedhura për konsum ose të përdorura në zonën e lirë ose magazinën e lirë.

2. Borxhi lind në çastin kur mallrat konsumohen ose përdoren për herë të parë në kushte të ndryshme nga ato të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

3. Debitor është personi që ka konsumuar ose përdorur mallrat dhe çdo person që ka marrë pjesë në këtë konsumim ose përdorim, duke e ditur, ose që objektivisht duhej të dinte se mallrat po konsumoheshin ose përdoreshin në kushte të ndryshme nga ato të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Kur autoritetet doganore i konsiderojnë mallrat e zhdukura si të konsumuara ose përdorura në zonë të lirë ose magazinë të lirë dhe nuk është e mundur të zbatohet paragrafi i mësipërm, personi që duhet të paguajë borxhin doganor është personi që mesa janë në dijeni autoritetet doganore, i ka pasur në pronësi i fundit këto mallra.

Neni 221

1. Duke anashkaluar nenin 217 dhe 219(1), quhet se nuk ka lindur asnjë borxh doganor importi për

mallra të caktuara, kur personi i interesuar provon se mospërmbushja e kushteve të cilat lindin nga:

a) dispozitat e nenit 42, 43, 65, 66 dhe neni 193(1)(b), ose

b) mbajtja e mallrave në fjalë në magazinim të përkohshëm, ose

c) përdorimi i regjimit doganor nën të cilin mallrat janë vendosur,

rezulton nga shkatërrimi i plotë ose humbja e pakthyeshme e këtyre mallrave për shkak të vetë natyrës së mallrave ose të rrethanave të paparashikuara ose fuqie madhore, ose si pasojë e autorizimit të lëshuar nga autoritetet doganore. Për qëllimet e këtij paragrafi, mallrat quhen të humbura në mënyrë të pakthyeshme kur janë bërë të papërdorshme për cilindo qoftë.

2. Gjithashtu, quhet që nuk lind me asnjë borxh doganor importi për mallrat e vendosura në qarkullim të lirë me detyrime importi të reduktuara ose zero për arsye të përdorimit të tyre të veçantë, kur këto mallra eksportohen ose rieksportohen me lejen e autoriteteve doganore.

Neni 222

Kur, në përputhje me nenin 221(1), quhet se nuk ka lindur një borxh doganor për mallrat e vendosura në qarkullim të lirë me detyrime importi të reduktuara ose zero për arsye të përdorimit të tyre të veçantë, çdo mbetje ose hedhurinë që rezulton nga ky shkatërrim quhen si mallra joshqiptare.

Neni 223

Kur në përputhje me nenin 218 ose 219 lind një borxh doganor për mallrat e vendosura në qarkullim të lirë me detyrime importi të reduktuara për arsye të përdorimit të tyre të veçantë, shuma e paguar në çastin e vendosjes së mallrave në qarkullim të lirë zbritet nga shuma e borxhit doganor. Kjo dispozite zbatohet mutatis mutandis në rastet kur një borxh doganor lind për mbetje ose hedhurina që dalin si pasojë e shkatërrimit të këtyre mallrave.

Neni 224

1. Një borxh doganor eksporti lind nga eksportimi jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, me një deklaratë doganore të mallrave që u nënshtrohen detyrimeve të eksportit.

2. Borxhi doganor lind në çastin kur pranohet deklarata doganore.

3. Debitor është deklaruesi. Në rast përfaqësimi të tërthortë, është gjithashtu debitor personi për llogari të të cilit bëhet deklarata.

Neni 225

1. Borxhi doganor i eksportit lind me daljen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, pa deklaratë doganore, i mallrave që i nënshtrohen pagimit të detyrimeve të eksportit.

2. Borxhi doganor lind në çastin kur këto mallra largohen efektivisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

3. Debitori është:

a) personi që nxjerr mallrat, dhe

b) çdo person që merr pjesë në këtë nxjerrje dhe që ka dijeni ose objektivisht duhej të dinte se asnjë deklaratë doganore nuk është depozituar, por që duhej të ishte depozituar.

Neni 226

1. Borxhi doganor i eksportit lind kur nuk respektohen kushtet në të cilat mallrat lejohen të dalin jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e eksportit.

2. Borxhi lind në çastin kur mallrat mbërrijnë në një destinacion të ndryshëm nga ai për të cilin janë lejuar të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e eksportit, ose, në rast se autoritetet doganore nuk janë në gjendje ta përcaktojnë kufirin kohor kur përfundon afati i fundit i përcaktuar për të dhënë provën se janë plotësuar kushtet e parashikuara për të përfituar përjashtimin nga detyrimet.

3. Debitor është deklaruesi. Në rastin e përfaqësimit të tërthortë, është gjithashtu debitor personi për llogari të të cilit bëhet deklarata.

Neni 227

Borxhi doganor i përmendur në nenin 216 deri 220 dhe 224 deri 226 lind edhe kur lidhet me mallra që u nënshtrohen masave ndaluese ose kufizuese të çdo lloji në importim ose eksportim. Megjithatë, borxhi

doganor nuk lind me futjen e paligjshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të monedhave false ose të substancave narkotike dhe psikotrope, të cilat nuk përfshihen në qarkun ekonomik të mbikëqyrur rreptësisht nga autoritetet doganore, duke synuar përdorimin e tyre për qëllime mjekësore e shkencore. Për qëllimet e legjislacionit penal të zbatueshëm në shkeljet doganore, borxhi doganor quhet se ka lindur kur në një ligj penal detyrimet doganore përbëjnë bazën për përcaktimin e ndëshkimeve, ose kur ekzistenca e borxhit doganor është bazë për ndjekje penale.

Neni 228

Kur për pagesën e një borxhi doganor janë përgjegjës disa persona, ata janë përgjegjës për këtë borxh personalisht dhe bashkërisht.

Neni 229

1. Përveç rasteve të parashikuara shprehimisht nga ky Kod dhe pa rënë ndesh me paragrafin 2, shuma e detyrimeve të importit ose e detyrimeve të eksportit të zbatueshme mbi mallrat, përcaktohet në bazë të rregullave të taksimit që u përshtaten këtyre mallrave në çastin kur lind borxhi doganor përkatës.

2. Kur nuk është e mundur të përcaktohet me saktësi se kur ka lindur borxhi doganor, çasti që merret parasysh në përcaktimin e rregullave të taksimit të përshtatshme për mallrat në fjalë, është çasti kur autoritetet doganore arrijnë në përfundimin se mallrat janë në një gjendje të tillë që i nënshtrohen borxhit doganor. Megjithatë, kur informacioni në dispozicion të autoriteteve doganore u lejon atyre të arrijnë në përfundimin që borxhi doganor ka lindur përpara se ata të arrinin në këtë konstatim, shuma e detyrimeve të importit ose e detyrimeve të eksportit për mallrat në fjalë, përcaktohet në bazë të elementeve të taksimit të mallrave në çastin më të hershëm në kohë, të cilit mund t'i referohet borxhi doganor në bazë të informacioneve të disponueshme.

3. Interesat zbatohen në rrethanat dhe kushtet që përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, për të parandaluar përfitime të padrejta financiare nëpërmjet shtyrjes së datës në të cilën lind borxhi doganor ose bëhet kontabilizimi.

Neni 230

1. Borxhi doganor lind në vendin ku ndodhin faktet që e krijojnë atë.

2. Kur nuk është e mundur të përcaktohet vendi i përmendur në paragrafin 1, borxhi doganor quhet se ka lindur në vendin ku autoritetet doganore arrijnë në përfundimin se mallrat janë në një situatë të tillë që bën të lindë borxhi doganor.

3. Kur një regjim doganor për mallrat nuk është mbyllur, borxhi doganor quhet se ka lindur:

a) në vendin ku mallrat janë vendosur nën këtë regjim, ose

b) në vendin ku mallrat hyjnë në Republikën e Shqipërisë nën këtë regjim.

4. Kur informacioni që disponojnë autoritetet doganore i mundëson ato të përcaktojnë se borxhi doganor kishte lindur kur mallrat ishin në një vend tjetër e në një datë të mëparshme, borxhi doganor quhet se ka lindur në vendin që mund të përcaktohet si vendndodhje e mallrave në çastin me të largët në kohë, kur mund të përcaktohet ekzistenca e borxhit doganor.

Neni 231

1. Për rastet në të cilat marrëveshjet që ekzistojnë midis Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera parashikojnë dhënien e trajtimit tarifor preferencial për importim të mallrave me origjinë shqiptare në këto vende, sipas kuptimit të këtyre marrëveshjeve, me kusht që, kur mallrat janë përftuar nën regjimin e përpunimit aktiv, mallrat joshqiptarë të trupëzuara brenda mallrave në fjalë, t'u nënshtrohen pagimit të detyrimeve të importit që duhen paguar, për rrjedhojë, vlefshmëria e dokumenteve të nevojshme për të mundësuar këtë trajtim tarifor preferencial në këto vende, çon në lindjen e një borxhi doganor importi.

2. Çasti kur lind ky borxh doganor quhet çasti kur autoritetet doganore pranojnë deklaratën e eksportit për mallrat në fjalë.

3. Debitor është deklaruesi. Në rastin e përfaqësimit të tërthortë, është gjithashtu debitor personi për llogari të të cilit bëhet deklarata.

4. Shuma e detyrimeve të importit që i përgjigjet këtij borxhi doganor, përcaktohet në të njëjtën mënyrë sikur të kishim të bënim me një borxh doganor që rrjedh nga pranimi në të njëjtën datë i deklaratës për vendosje në qarkullim të lirë të mallrave në fjalë, me qëllim që të mbyllet regjimi i përpunimit aktiv.

KREU 3
VJELJA E SHUMËS SË BORXHIT DOGANOR

## SEKSIONI 1
## KONTABILIZIMI DHE KOMUNIKIMI I SHUMËS SË DETYRIMEVE DEBITORIT

### Neni 232

1. Çdo shumë e detyrimeve të importit ose e detyrimeve të eksportit që buron nga një borxh doganor, që këtej e tutje e quajtur "shuma e detyrimeve", llogaritet nga autoritetet doganore sapo ato disponojnë elementet e nevojshme dhe regjistrohet nga këto autoritete në regjistrin kontabël ose me çdo mjet tjetër të barazvlefshëm (kontabilizim).

2. Paragrafi i parë nuk zbatohet:

a) kur futet një taksë antidumping ose një taksë kundërbalancuese me anë të një ligji tjetër të veçantë;

b) kur shuma e detyrimeve që duhen paguar është më e madhe se ajo e përcaktuar në bazë të informacionit tarifor të detyrueshëm;

c) kur aktet nënligjore në zbatim të Kodit nuk e kërkojnë kontabilizimin, nga autoritetet doganore, e shumave të detyrimeve më të ulëta se një nivel i caktuar.

3. Procedurat praktike të kontabilizimit të shumës së detyrimeve përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

### Neni 233

1. Kur një borxh doganor lind si pasojë e pranimit të deklaratës së vendosjes së mallrave nën një regjim doganor të caktuar, të ndryshëm nga lejimi i përkohshëm me përjashtim të pjesshëm nga detyrimet e importit, ose nga çdo akt tjetër që ka efekt të njëjtë juridik me këtë pranim, shuma që i korrespondon këtij borxhi doganor, kontabilizohet sapo të jetë llogaritur, të shumtën ditën e dytë që mallrat janë çliruar. Megjithatë, me kusht që pagesa të jetë siguruar, shuma e përgjithshme e detyrimeve që ka të bëjë me të gjitha mallrat e çliruara nga i njëjti person gjatë një periudhe, të caktuar nga autoritetet doganore, e cila nuk mund të jetë më shumë se 31 ditë, mund të mbulohet nga një kontabilizim i vetëm i cili kryhet brenda 5 ditësh nga përfundimi i periudhës në fjalë.

2. Kur parashikohet që çlirimi i mallrave mund të jepet duke pritur që të plotësojnë më parë disa kushte të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, nga të cilat varet përcaktimi i shumës së borxhit ose vjelja e tij, kontabilizimi duhet të bëhet jo më vonë se dy ditë pas datës që është përcaktuar ose fiksuar shuma e borxhit ose detyrimi për të paguar detyrimet që burojnë nga ai borxh. Megjithatë, kur borxhi doganor ka të bëjë me taksën e përkohshme antidumping ose taksën kundërbalancuese, ky detyrim kontabilizohet jo më vonë se dy muaj pas datës së nxjerrjes së taksës përfundimtare antidumping ose të taksës kundërbalancuese.

3. Kur lind një borxh doganor në kushte të ndryshme nga ato të përmendura në paragrafin 1, shuma përkatëse kontabilizohet brenda dy ditësh nga data kur autoritetet doganore janë në gjendje:

a) të llogarisin shumën e detyrimeve në fjalë, dhe

b) të përcaktojnë debitorin.

### Neni 234

1. Kur rrethana të veçanta i pengojnë autoritetet doganore kompetente të respektojnë kufirin kohor të mëparshëm, kufiri kohor për kontabilizimin e parashikuar në nenin 233 mund të zgjatet. Kjo zgjatje nuk mund të kalojë 14 ditë.

2. Kufiri kohor i parashikuar në paragrafin 1 nuk zbatohet në rast rrethanash të jashtëzakonshme ose fuqie madhore.

### Neni 235

1. Kur shuma e detyrimeve që rezultojnë nga një borxh doganor nuk është kontabilizuar në përputhje me nenet 233 e 234, ose është kontabilizuar me një shifër me të vogël sesa shuma e detyruar në bazë të ligjit, shuma për t'u vjelë kontabilizohet brenda dy ditësh nga data kur autoritetet doganore janë vënë në dijeni për situatën dhe janë në gjendje të llogarisin shumën që duhet paguar e të përcaktojnë debitorin (kontabilizim i mëvonshëm). Ky kufi kohor mund të zgjatet në përputhje me nenin 234.

2. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në nënparagrafin e dytë të nenit 232(2), kontabilizimi i mëvonshëm nuk kryhet në rastet kur:

a) vendimi fillestar për të mos kontabilizuar detyrimet ose për t'i kontabilizuar në një nivel më të ulët sesa shuma e detyrimeve merret në bazë dispozitash të karakterit të përgjithshëm, të shfuqizuara më vonë me vendim të gjykatës;

b) shuma e detyrimeve që duhet paguar nuk ishte kontabilizuar si pasojë e një gabimi nga ana e vetë autoriteteve doganore, gabim i cili nuk mund të ishte zbuluar nga personi që duhet të paguajë dhe ky i fundit ka vepruar në mirëbesim dhe ka respektuar të gjitha dispozitat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi përsa i

përket deklaratës doganore;

c) në bazë të dispozitave në fuqi autoritetet doganore kompetente përjashtohen nga kontabilizimi i mëvonshëm i shumës së detyrimeve nën një shifër të caktuar.

Neni 236

1. Sapo të kontabilizohet shuma e detyrimeve, i komunikohet debitorit sipas procedurave përkatëse, të përshkruara në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

2. Kur shuma e detyrimeve, që duhen paguar, tashmë është kontabilizuar, për ta treguar një gjë të tillë në deklaratën doganore, autoritetet doganore mund të shënojnë mbi deklaratë që nuk ka nevojë të bëhet njoftimi siç parashikohet në paragrafin 1, me kusht që shuma e përkatëse e detyrimeve të përputhet me shumën e përcaktuar nga autoritetet doganore.

3. Njoftimi i debitorit nuk mund të bëhet pas mbarimit të afatit trevjeçar nga data në të cilin borxhi doganor ka lindur. Megjithatë, kur autoritetet doganore për arsye të një procedimi penal nuk kanë mundur të përcaktojnë shumën e saktë të detyrimeve që realisht duhen paguar, njoftimi i debitorit bëhet edhe pas mbarimit të afatit trevjeçar.

SEKSIONI 2
KUFIRI KOHOR DHE PROCEDURAT E PAGIMIT TË SHUMËS SË DETYRIMEVE DOGANORE

Neni 237

1. Shumat e detyrimeve të njoftuara sipas nenit 236 paguhen nga debitorët brenda afateve të mëposhtme:

a) nëse personi nuk gëzon ndonjë prej lehtësive të pagesës të parashikuara nga aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, pagesa bëhet brenda afatit të parashikuar. Zgjatja jepet automatikisht kur vërtetohet se personi i interesuar e mori njoftimin tepër vonë dhe se kryerja e pagesës brenda afatit të parashikuar ishte e pamundur. Gjithashtu, autoritetet doganore mund të japin zgjatje të afatit, me kërkesë të debitorit, kur shuma e detyrimeve që duhet paguar është pasojë e një vjeljeje pas zhdoganimit. Kjo zgjatje e kufirit kohor nuk duhet të kalojë 10 ditë;

b) nëse personi gëzon ndonjërën nga lehtësitë e pagesës së parashikuar në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, pagesa bëhet jo më vonë se përfundimi i afatit ose i afateve të përcaktuara në lidhje me këto lehtësira.

2. Kur, një kërkesë për shuarjen e detyrimeve, bëhet sipas neneve 250, 251 ose 252 ose kur mallrat janë sekuestruar, me synim konfiskimin e mëvonshëm të tyre sipas nenit 246 (b), (c) (ii), ose (d), detyrimi i debitorit për pagimin e detyrimeve do të përmbushet më vonë, sipas kushteve të parashikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Neni 238

Pagesa bëhet me para në dorë ose me ndonjë mjet tjetër i cili, sipas dispozitave në fuqi ka të njëjtin efekt shlyerjeje.

Neni 239

Nëse shuma e detyrimeve që duhen paguar nga personi i interesuar ka të bëjë me mallra të deklaruara për një regjim doganor që nënkupton pagesën e këtyre detyrimeve, autoritetet doganore, me kërkesë të këtij personi, lejojnë shtyrjen e afatit të pagesës së shumës në fjalë sipas kushteve të përcaktuara në nenet 240, 241 dhe 242.

Neni 240

1. Lejimi i shtyrjes së afatit për pagesën kushtëzohet me dhënien e një garancie nga ana e kërkuesit.

2. Veç kësaj, lejimi i shtyrjes së afatit të pagesës mund të shkaktojë pagesë të shpenzimeve shtesë për hapjen e një dosjeje për shërbimet e kryera.

Neni 241

Kur lejojnë shtyrjen e afatit të pagesës, autoritetet doganore vendosin edhe se cila prej procedurave të mëposhtme duhet të përdoret:

a) veçmas për secilën prej shumave të detyrimeve, të kontabilizuara sipas kushteve të përcaktuara në nënparagrafin e parë të nenit 233(1) ose në nenin 235(1); ose

b) globalisht për tërësinë e të gjitha shumave të detyrimeve, të kontabilizuara sipas kushteve të përcaktuara në nënparagrafin e parë të nenit 233(1), brenda një afati të caktuar nga autoritetet doganore, që nuk i kalon 31 ditë; ose

c) globalisht për tërësinë e të gjitha shumave të detyrimeve, të kontabilizuara se bashku, duke formuar një hyrje të vetme, sipas nënparagrafit të dytë të nenit 233(1).

Neni 242

1. Afati i shtyrjes së pagesës është 30 ditë. Ai llogaritet si vijon:

a) kur pagesa shtyhet sipas nenit 241(a), afati llogaritet nga e nesërmja e ditës që shuma e detyrimeve kontabilizohet nga autoritetet doganore. Kur zbatohet neni 234, afatit 30-ditor, të llogaritur sipas nënparagrafit të parë, i zbritet numri i ditëve që i korrespondojnë afatit prej më shumë se dy ditësh të përdorur për kontabilizimin e shumës;

b) kur pagesa shtyhet sipas nenit 241(b), afati llogaritet nga e nesërmja e ditës që përfundon afati i kontabilizimit global. Atij i zbritet numri i ditëve që i korrespondon gjysmës së ditëve të afatit të kontabilizimit global;

c) kur pagesa shtyhet sipas nenit 241(c), afati llogaritet nga e nesërmja e ditës së përfundimit të afatit për të cilin mallrat në fjalë ishin çliruar. Atij i zbritet numri i ditëve që i korrespondon gjysmës së numrit të ditëve të afatit në fjalë.

2. Kur afatet e parashikuara në paragrafin 1(b) dhe (c) përmbajnë një numër ditësh tek, numri i ditëve që i zbritet afatit 30-ditor, në zbatim të paragrafit 1(b) dhe (c), është i barabartë me gjysmën e numrit çift paraardhës.

3. Për të thjeshtuar punën, kur periudhat e përmendura në paragrafin 1(b) dhe (c), janë javë ose muaj kalendarike, autoritetet doganore mund të parashikojnë që pagesa e detyrimeve që kanë qënë objekt i shtyrjes së afatit të pagesës të bëhet:

a) nëse periudha është javë kalendarike, të premten e javës së katërt që vjen pas asaj jave kalendarike;

b) nëse periudha është muaj kalendarik, të shumtën ditën e 16 të muajit që vjen pas atij muaji kalendarik.

Neni 243

1. Autoritetet doganore mund t'i japin debitorit edhe lehtësi të tjera pagese, përveç shtyrjes së afatit të pagesës. Dhënia e këtyre lehtësive:

a) kushtëzohet me sigurimin e një garancie. Megjithatë, garancia nuk kërkohet në qoftë se, për shkak të gjendjes së debitorit, kërkimi i saj krijon vështirësi serioze ekonomike ose sociale për debitorin;

b) sjell ngarkimin e një interesi mbi shumën e detyrimit. Shuma e këtij interesi përllogaritet në mënyrë të tillë që të jetë e barazvlefshme me shumën që do të ngarkohej për këtë qëllim në Lekë.

2. Cilido qoftë lehtësimi i pagesës dhënë debitorit në bazë të akteve nënligjore në zbatim të këtij Kodi, ky i fundit mund të paguajë të gjithë ose një pjesë të shumës së detyrimeve, pa pritur përfundimin e afatit që i është dhënë për pagesën.

Neni 244

Detyrimi mund të paguhet edhe nga ndonjë palë e tretë në vend të debitorit.

Neni 245

1. Kur shuma e detyrimeve që duhen paguar nuk është shlyer brenda afatit të caktuar:

a) autoritetet doganore përdorin të gjitha mjetet ligjore për të siguruar pagesën e shumës së borxhit doganor. Dispozita të posaçme për dorëzaninë brenda kuadrit të regjimit të tranzitit do të parashikohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi;

b) përveç shumës së detyrimeve ngarkohen edhe kamatë vonesat. Norma e kamatë vonesave mund të jetë më e lartë sesa norma e interesit të kredisë, por jo më e ulët sesa kjo e fundit.

2. Autoritetet doganore, kur lind një borxh doganor, me qëllim që të sigurojnë pagimin e borxhit doganor, mund të marrin masat e meposhtme:

a) sekuestrimin e vlerave monetare, të kredive, sendeve me vlerë të çmuar, dokumenteve me anë të të cilave bëhen pagesa, valutave të huaja të depozituara në një bankë, që i përkasin debitorit, personave të tretë ose garantuesve që kanë detyrime kundrejt debitorit;

b) sekuestrimin e mallrave, të pasurive të tundshme ose të patundshme që i përkasin debitorit ose një pale të tretë ose garantuesit që ka detyrime kundrejt debitorit.

3. Autoritetet doganore mund t'u kërkojnë autoriteteve kompetente edhe pezullimin e veprimtarive

ekonomike të debitorit në lidhje me importimin, eksportimin dhe tranzitimin e mallrave ose të veprimtarive të tjera prodhuese për ushtrimin e të cilave debitori është regjistruar pranë autoriteteve të taksave.

4. Vendimet e marra nga administrata doganore për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, bëhen tituj ekzekutivë menjëherë sapo ato i njoftohen debitorit. Ekzekutimi i vendimeve të sipërpërmendura bëhet në bazë të dispozitave të parashikuara nga nenet 511 dhe në vazhdim të Kodit të Procedurës Civile. Titujt ekzekutivë të nxjerrë nga administrata doganore, menjëherë sapo mbështeten me urdhrin e ekzekutimit të nxjerrë nga autoritetet gjyqësore kompetente, mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga organet e administratës doganore.

## KREU 4
## SHUARJA E BORXHIT DOGANOR

### Neni 246
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Pa rene ndesh me dispozitat ne fuqi persa i perket parashkrimit te nje borxhi doganor dhe mosvjeljes se nje borxhi te tille në rastin e paaftësisë së debitorit për të paguar, të provuar me vendim gjykate, borxhi doganor shuhet:

a) kur paguhet shuma e detyrimeve;

b) kur shuhet shuma e detyrimeve;

c) lidhur me mallrat e deklaruara për një regjim doganor që sjell detyrimin për të paguar detyrimet:

i) kur cilësohet e pavlefshme deklarata doganore në përputhje me nenin 91;

ii) kur mallrat para çlirimit të tyre sekuestrohen dhe njëkohësisht ose më vonë konfiskohen, shkatërrohen sipas udhëzimeve të autoriteteve doganore, shkatërrohen ose braktisen sipas nenit 197, shkatërrohen ose humbasin në mënyrë të pakthyeshme për shkaqe që lidhen me vetë natyrën e tyre ose me rrethana të paparashikueshme ose për shkak fuqie madhore;

d) kur mallrat në lidhje me të cilat lind një borxh doganor, sipas nenit 217, sekuestrohen pas hyrjes së paligjshme dhe njëkohësisht ose më pas konfiskohen.

2. Në rast sekuestrimi e konfiskimi, borxhi doganor, për nevoja të legjislacionit penal që zbatohet për vepra penale në fushën e doganave, quhet se nuk është shuar kur, sipas pjesës VIII të këtij Kodi, detyrimet doganore përbëjnë bazën e përcaktimit të sanksioneve ose ekzistenca e një borxhi doganor është baza për fillimin e ndjekjes penale.

### Neni 247

Borxhi doganor, siç përmendet ne nenin 231, shuhet gjithashtu kur anulohen formalitetet e kryera për të mundësuar trajtimin tarifor preferencial që jepet sipas nenit 231.

## KREU 5
## RIMBURSIMI DHE SHUARJA E DETYRIMEVE

### Neni 248

Përkufizimet që vijojnë kanë këtë domethënie:

a) “rimbursim” do të thotë rikthimi i plotë ose i pjesshëm i detyrimeve të importit ose i detyrimeve të eksportit që janë paguar;

b) “shuarje” do të thotë vendimi për të mos paguar të gjithë ose një pjesë të shumës së një borxhi doganor ose vendimi për të anuluar kontabilizimin e gjithë ose të një pjesë të shumës së detyrimeve të importit ose të detyrimeve të eksportit që nuk janë vjelë.

### Neni 249

1. Detyrimet e importit ose detyrimet e eksportit rimbursohen kur konstatohet se në çastin e pagimit kjo shumë ligjërisht nuk përbënte detyrim ose se shuma ishte kontabilizuar në kundërshtim me nenin 235(2). Detyrimet e importit ose detyrimet e eksportit shuhen kur konstatohet se në çastin e kontabilizimit të këtyre detyrimeve, ato sipas ligjit nuk përbënin detyrim, ose se kontabilizimi është bërë në kundërshtim me nenin 235(2). Nuk jepet rimbursim ose shuarje detyrimesh në rast se faktet, që çojnë në përfundimin se detyrimet nuk përbënin ligjërisht detyrim, ose se kontabilizimi është gabuar, janë pasojë e një veprimi të qëllimshëm nga personi i interesuar.

2. Detyrimet e importit ose detyrimet e eksportit rimbursohen ose shuhen me paraqitjen e një kërkese në zyrën doganore kompetente, brenda një periudhe trevjeçare, që fillon nga data kur shuma e këtyre detyrimeve i është njoftuar debitorit. Kjo periudhë zgjatet, nëse ky person i interesuar jep prova se

mosparaqitja e kërkesës brenda afatit të caktuar është pasojë e rrethanave të jashtëzakonshme ose fuqie madhore. Kur autoritetet doganore nga ana e tyre, zbulojnë se brenda këtij afati janë krijuar një ose më shumë situata, të cilave i referohet nënparagrafi i parë dhe i dytë i paragrafit të parë, ato rimbursojnë ose shuajnë detyrimet e importit me nismën e tyre.

Neni 250

Detyrimet e importit ose detyrimet e eksportit rimbursohen kur një deklaratë doganore anulohet dhe detyrimet janë paguar. Rimbursimi jepet vetëm pasi të paraqitet një kërkesë nga personi i interesuar brenda afateve të përcaktuara për dorëzimin e kërkesave për anulim deklaratash doganore.

Neni 251

1. Detyrimet e importit rimbursohen ose shuhen kur përcaktohet se shuma e kontabilizuar e këtyre detyrimeve lidhet me mallra të vendosura nën një regjim doganor të caktuar dhe refuzohet nga importuesi, sepse në çastin kohor të përmendur në nenin 92 ato janë me defekt ose nuk përputhen me kushtet e kontratës, në bazë të së cilës janë importuar. Në mallrat me defekt, quhet se përfshihen edhe mallrat e dëmtuara para çlirimit të tyre.

2. Rimbursimi ose shuarja e detyrimeve të importit duhet të jepet me kusht që:

a) mallrat të mos jenë përdorur, përveç përdorimit fillestar që ka qënë i nevojshëm për të konstatuar defektin ose nuk përputhen me kushtet e kontratës;

b) mallrat të eksportohen jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Me kërkesë të personit të interesuar, autoritetet doganore lejojnë shkatërrimin e mallrave ose vendosjen e tyre, me qëllim rieksportimi, nën regjimin e tranzitit ose nën regjimin e magazinimit doganor ose në një zonë të lirë apo magazinë të lirë, në vend që të eksportohen. Për qëllim të caktimit të tyre nën një prej regjimeve doganore të përmendura më lart, mallrat konsiderohen joshqiptare.

3. Detyrimet e importit nuk rimbursohen ose nuk shuhen për mallra, të cilat para se të depozitohej deklarata doganore janë lejuar përkohësisht për t'u testuar, me përjashtim të rasteve kur konstatohet se fakti, që mallrat janë me defekt ose nuk përputhen me kushtet e kontratës, nuk mund të zbulohej normalisht gjatë këtyre testimeve.

4. Detyrimet e importit rimbursohen ose shuhen për arsyet e parashtruara në paragrafin 1 me depozitimin e kërkesës pranë zyrës doganore përkatëse brenda 12 muajsh nga data kur shuma e këtyre detyrimeve i është komunikuar debitorit. Megjithatë, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave mund të lejojë zgjatjen e këtij afati për shkaqe të jashtëzakonshme, të justifikuara si duhet.

Neni 252

1. Detyrimet e importit ose detyrimet e eksportit mund të rimbursohen ose shuhen në situata të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenet 249, 250, 251 kur:

a) aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi e parashikojnë një gjë të tillë;

b) burojnë nga rrethana kur personit të interesuar nuk mund t'i vishet mashtrimi ose një neglizhencë e dukshme. Rrethanat në të cilat mund të zbatohet kjo dispozitë dhe procedurat përkatëse që duhen ndjekur përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi. Rimbursimi ose shuarja mund t'u nënshtrohen kushteve të posaçme.

2. Detyrimet rimbursohen ose shuhen për arsyet e parashikuara në paragrafin 1, me dorëzimin e kërkesës në zyrën doganore përkatëse brenda 12 muajsh nga data kur këto detyrime i janë njoftuar debitorit. Megjithatë, Drejtori i Përgjithshëm mund të lejojë zgjatjen e këtij afati për shkaqe të jashtëzakonshme, të jusifikuara si duhet.

Neni 253

Detyrimet e importit ose detyrimet e eksportit rimbursohen ose shuhen në kushtet e parashikuara në këtë kre vetëm në qoftë se shuma për t'u rimbursuar ose shuar është më e madhe sesa shuma e përcaktuar në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.

Neni 254

Rimbursimi nga autoritetet doganore i shumës së detyrimeve të importit ose detyrimeve të eksportit, si dhe i interesave të kredisë ose të kamatë-vonesave të mbledhura kur janë paguar këto detyrime, nuk sjell si pasojë pagesë të interesit nga këto autoritete. Megjithatë, interesi paguhet:

a) kur vendimi për të pranuar një kërkesë për rimbursim nuk është zbatuar për tre muaj nga data e marrjes së vendimit;

b) kur e kërkojnë akte të caktuara me karakter të përgjithshëm kombëtar.

Shuma e këtij interesi llogaritet në mënyrë të njëjtë me shumën që do të paguhej për këtë qëllim në para shqiptare ose në tregun financiar.

### Neni 255

Kur një borxh doganor është hequr gabimisht, ose shuma që i korrespondon detyrimeve përkatëse është rimbursuar gabimisht, borxhi fillestar mbetet përsëri për t'u paguar. Interesat e paguara sipas nenit 254 duhet të rimbursohen.

# PJESA VIII
# SHKELJET NË FUSHËN DOGANORE DHE SANKSIONET

## KREU 1
## DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRKUFIZIME

### Neni 256
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Shkelje doganore janë:

a) kundërvajtjet administrative doganore;

b) kontrabanda.

2. Cdo veprim ose mosveprim, qe bie ndesh me dispozitat e parashikuara ne kete Kod, me aktet nenligjore te tij dhe me dispozita te tjera ne fuqi, me perjashtim te rasteve te fuqise madhore, quhet kundervajtje administrative doganore dhe denohet si e tille."

3. Shmangia ose tentativa për të shmangur, me çfarëdo mënyre, kontrollin dhe/ose mbikëqyrjen doganore mbi mallrat me qëllim shmangien e pagesës së detyrimeve të importit dhe eksportit, siç është përshkruar në nenet 276 deri në 280, si dhe secili prej veprimeve të përshkruara në këto nene, përbën kontrabandë dhe dënohet si e tillë.

4. Pagesa e gjobës, që zbatohet për shkeljen doganore, në asnjë rast nuk do të jetë shkak për të përjashtuar shkelësin nga pagimi i detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat objekt i shkeljes.

## KREU 2
## KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE DOGANORE

### Neni 257

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore deklarimi në manifestin e ngarkesës të një mjeti ajror ose anijeje i një sasie mallrash, të ndryshme nga ajo që konstatojnë autoritetet doganore.

2. Kapiteni i anijes ose i mjetit ajror për kryerjen e kësaj shkeljeje ndëshkohet me gjobë prej 10 000 lekë për çdo koli ose me një gjobë prej 30 000 lekë për çdo ton, në rast se ngarkesa përmban mall rifuzo.

3. Për qëllim të këtij neni, nëse kolitë e tepërta kanë të njëjtat marka dhe shenja sigurie me kolitë e tjera të deklaruara në manifest, konsiderohen të padeklaruara kolitë e gjetura më tepër, të cilave u korrespondon klasifikimi tarifor që sjell pagesën e detyrimeve doganore më të larta.

4. Kur ndryshimet e konstatuara përbëjnë më pak se 5 për qind të sasisë së treguar në manifest, nuk zbatohet gjobë.

### Neni 258

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, kryen kundërvajtje administrative doganore kapiteni i mjetit lundrues që:

a) vonon paraqitjen e manifestit. Ky veprim ndëshkohet me një gjobë prej 40 000 lekë për çdo 5 orë vonesë. Në këtë rast nuk llogariten për këtë qëllim orët gjatë të cilave zyra doganore kompetente është e mbyllur;

b) refuzon të pranojë në bord autoritetet doganore. Ky veprim ndëshkohet me një gjobë nga 300 000 lekë deri 500 000 lekë;

c) niset pa lejen e organeve doganore. Ky veprim ndëshkohet me një gjobë nga 300 000 lekë deri 500 000 lekë.

2. Gjobat e parashikuara në këtë nen, zbatohen pavarësisht nëse për të njëjtin veprim ose mosveprim legjislacioni për lundrimin ujor parashikon përkatësisht edhe sanksione të tjera.

Neni 259

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, kryen kundërvajtje administrative doganore, kapiteni i mjetit ajror që:

a) vonon paraqitjen e manifestit. Ky veprim ndëshkohet me një gjobë prej 40 000 lekë për çdo 5 orë vonesë. Nuk llogariten për këtë qëllim orët gjatë të cilave zyra doganore kompetente është e mbyllur;

b) refuzon të pranojë në bord autoritetet doganore. Ky veprim ndëshkohet me një gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë;

c) niset pa lejen e autoriteteve doganore. Ky veprim ndëshkohet me një gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë.

2. Gjobat e parashikuara në këtë nen, zbatohen pavarësisht nëse për të njëjtin veprim ose mosveprim legjislacioni për navigacionin ajror parashikon përkatësisht edhe sanksione të tjera.

Neni 260

Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, kryen kundërvajtje administrative doganore transportuesi i mallrave në rrugë tokësore që:

a) devijon nga itinerari i përcaktuar prej autoriteteve doganore. Ky veprim ndëshkohet me një gjobë nga 50 000 lekë deri 150 000 lekë;

b) vonon paraqitjen e mallrave pranë autoriteteve kompetente doganore. Ky veprim ndëshkohet me një gjobë prej 30 000 lekë për çdo 5 orë vonesë. Në këtë rast nuk llogariten për këtë qëllim orët gjatë të cilave zyra doganore kompetente është e mbyllur;

c) niset pa lejen e autoriteteve doganore. Ky veprim ndëshkohet me një gjobë nga 100 000 lekë deri 300 000 lekë;

d) transporton një sasi më të vogël ose më të madhe kolish, pakosh apo të tjera forma të ngjashme ambalazhimi mallrash në përgjithësi, sesa ajo e treguar në dokumentin shoqërues të mallit. Ky veprim ndëshkohet me një gjobë nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë;

e) shkel normat e Konventës TIR dhe anekseve të saj në fuqi, ku parashikohen përgjegjësitë e transportuesit të mallrave, brenda ose gjatë kalimit përmes territorit doganor. Ky veprim ndëshkohet me një gjobë nga 50 000 lekë deri në 100 000 lekë.

Neni 261
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore deklarimi i një cilësie, sasie, vlere ose origjine të ndryshme nga ajo që konstatojnë autoritetet doganore, në çastin kur deklaruesi paraqet deklaratën për vendosjen e mallrave në qarkullim të lirë. Ky veprim ndeshkohet me nje gjobe nga 30 000 leke deri ne 100 000 leke. Ne rastet e diferencave ne sasi, perveç gjobes behet edhe konfiskimi i mallrave te padeklaruara dhe te gjetura ne teprice.

2. Në rastet kur pas rishikimit të deklaratës rezulton që detyrimet doganore që duhen paguar janë më të larta se ato të llogaritura në bazë të deklaratës dhe diferenca e këtyre është më e madhe sesa 5 për qind, në vend të gjobës së mësipërme, zbatohet një gjobë e barabartë me trefishin e diferencës së detyrimeve doganore të papaguara.

3. Megjithatë, në rast se kjo diferencë është pasojë e një gabimi të kryer në mirëbesim gjatë hartimit të deklaratës doganore dhe deklaruesi i ka paraqitur të gjithë dokumentet dhe informacionin e nevojshëm për verifikim doganor, zbatohet një gjobë që shkon nga një e dhjeta deri në tërë shumën e diferencës së detyrimeve doganore të papaguara.

4. Gjobat e sipërpërmendura zbatohen mutatis mutandis sa herë që nga autoritetet doganore konstatohet një vlerë ose origjinë e ndryshme nga ajo e deklaruar për mallrat për t'u vendosur në cilindo prej regjimeve doganore, përveç regjimit të tranzitit.

Neni 262

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore paraqitja e mallrave të vendosura në regjimin e tranzitit, në një zyrë doganore të ndryshme nga ajo e destinacionit.

2. Deklaruesi ose garantuesi ndëshkohet me një gjobë nga 100 000 lekë deri në 200 000 lekë.

Neni 263

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore,

deklarimi në dokumentet e tranzitit në zyrën doganore të nisjes i një sasie mallrash, të ndryshme nga ajo që konstatohet në çastin e mbërritjes së tyre në doganën e destinacionit.

2. Deklaruesi ose garantuesi ndëshkohet me gjobë që shkon nga një deri në trefishin e shumës së diferencës së konstatuar të detyrimeve doganore të papaguara.

Neni 264

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore deklarimi në dokumentet e tranzitit të paraqitura në zyrën doganore të nisjes i një cilësie mallrash, të ndryshme nga ajo që konstatohet në çastin e mbërritjes së mallrave në doganën e destinacionit.

2. Deklaruesi ose garantuesi ndëshkohen me një gjobë që shkon nga një deri në trefishin e shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat e shënuara në dokumentin e tranzitit dhe që nuk korrespondojnë me cilësinë e konstatuar nga zyra doganore e destinacionit.

Neni 265

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore, deklarimi dhe/ose regjistrimi i një cilësie ose sasie mallrash të magazinuara në një magazinë doganore, të ndryshme nga ajo që konstatojnë autoritetet doganore.

2. Administruesi i magazinës ose depozituesi, kur magazinimi është nën përgjegjesinë e këtij të fundit, ndëshkohen me një gjobë nga një deri në trefishin e shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat me cilësi ose sasi të ndryshme.

3. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, nëse diferenca në sasi është më e madhe se 20 për qind, qoftë kjo për më shumë ose më pak, përgjegjësi i magazinës duhet të paraqesë menjëherë deklaratën për vendosjen në qarkullim të lirë të mallrave të regjistruara në emrin e tij. Në rast se edhe më parë në mallrat e ruajtura në magazina të administruara nga i njëjti person janë konstatuar diferenca sasiore, më të mëdha se 20 për qind, edhe nëse ka patur të bëjë me mallra të një cilësie tjetër, autoritetet doganore i revokojnë administratorit të magazinës autorizimin për administrimin e magazinës për një periudhë të paktën një vjeçare.

Neni 266

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore deklarimi në deklaratën përmbledhëse, e përdorur për futjen e mallrave në magazinim të përkohshëm për qëllim të neneve nga 75 deri 78 të këtij Kodi, si dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, i një sasie ose cilësie mallrash në magazinim të përkohshëm, të ndryshme nga ajo që konstatohet nga autoritetet doganore.

2. Personi i autorizuar, ose personat të cilëve u referohet neni 69, paragrafi 2, që paraqesin deklaratën përmbledhëse dhe kanë kryer këtë shkelje, ndëshkohen me sanksionet që vijojnë:

a) pagesën e detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat që dalin me diferencë. Detyrimet përllogariten, kur është e mundur, në bazë të elementeve të deklaratës përmbledhëse ose përllogariten në bazë të detyrimeve më të larta që zbatoheshin në ditën e hyrjes në magazinim të përkohshëm; dhe

b) pagesën e një gjobe që shkon nga një deri në trefishin e detyrimeve doganore që duhen paguar sipas nënparagrafit (a).

Neni 267

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore plotësimi i deklaratës për lejim të përkohshëm të mallrave ose për regjimin e përpunimit aktiv, duke deklaruar një cilësi ose sasi të ndryshme nga ajo e konstatuar nga autoritetet doganore.

2. Deklaruesi që kryen këtë shkelje ndëshkohet me sanksionet që vijojnë:

a) në rastin e diferencës në cilësi, pagesa e një gjobe që shkon nga një deri në trefishin e shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat e konstatuara;

b) në rastin e diferencës në sasi, pagesën e një gjobe që shkon:

i) nga dy deri në pesëfishin e shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat që mungojne ose janë tepër,

ii) nga gjysma deri në gjithë shumën e detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat në mungesë ose në tepricë, kur diferenca e konstatuar shkaktohet nga një gabim përllogaritjeje ose shkrimi në mirëbesim nga deklaruesi.

Neni 268
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore plotësimi i deklaratës për rieksport të mallrave të vendosura në lejim të përkohshëm ose nën regjimin e përpunimit aktiv, duke deklaruar një cilësi ose sasi të ndryshme nga ajo që konstatojnë autoritetet doganore.

2. Deklaruesi që kryen këtë shkelje ndëshkohet me sanksionet që vijojnë:

a) në rastin e konstatimit të diferencës në cilësi, pagesa e një gjobe që shkon nga një deri në trefishin e shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat e importuara përkohësisht, kundrejt atyre të paraqitura për rieksportim;

b) në rast diference në sasi, pagesën e një gjobe që shkon:

i) nga dy deri në pesëfishin e shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat në mungesë,

ii) nga dy deri në pesëfishin e shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat në tepricë.

(fjalia e fundit e shfuqizuar).

Neni 269

(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore plotësimi i një deklarate për eksportim të përkohshëm të mallrave të vendosura nën regjimin e përpunimit pasiv, duke deklaruar një cilësi ose sasi të ndryshme nga ajo që konstatojnë autoritetet doganore.

2. Deklaruesi për kryerjen e këtyre shkeljeve ndëshkohet me sanksionet që vijojnë:

a) në rastin e konstatimit të diferencës në cilësi, pagesa e një gjobe që shkon nga një deri në trefishin e diferencës së shumës së detyrimeve doganore duhen paguar për mallrat e deklaruara dhe atyre të konstatuara;

b) në rastin e konstatimit të diferencës në sasi, pagesën e një gjobe që shkon nga dy deri në pesëfishin e shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për diferencën e konstatuar.

Nuk zbatohet asnje sanksion kur diferenca ne sasi nuk kalon 5 %.

Neni 270

(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore plotësimi i një deklarate për riimportim të mallrave të vendosura nën regjimin e përpunimit pasiv, duke deklaruar një cilësi ose sasi të ndryshme nga ajo që konstatojnë autoritetet doganore.

2. Deklaruesi që kryen këtë shkelje ndëshkohet me sanksionet që vijojnë dhe mund t'i revokohet edhe autorizimi:

a) në rastin e konstatimit të diferencës në cilësi, pagesa e një gjobe që shkon nga një deri në dhjetëfishin e shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat e konstatuara të ndryshme;

b) në rast se konstatohet diferencë në sasi, pagesa e një gjobe që shkon nga:

i) dy deri në pesëfishin e detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat që janë tepër,

ii) dy deri në pesëfishin e detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat që mungojnë.

(fjalia e fundit e shfuqizuar).

Neni 271

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore rieksportimi i një sasie mallrash të vendosura nën lejim të përkohshëm ose nën regjimin e përpunimit aktiv, më të vogël se sasia e parashikuar në autorizim, pasi dokumenti/dokumentet e heqjes së regjimit është/janë paraqitur.

2. Mbajtësi i autorizimit ndëshkohet me sanksionet e mëposhtme dhe mund t'i revokohet edhe autorizimi:

a) në rast se mallrat që mungonin gjenden në mjediset e mbajtësit të autorizimit, pagesën e një gjobe që shkon nga një deri në trefishin e shumës së detyrimeve doganore që duhen paguar për këto mallra (produkte kompensuese dhe mallra të importuara përkohësisht, në gjendjen e tyre të pandryshuar);

b) në rast se mallrat nuk gjenden në mjediset e mbajtësit të autorizimit, pagesën e një gjobe shtesë të asaj që parashikohet në nënparagrafin (a), e barabartë me gjithë shumën e detyrimeve doganore që duhen paguar për këto mallra (produkte kompensuese dhe mallra të importuara përkohësisht në gjendjen e tyre të pandryshuar), duke i konsideruar sikur ato të ishin vendosur në qarkullim të lirë pa marrë autorizimin përkates nga dogana.

Në të dy rastet, mbajtësi i autorizimit është i detyruar të paraqesë një deklaratë për vendosjen në qarkullim të lirë të mallrave që mungojnë.

Neni 272

1. Pa rënë ndesh me dispozitat për kontrabandën, quhet se përbën kundërvajtje administrative doganore mosparaqitja në kohën e përcaktuar e dokumentit të mbylljes së regjimit për mallrat e vendosura në lejim të përkohshëm, nën regjimin e përpunimit aktiv ose nën regjimin e përpunimit pasiv.

2. Për kryerjen e kësaj kundërvajtjeje, mbajtësi i autorizimit ndëshkohet me një gjobë që shkon nga 50 000 lekë deri në 200 000 lekë.

Neni 273

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore mosrespektimi i afateve kohore, brenda të cilëve mallrat e vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm, sipas neneve 157 deri në 164, duhet të ishin rieksportuar ose të cilave duhet t'u ishte caktuar një regjim tjetër doganor.

2. Personi, i autorizuar të përdorë mallrat e vendosura nën regjimin e lejimit të përkohshëm, i nënshtrohet një gjobe që shkon nga gjysma deri në gjithë shumën e detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat në fjalë.

Neni 274

1. Pa rënë ndesh me dispozitat mbi kontrabandën, përbën kundërvajtje administrative doganore mosparaqitja e deklaratës doganore brenda afateve të parashikuara nga ky Kod.

2. Deklaruesi për kryerjen e kësaj kundërvajtjeje ndëshkohet me një gjobë prej 20 000 lekë për çdo ditë vonesë.

Neni 275

1. Për shkeljet, të cilave u referohet neni 256 paragrafi 2 dhe të paparashikuara shprehimisht në këtë kre, zbatohet një gjobë që shkon nga 50 000 lekë deri në 200 000 lekë.

2. Kur i njëjti shkelës ka kryer disa kundërvajtje administrative në të njëjtën kohë, të përshkruara në këtë Kod, çdo shkelje ndëshkohet në veçanti.

KREU 3
KONTRABANDA

Neni 276

1. Kryen kontrabandë në lëvizjen e mallrave nëpërmjet kufijve tokësore dhe në brendësi të zonave doganore, kushdo që:

a) sjell mallra nëpërmjet kufijve tokësore, në kundërshtim me këtë Kod dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

b) shkarkon ose ruan mallra në hapësirën e ndërmjetme mes kufirit dhe zyrës doganore më të afërt;

c) gjendet me mallra të fshehura në trup, në bagazh, në pako ose në artikuj të tjerë të mbartur, ose në çfarëdo mjet transporti për t'iu shmangur kontrollit dhe/ose mbikëqyrjes doganore;

d) largon mallrat nga zonat doganore pa paguar detyrimet që duhen paguar ose pa garantuar pagesën, me përjashtim të rasteve të përjashtimit nga detyrimi për dhënien e garancive, siç parashikohet në këtë Kod;

e) nxjerr mallrat, të cilat u nënshtrohen detyrimeve të eksportit jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në një nga mënyrat e përshkruara më sipër;

f) mban në afërsi të vijës doganore mallra për të cilat nuk mund të dëshmojë prejardhjen e rregullt;

g) refuzon të paraqesë manifestin dhe dokumentet përkatëse;

h) ngarkon, shkarkon ose transbordon mallrat, udhëtarët dhe bagazhet e tyre, pa lejen e autoriteteve doganore.

Neni 277

Kryen kontrabandë në lëvizjen e mallrave nëpërmjet liqeneve kufitare kapiteni i mjetit lundrues, që sjell mallra nëpërmjet liqeneve të Ohrit, Shkodrës dhe Prespës, pa i paraqitur ato në njërën prej zyrave doganore më të afërta.

Neni 278

Kryen kontrabandë në lëvizjen e mallrave në rrugë detare kapiteni i mjetit lundrues që:

a) sjell mallra nëpërmjet kufirit detar, në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi dhe aktet e tij nënligjore;

b) ndërsa transporton mallra në mjetin lundrues i afrohet portit, hedh spirancën ose ndalon në afërsi të portit pa lejen e autoriteteve doganore;

c) ndërsa transporton mallra qëndron në vende ku nuk ka zyrë doganore ose shkarkon ose transbordon këto mallra në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi dhe aktet nënligjore të tij;

d) transporton mallrat pa manifestin përkatës;

e) në çastin e nisjes nuk ka në bord mallrat që në bazë të manifestit dhe dokumenteve të tjera doganore duhet të gjendeshin aty;

f) transporton mallra nga një doganë në një tjetër pa dokumentet përkatëse të tranzitit.

Neni 279

Kryen kontrabandë në lëvizjen e mallrave në rrugë ajrore kapiteni i mjetit ajror që:

a) sjell mallra në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në rrugë ajrore në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi dhe aktet e tij nënligjore;

b) transporton mallra pa manifestin përkatës;

c) në çastin e nisjes nuk ka në bord mallrat që në bazë të manifestit dhe dokumenteve të tjera doganore duhet të gjendeshin aty;

d) largon mallrat ose lejon që ato të largohen nga vendi i uljes së mjetit ajror, pa autorizimin e autoriteteve doganore;

e) ulet jashtë një aeroporti të autorizuar dhe nuk lajmëron menjëherë për këtë ulje autoritetet doganore më të afërta ose autoritete të tjera të policisë. Në këto raste quhet i hyrë në kontrabandë, përveç ngarkesës, edhe mjeti ajror;

f) ngarkon, shkarkon ose transbordon mallra, persona ose bagazhin e tyre pa lejen e autoriteteve doganore.

Neni 280

Quhet gjithashtu kontrabandë:

a) hedhja në konsum e mallrave të vendosura në qarkullim të lirë pasi janë importuar me pezullim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet doganore për shkak të destinacionit përfundimtar ose të përdorimit të tyre të veçantë kur autoritetet doganore vërtetojnë se destinacioni i tyre përfundimtar ose përdorimi i tyre i veçantë është i ndryshëm nga ai që është përcaktuar për të përfituar përjashtimin nga detyrimet doganore;

b) eksportimi ose importimi i mallrave të ndaluara ose që u nënshtrohen kufizimeve, me perjashtim të rasteve kur për këto mallra është lëshuar një autorizim me shkrim nga autoritetet kompetente;

c) nëdorësia e mallrave në kundërshtim me kufizimet ose ndalimet e parashikura në nenin 83(2) të këtij Kodi;

d) heqja ose falsifikimi në çfarëdo mënyre i numrit të identifikimit të mjetit të transportit. Konsiderohen bashkëpunëtorë në këtë shkelje dhe dënohen si të tillë, pronari i mjetit, si dhe të gjithë personat që marrin pjesë në kryerjen e këtij akti, duke përfshirë edhe teknikët dhe çdo person që nxjerr përfitime nga falsifikimi ose heqja në fjalë;

e) blerja, shitja, ruajtja dhe nëdorësia e mallrave nga individë, të cilët kanë dijeni ose objektivisht duhej të ishin në dijeni se këto mallra janë futur kontrabandë;

f) hedhja e mallrave, që nuk u janë nënshturar detyrimeve doganore, nga mjeti i transportit gjatë udhëtimit në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

g) importimi, eksportimi ose shitja e sendeve me vlera kulturore kombëtare, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi në këtë fushë;

h) thyerja e vulës doganore, zëvendësimi ose ndërrimi i shenjave të tjera të sigurisë, të vendosura mbi mjetin e transportit ose mbi mallrat.

KREU 4
"Sanksionet qe zbatohen per kontrabanden"
(ndryshuar titulli me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

Neni 281
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. "Kundervajtja e parashikuar ne nenin 256, paragrafi 3 dhe e percaktuar ne nenet 276 deri 280 denohet me:

a) sekuestrim te mallit objekt i kontrabandes, qofshin edhe mallra qe nuk tatohen;

b) gjobe nga dy deri ne pesefishin e shumes se detyrimeve doganore qe duhen paguar per mallrat qe jane objekt kontrabande, pavaresisht nga denimi i parashikuar ne Kodin Penal."

2. Çdo shkelës përgjigjet personalisht dhe solidarisht për pagesën e sanksionit të mësipërm, në varësi të shkallës së pjesëmarrjes.

3. Fakti që ata përgjigjen personalisht dhe solidarisht do të thotë që secili prej tyre është i detyruar të përmbushë tërësisht detyrimet dhe, autoritetet doganore mund të kërkojnë pagesën ose të padisin njërën ose dhe gjitha palët për këtë detyrim, ashtu siç shihet e nevojshme. Nëse njëra palë paguan shumën e përgjithshme, të tjerat çlirohen nga detyrimi ndaj autoriteteve doganore.

4. Kur i njëjti shkelës kryen njëherazi më shumë se një shkelje, të parashikuar në këtë Kre, çdo shkelje dënohet në veçanti.

"Neni 281/1
(shtuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Ne rastet e perseritjes se kontrabandes, sanksioni i zbatuar do te jete dyfish i sanksionit te meparshem.
2. Kontrabanda e mbetur ne tentative denohet si kontrabanda e konsumuar.

Neni 281/2
(shtuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

Kundervajtesi, perveç ndeshkimit administrativ per kontrabanden, te parashikuar nga ky Kod, i nenshtrohet edhe ndjekjes penale ne perputhje me dispozitat e Kodit Penal."

Neni 282

1. Për qëllim të këtij kreu, “objekte të kontrabandës” do të thotë mallrat objekt kontrabande, si dhe mjetet e transportit dhe objekte të tjera të përdorura për t’i transferuar ose fshehur ato. Pa rënë ndesh me ligjet e tjera në këtë fushë, mallrat në fjalë sekuestrohen nga autoritetet doganore e më pas, me vendim të autoriteteve gjyqësore kompetente, mund të konfiskohen dhe në vijim të trajtohen në bazë të legjislacionit në fuqi.

2. Sekuestrimi i objekteve të kontrabandës kryhet pavarësisht nga shkalla e pjesëmarrjes në kontrabandë të kujtdo që ka të drejta mbi këto objekte.

3. Kur personi përgjegjës për kontrabandën ka në dorësi, si pasojë e një vepre penale tjetër, objekte të kontrabandës, të sekuestruara për qëllim të këtij neni, këto i kthehen pronarit të ligjshëm.

4. Mjetet e transportit përjashtohen nga sekuestrimi kur:

a) në bazë të provave që disponohen, pronari i tyre nuk është përfshirë në aktin e kontrabandës;

b) pronari zotëron mjetet e transportit në mirëbesim si pasojë e procedurave të zakonshme të tregtisë, pa qenë në gjendje të dijë në mënyrë objektive se mjetet në fjalë ishin një mjet ose objekt i aktit të kontrabandës ose të një akti apo krimi të ngjashëm.

5. Në rast se janë sekuestruar mallra që prishen dhe kur ekzistojnë prova të mjaftueshme, autoritetet gjyqësore kompetente marrin një vendim në lidhje me konfiskimin e tyre brenda 48 orëve nga çasti i marrjes së dosjes, në mënyrë që mallrat të mos zhvleftësohen.

6. Në rast se janë sekuestruar mjete transporti, autoritetet gjyqësore, kur ka prova të mjaftueshme në lidhje me aktin e kontrabandës, mund të marrin vendim përsa i përket konfiskimit të tyre brenda 5 ditësh. Në çdo rast, pas përfundimit të këtij afati, autoritetet doganore mund t’u kërkojnë autoriteteve gjyqësore që këto mjete transporti t’i jepen autoriteteve doganore për t’i përdorur gjatë ushtrimit të detyrës së tyre. Shpenzimet për përdorimin dhe mirëmbajtjen e këtyre mjeteve janë në ngarkim të autoriteteve doganore.

Neni 283

1. Objektet e kontrabandës, të parashikuara në nenin 282, sekuestrohen:

a) kur veprimi i kontrabandës është në kryerje e sipër. Veprimi i kontrabandës është në kryerje e sipër kur mallrat nuk janë magazinuar përfundimisht në një shtëpi, në një dyqan, në një magazinë ose në çfarëdo vendi tjetër që ka zgjedhur personi përgjegjës ose bashkëpunëtorët e tij. Kontrabanda është në kryerje e sipër edhe kur personi përgjegjës është kapur në afërsi të vendit ku është kryer kontrabanda, duke pasur në zotërim çdo lloj prove komprometuese ose është ndaluar në vijim të një informacioni të dhënë nga persona të tjerë;

b) kur veprimi i kontrabandës ka përfunduar. Në këtë rast objektet e kontrabandës janë vendosur përfundimisht në vendin e zgjedhur nga personi përgjegjës ose bashkëpunëtorët e tij.

Neni 284

Asnjë e drejtë kompensimi për dëmin e shkaktuar nga zhvlerësimi që rrjedh nga sekuestrimi i mallrave që janë objekt të kontrabandës nuk mund të ngrihet kundër autoriteteve doganore ose të shtetit shqiptar.

## KREU 5
## VERIFIKIMI I SHKELJEVE DOGANORE

### Neni 285

1. Shkeljet me karakter administrativ verifikohen dhe ndëshkohen nga autoritetet doganore në përputhje me dispozitat e neneve 256 deri 275. Në rastet e kontrabandës, autoritetet doganore përcaktojnë dhe arkëtojnë shumën e gjobës që zbatohet për çdo rast konkret, ndërsa autoritetet gjyqësore marrin masat për zbatimin e masave shtesë të parashikuara nga Kodi Penal.

2. Për qëllim të këtij kreu, "autoritete doganore kompetente" do të thotë autoritetet doganore që ushtrojnë mbikëqyrje dhe kontrolle në zonën ku është kryer dhe verifikuar shkelja doganore.

3. Për të gjitha shkeljet e dispozitave të këtij Kodi dhe akteve të tij nënligjore mbahet një procesverbal me shkrim.

4. Procesverbali duhet të paraqitet dhe regjistrohet në librat e autoriteteve doganore kompetente dhe duhet të nënshkruhet prej të paktën 2 punonjësve të doganës.

5. E njëjta procedurë ndiqet për shkeljet e dispozitave të tjera ligjore, zbatimi i të cilave i është besuar pjesërisht ose tërësisht autoriteteve doganore.

6. Autoritetet doganore me qëllim që të parandalohen, verifikohen dhe frenohen shkeljet doganore, mund të kryejnë të gjitha kontrollet e nevojshme pranë mjediseve të operatorëve ekonomikë, në magazinat e tyre dhe në të gjithë mjediset ku mbahen regjistrat e llogarisë së firmës.

### Neni 286

1 .Procesverbali duhet të përmbajë:

a) vendin, datën dhe kohën kur verifikohet shkelja;

b) emrat e personave që nënshkruajnë raportin dhe autoritetin që përfaqësojnë;

c) të dhëna identifikuese të atij ose atyre që kanë kryer shkeljen doganore;

d) llojin e shkeljes së kryer;

e) mënyrën në të cilën është kryer shkelja;

f) identifikimin e mjetit të transportit;

g) treguesit që lidhen me sasinë, cilësinë, vlerën, origjinën dhe klasifikimin tarifor të mallrave që janë objekt i shkeljes;

h) treguesit që lidhen me sekuestrimin e mundshëm të objekteve të kontrabandës;

i) shumën e detyrimeve doganore që duhen paguar;

j) nenet e shkelura, nenet në bazë të të cilëve përcaktohen sanksionet, si dhe sanksionet e parashikuara për çdo shkelje;

k) firmat e punonjësve të doganës, dhe kur është e mundur, firmën e shkelësit.

2. Autoritetet doganore duhet të njoftojnë menjëherë personin ose personat përgjegjës për kryerjen e shkeljes, mbi procesverbalin e mbajtur sipas paragrafit të mësipërm.

3. Autoritetet doganore për të marrë në pyetje të akuzuarin dhe dëshmitarët, duhet t'u bëjnë atyre një njoftim në të cilën përcaktohet data dhe ora në të cilën duhet të paraqiten personalisht ose duhet të depozitojnë një dëshmi me shkrim. Afati kohor për t'u paraqitur për këtë qellim nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë. Në rastet e flagrancës marrja në pyetje e shkelësve dhe dëshmitarëve bëhet menjëherë. Konsiderohen, gjithashtu, dëshmitarë të gjithë ata persona që mund të jenë bashkëpunëtorë në shkelje, si dhe vetë punonjësi ose nëpunësi i doganës që ka verifikuar shkeljen dhe ka nënshkruar procesverbalin.

4. Në rastet kur i akuzuari dhe dëshmitarët marrin pjesë personalisht në marrjen në pyetje, dy punonjës të autorizuar të doganës drejtojnë seancën dhe përgatisin raportin përkatës.

5. Dëshmitë duhet të nënshkruhen nga i akuzuari, nga dëshmitarët kur janë të pranishëm, dhe nga të dy punonjësit e doganës që kanë drejtuar marrjen në pyetje.

6. Kur një ose me shume të akuzuar ose dëshmitarë janë shtetas të huaj, marrja në pyetje bëhet në prani të një përkthyesi, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale dhe të Kodit të Procedurës Civile.

### Neni 287

1. Autoritetet doganore, pasi përgatisin dosjen në lidhje me shkeljen e verifikuar, marrin vendimin përkatës. Dosja përmban:

a) procesverbalin për verifikimin e shkeljes sipas nenit 286;

b) dokumentet përkatëse;

c) deklaratat dhe dëshmitë e të akuzuarve dhe/ose dëshmitarëve.

2. Kur, në bazë të dispozitave të këtij Kodi, zbatimi i gjobës parashikon një minimum dhe një maksimum, për të përcaktuar shumën e saj duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm:

a) deklaratat dhe dëshmitë e të akuzuarve dhe/ose dëshmitarëve;

b) rrezikshmërinë e shkeljes;

c) qëndrimin e mbajtur nga i akuzuari për të fshehur provat dhe pasojat e shkeljes;

d) mënyrat dhe mjetet që ka përdorur i akuzuari për të kryer shkeljen;

e) numrin e të akuzuarve;

f) nëse i njëjti shkelës ka kryer të njëjtën shkelje në mënyrë të përsëritur;

g) shkallën e pjesëmarrjes të secilit të akuzuar.

Neni 288

1. Kur shkelja doganore përbën kontrabandë, kallzimi penal bashkë me dosjen përkatëse, të përmendur në nenin 287(1), i transferohet autoriteteve gjyqësore kompetente për procedimin penal, brenda 24 orësh nga çasti i verifikimit të shkeljes.

2. Në rastet kur zbatohet neni 291(1) i këtij Kodi, dosjes së sipërpërmendur i bashkëngjitet vendimi i autoriteteve doganore në lidhje me përmbushjen e kushteve të parashikuara nga neni në fjalë.

Neni 289

1. Vendimi i autoriteteve doganore kompetente, për pagimin e detyrimeve doganore për qëllim të nenit 256(4) dhe të gjobave përkatëse të përcaktuara në bazë të nenit 287(2), duhet të merret dhe t'i njoftohet personit të akuzuar brenda 24 orësh nga çasti i verifikimit të shkeljes. Për të siguruar borxhin doganor zbatohen dispozitat e parashikuara në nenin 245 të këtij Kodi.

2. Kundër vendimit të autoriteteve doganore kompetente të përmendura në paragrafin 1, personi i akuzuar mund t'i paraqesë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave një ankesë të arsyetuar kundër këtij vendimi brenda 5 ditësh nga data e njoftimit. Në qoftë se personi i akuzuar nuk paguan shumën e përmendur në paragrafin 1, dhe nuk apelon pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, autoritetet doganore marrin të gjitha masat për të proceduar me vjeljen e shumës së borxhit doganor dhe të gjobës, në bazë të procedurave të përcaktuara në nenin 245 të këtij Kodi.

3. Për të paraqitur ankesën, apeluesi duhet të paguajë shumën e përgjithshme të detyrimeve doganore që duhen paguar, si rrjedhim i verifikimit të bërë, dhe të depozitojë, paraprakisht, në llogarinë bankare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave një shumë të barabartë me 40 për qind të shumës së përgjithshme të gjobës së zbatuar nga autoritetet doganore. Shuma që i korrespondon 40 për qind, në asnjë rast, nuk mund të jetë më e madhe se shuma e përgjithshme e detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat që janë objekt i shkeljes.

4. Drejtori i Përgjithshëm merr një vendim brenda 30 ditësh nga dita e marrjes së ankesës dhe ky vendim i njoftohet menjëherë apeluesit dhe autoriteteve doganore kompetente.

5. Nëse ankesa nuk pranohet, apeluesi duhet të paguajë pjesën që mbetet prej 60 për qind të gjobës, dhe mund të ankohet kunder vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm pranë autoriteteve gjyqësore brenda 30 ditësh nga data e njoftimit të mospranimit të ankesës.

6. Në rast se autoritetet gjyqësore pranojnë ankesën, autoritetet doganore duhet t'i kthejnë apeluesit shumën e depozituar. Kthimi i kësaj shume mund të bëhet vetëm pasi vendimi i autoriteteve gjyqësore kompetente merr formë të prerë.

Neni 290

Kur shkelja doganore përbën kontrabandë, autoritetet doganore, pasi të kenë filluar procedurat e përmendura në nenin 289 për vjeljen e detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat objekt kontrabandë dhe të gjobave përkatëse, i transferojnë autoriteteve gjyqësore kompetente, brenda 48 orësh nga çasti i verifikimit, të gjithë dosjen sipas nenit 287(1). Në raportin e dërguar këtyre autoriteteve, autoritetet doganore tregojnë edhe shumën e gjobës që është zbatuar për rastin konkret, të përcaktuar sipas nenit 287(2).

Neni 291

1. Personi i akuzuar mund t'u kërkojë autoriteteve doganore zgjidhjen në rrugë administrative të veprës së kontrabandës, në rast se plotësohen njëkohësisht të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) ndjekja penal nuk ka filluar ende;

b) shuma e detyrimeve doganore që duhen paguar për mallrat e përfshira në kontrabandë është më e vogël se 5 milionë lekë;

c) personi përgjegjës paguan menjëherë shumën e detyrimeve doganore dhe gjobën e zbatuar; dhe

d) personi i akuzuar deklaron se heq dorë nga e drejta e ankimit të parashikuar në nenin 289.

Me propozim të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave mund të ndryshojë kufirin e përmendur në paragrafin 1(b) të këtij neni.

2. Sekuestrimi që zbatohet mbi mallrat objekt kontrabande dhe ndalimi i të akuzuarit, kurdo që bëhet, anulohet menjëherë sapo autoritetet doganore verifikojnë se janë plotësuar të gjitha kushtet e përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Ky nen nuk zbatohet kur:

a) kontrabanda kryhet nga një punonjës i doganës, punonjës shtetëror, agjent doganor ose nga çdo person tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet me atë doganore;

b) i akuzuari ka në zotërim objekte të kontrabandës si pasojë e një vepre penale tjetër;

c) mallrat objekt kontrabande janë mallra të ndaluara ose që u nënshtrohen kufizimeve sipas nenit 83(2) të këtij Kodi ose janë objekte me vlerë kulturore kombëtare;

d) i akuzuari është përsëritës.

Neni 292

Autoritetet gjyqësore kompetente, mbi bazën e kallzimit penal të bërë nga autoritetet doganore në përputhje me nenin 288 të këtij Kodi, fillojnë procedurat e nevojshme për ndjekjen penale.

Neni 293
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Organet e policise gjyqesore, te parashikuara ne nenin 9 pika 4 te ketij Kodi kane te drejte te arrestojne dhe te ndalojne sipas neneve 251 dhe 253 te Kodit te Procedures Penale personat qe kryejne kontrabande.

2. Kur personi lirohet ne perputhje me nenin 291 dosja perkatese, se bashku me vendimin per zgjidhjen e çeshtjes ne rruge administrative, u dergohen brenda 24 oreve autoriteteve gjyqesore kompetente.

Neni 294
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Punonjësit e doganës mund të autorizohen nga kryetari i zyrës kompetente për të mbledhur informacione ose për të zbuluar provat mbi shkeljet e këtij Kodi dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Informacioni mund te merret ose kerkohet ne vendet ku kryhen veprimtari prodhuese, sherbimi dhe tregtare, si dhe kudo ku ruhen shkresa dhe dokumente te tjera ne lidhje me mallrat qe jane objekt i shkeljeve doganore. Mbledhja e informacionit per kontrabanden, kur ka filluar procedimi penal, behet sipas dispozitave te Kodit te Procedures Penale.

Neni 295

Të gjitha institucionet publike civile dhe policia kufitare dhe e rendit, si dhe pjesëtarët ose vartësit e tyre, janë të detyruar të ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor.

Neni 296
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

Të ardhurat që burojnë nga zbatimi i sanksioneve dhe i shitjes së objekteve të kontrabandës të konfiskuara shpërndahen si vijon:

a) 50 për qind buxhetit të shtetit;

b) 50 për qind që mbetet ndahet në bazë të përqindjes së caktuar nga Ministri i Financave sipas kritereve të mëposhtme:

i) investime e shpenzime për përmirësimin e kushteve të punës së personelit;

ii) shpërblime për personelin doganor që ka marrë pjesë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në shqyrtimin shkeljes doganore;

iii) shpërblime për informatorët që kanë bërë të mundur zbulimin e shkeljeve.

PJESA IX
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 297
(ndryshuar me ligjin Nr.8473, date 14.4.1999)

1. Periudha e tranzicionit zgjat një muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij Kodi dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Me përjashtim të dispozitave të pjesës VIII të këtij Kodi, gjatë kësaj periudhe tranzicioni, do të vazhdojnë të zbatohen procedurat e parashikuara në ligjin nr.7599, datë 2.9.1992 "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë" dhe ndryshimet e mëtejshme. Gjatë kësaj periudhe Drejtori i Përgjithshëm i Doganave merr të gjitha masat dhe nxjerr udhëzimet e nevojshme për vënien në zbatim të këtij Kodi dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Me mbarimin e periudhës së tranzicionit shfuqizohen ligjet e mëposhtme:

(1) Ligji nr.7599, datë 2.9.1992 "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë".

(2) Ligji nr.8020, datë 1.11.1995 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 7599, datë 2.9.1992 "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë".

Pika (3) shfuqizohet

(3) Ligji nr. 8263, datë 15.12.1997 "Për një ndryshim në ligjin nr.7599, datë 2.9.1992 "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë".

(4). Me hyrjen në fuqi të këtij Kodi:

(5) shfuqizohet ligji nr. 8187, datë 23.1.1997 "Për vlerësimin doganor";

(6) shfuqizohen nenet 1; 3; 17; 18; 19; 20/1; 20/2; 20/3; 20/4; 20/5; dhe 21 të ligjit nr.7609, datë 22.9.1992 "Për tarifat doganore", ndryshuar me ligje të tjera, si dhe çdo dispozitë tjetër e këtij ligji që bie në kundërshtim me këtë Kod;

(7) shfuqizohen dispozitat në lidhje me policinë doganore në dekretin nr. 1074, datë 2.4.1995 "Për shpërbërjen e Policisë Financiare dhe krijimin e Policisë Doganore dhe Policisë Tatimore", miratuar nga ligji nr.7938, datë 24.5.1995;

(8) shfuqizohen dispozitat në lidhje me policinë doganore në dekretin nr. 1701, datë 9.1.1997 "Për një shtesë në dekretin nr.1074, datë 2.4.1995 "Për Shpërbërjen e Policisë Financiare dhe krijimin e Policisë Doganore dhe të Policisë Tatimore", miratuar me ligjin nr.7938, datë 24.5.1995";

(9) shfuqizohet dhe çdo dispozitë tjetër që bie ndesh me këtë Kod;

(10) taksat e reja doganore do të hyjnë në fuqi pas datës 31 mars 1999 me ligj të veçantë.

Neni 298

Në periudhën e ndërmjetme nga miratimi i këtij Kodi në Kuvend, deri në ditën e hyrjes në fuqi, ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi, në fushën e organizimit të administratës doganore, të faktorëve mbi bazën e të cilëve zbatohen detyrimet doganore, të dispozitave të zbatueshme për mallrat që hyjnë dhe dalin nga territori doganor, të destinacioneve doganore, të operacioneve të privilegjuara dhe borxhit doganor, si dhe në fushën e shkeljeve doganore, të cilat hyjnë në fuqi në të njëjtën datë me hyrjen në fuqi të këtij Kodi.

Neni 299

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2312, datë 10.2.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani**